



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 28 MAJ 2009

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
28. MAJA 2009. GODINE

MAJ – MAJA
2009

Seancën e kryesoi, **Xhavit HALITI**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Të nderuar deputetë,
I nderuar Kryeministër, zëvendëskryeministra dhe Kabinet qeveritar,

Hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 91 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Ju njoftoj së në bazë të rregullave 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit i ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Ndërkohë, në bazë të Rregullës 23.2 të Rregullores së Punës, Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 26 maj 2009, vendosi që Kuvendit t'i propozojë që në seancën e sotme plenare të radhitet edhe Shqyrtimi i parë i Projektligjit për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Bankën Botërore.

Ky propozim është mbështetur nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Gjithashtu, ju njoftoj se deri në fillim të seancës plenare nuk kam pranuar asnjë propozim për amendamentimin e rendit të ditës ose propozim për shqyrtimin e ndonjë çështje urgjente në pajtim me rregullat procedurale.

Andaj, në qoftë se edhe tani, eventualisht, ka ndonjë kërkesë për ndryshim të rendit të ditës, sepse unë para se të përgatitej skenari kam pasur disa kërkesa nga grupet parlamentare dhe nga Qeveria për ta ndryshuar ose për ta hequr ndonjë pikë të rendit të ditës, ju lus që të paraqiteni lidhur me rendin e ditës. Fjalën e ka ministri Arsim Bajrami.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar Kryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Në rendin e ditës sot është përfshirë edhe diskutimi i tri ligjeve organike, ligjeve sistemore, të cilat do të vendosin bazën e reformimit të administratës publike: Ligji për Qeverinë e Republikës së Kosovës; Ligji për Shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe Ligji për pagat e nëpunësve civilë të Republikës së Kosovës.

Bëhet fjalë për ligje sistemore, organike, që duhet të vendosin bazën juridike për reformimin e tërë sektorit publik.

Qeveria ka përpunuar me përkushtim të jashtëzakonshëm këto ligje.

Ne jemi duke i përfunduar edhe marrëveshjet me faktorët – partnerët tanë ndërkombëtarë rreth konstruksionit financiar të këtyre ligjeve dhe meqenëse këto tri ligje janë të ndërlidhura dhe kanë një kosto financiare, kërkojmë nga Kryesia e Kuvendit dhe nga Parlamenti që këto ligje t'i lëmë për mbledhjet e ardhshme, me qëllim që plotësisht të sigurojmë një konstruksion të plotë financiar për të mundësuar edhe planifikimin e mirë të këtyre ligjeve në kornizën afatmesme të shpenzimeve. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Bajrami. A ka ndonjë propozim lidhur me këtë? Ministri Rashiq, e ka kërkuar fjalën.

MINISTAR SAŠA RAŠIĆ: Poštovani predsedavajući Skupštine,
Poštovani Premijeru, zamenici premijera,
Kolege ministri,
Uvaženi poslanici,

Želim da vas obavestim da je ministar Nenad Rašić, ministar za rad i socijalnu politiku službeno odustan, s toga predlažem da se 7 tačka dnevnog reda, a to je prvo razmatranje Nacrta zakona o izmenama i dopunama o socijalnoj šemi na Kosovu, odloži za narednu sednicu. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Në marrëveshje të plotë me kolegun tim, kryetarin e Grupit Parlamentar të PDK-së dhe në konsultim me disa nga shefat e tjerë të grupeve parlamentare, në marrëveshje dhe me kërkesë edhe të Kryetarit të Kuvendit, kërkoj që pika e tretë e rendit të ditës për zgjedhjen e Avokatit të Popullit të enjten e ardhshme në një mbledhje të veçantë votimi në mënyrë që gjatë kësaj periudhe kohore ne të harmonizojmë të gjitha angazhimet tona të përbashkëta në mënyrë Avokati i Popullit të jetë i zgjedhur dhe t'ia fillojë punës sot një javë. Faleminderit !

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka propozime të tjera lidhur me rendin e ditës. Mendoj se sa iu përket tri propozimeve të parashtruara, kryetarët e grupeve parlamentare e kanë fjalën. .

Unë mendoj se të tri propozimet kanë arsyeshmërinë e vet dhe propozoj që me një votim formal të miratojmë shtyrjen për ndonjëherë nga seancat e ardhshme për këto projektligje:

1. Shqyrtimin e parë të Projektligjit për Shërbimin civil të Republikës së Kosovës;
2. Shqyrtimin e parë të Projektligjit për pagat e punonjësve në Shërbimin civil, dhe
3. Shqyrtimin e parë të Projektligjit për Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Pra, fjala është për projektligjet e propozuara nga ministri Bajrami. Prandaj, kërkoj që të votojmë me një votim formal për të tri propozimet.

Shumica janë “për”, “kundër” 5 , pra, miratohet propozimi i ministrit Bajrami që projektligjet e cekura me lart të shtyhen për seancën e ardhshme.

Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit 2003/15 për skemën sociale në Kosovë, të propozuar nga ministri Rashiq, që është në udhëtim zyrtar dhe s'mund ta shqyrtojmë sot pa prezencën e tij.

Edhe këtë propozim duhet ta miratojmë. Ju faleminderit!

“Kundër”, 5 vota, të gjitha të tjerat janë “për”, pra miratohet shtyrja e shqyrtimit të parë të Projektligjit të lartpërmendur.

Shtyrja e zgjedhjes së Avokatit të Popullit për seancën e ardhshme.

Kush është “për”? Faleminderit!
“Kundër”?

(Reagim)

Atëherë, duhet t’i numërojmë. Po shihet se shumica janë “për”. Po, atëherë numëroni edhe “kundër” kush është?

(Numërohen votat)

Nga 98 prezentë, 26 janë “kundër”. Pra, konstatoj se miratohet edhe propozimi i kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës dhe i atij të Lidhjes Demokratike të Kosovës – së bashku, që të shtyhet zgjedhja e Avokatit të Popullit.

Sipas marrëveshjes dhe vendimit të Grupit Parlamentar “7+” është bërë ndërrimi i anëtarit të Kryesisë së Kuvendit nga radhët e komunitetit joshqiptar dhe joserb, si dhe ndërrimi i kryetarit të këtij grupi parlamentar, si vijon:

- Deputetja Myfera Shinik do të jetë anëtare e Kryesisë së Kuvendit, kurse deputeti Xhezair Murati caktohet kryetar i Grupit Parlamentar ”7+”.

Ky është vetëm një njoftim, që nuk është për t’u votuar. Pra, është e drejtë e tyre, sipas marrëveshjes paraprahe.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

- **Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 15 maj 2009.**

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se për shkak të shtyrjes së njëpasnjëshme të seancës plenare të datës 14 maj 2009, sot do të miratohet vetëm Procesverbalit i seancës plenare të mbajtur më 15 maj 2009, i cili u është shpërndarë deputetëve.

Pyes deputetët, a kanë vërejtje në procesverbal? E ka fjalën Shkumbin Demaliaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Për procesverbalin kur janë zgjedhur anëtarët – gjyqtarët për Gjykatën Kushtetuese, unë , por besoj se edhe i gjithë grupi ynë parlamentar nuk do ta miratojë këtë procesverbal për shkak se me rastin e përzgjedhjes dhe të votimit që është bërë atë ditë, në Kuvend është shkelur neni 114 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Ne këtu kemi pasur rastin që vazhdimisht për disa rregulla shumë të imëta dhe për çfarëdo që ka kërkuar dikush nga deputetët, që t’ua lexonim ato dhe kështu ka vepruar edhe Kryetari i Parlamentit. Thotë, shini Rregulloren, por në këtë rast është shkelur Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe është shkelur neni 6 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës me rastin e përzgjedhjes së anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Po e lexoj nenin 114, është përbërja edhe mandati i Gjykatës Kushtetuese. “Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 gjyqtarë, të cilët do të jenë jo veç të shquar, çka do të thotë dhe personalitete me moralin më të lartë dhe jo më me pak se 10 vjet përvojë profesionale përkatëse”. Pra, anëtarët që janë zgjedhur nuk janë juristë të shquar, janë juristë, por nuk kanë përvojë 10 vjeçare, sepse shumica prej tyre janë ish- profesorë të mirë dhe deri para 3-4 vjetësh kanë qenë asistentë edhe në këtë rast nuk e kanë këtë përvojë...

KRYESUESI: Zoti Demaliaj, jeni jashtë rendit të ditës....

SHKUMBIN DEMALIAJ: Jemi duke folur për procesverbalin, kur shkelet kushtetutshmëria e vendit...

KRYESUESI: Në qoftë se ju keni folur dhe jeni keqinterpretuar ose

SHKUMBIN DEMALIAJ: Nuk është keqinterpretim shkelja e Kushtetutës, por kështu është duke vazhduar ky mandat i këtij Kuvendi dhe qeverisja e vendit, është gjithnjë me shkelje kushtetuese. Ju mund të ma merrni fjalën, por ne nuk do ta votojmë këtë procesverbal. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Ka dikush ndonjë vërejtje tjetër?

(Ndërhyrje nga salla)

Urdhëro, në qoftë nuk e ke fjalën për procesverbal, unë do ta marrë fjalën menjëherë. Në rregull.. Zoti Gjini e ka fjalën, për procesverbalin.

ARDIAN GJINI: E kam kërkuar fjalën si shef i Grupit që gjysmë ore. Pra, po të tregoj që gjysmë ore e ke emrin tim aty si shef i Grupit Parlamentar, të gjithëve u jepet fjala, kurse mua jo. Ky është skandalizim i Kuvendit. Jam shef i Grupit Parlamentar.

KRYESUESI: Ndaljani mikrofonin. Nuk e ke kërkuar fjalën si shef i Grupit Parlamentar. Nuk je paraqitur për fjalë. Unë nuk e kam. A do ndokush tjetër të flasë për procesverbalin? Po, Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Zotëri kryesues!

Është obligim i cilitdo qytetar të Kosovës, kudo dhe kurdo, e aq më parë në tekstin konkret, në procesverbalin, ta ngritë zërin kundër shkeljes së Kushtetutës, nenit 114 edhe nenit....

KRYESUESI: Zoti Smaka, keni mundësi që të ankoheni në Gjykatën Kushtetuese tani.

RIZA SMAKA: Kjo është një.

KRYESUESI: Ju faleminderit! I merret fjala zotit Smaka, lidhur me procesverbalin.

RIZA SMAKA: Ju lutem!

KRYESUESI: A ka dikush tjetër të thotë diçka lidhur me procesverbalin? Nuk ka. Konstatoj se u miratua procesverbali me vërejtjet e paraqitura. Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Ju njoftoj se në mes të dy seancave është parashtruar një numër i madh i pyetjeve parlamentare, saktësisht 41 sosh, ndërsa koha e paraparë është e kufizuar në 50 minuta.

Procedimi i pyetjeve do të bëhet sipas kohës së parashtruar dhe numrit rendor të pyetjeve. Fillojmë me procedimin e pyetjeve të parashtruara.

Deputetja Zylfije Hundozi, pyetje për ministrin e Shërbimeve Publike, Arsim Bajrami.

ZYLFIJE HUNDOZI: Zoti kryesues, unë po e tërheq pyetjen time për arsye se në seancën e kaluar kanë thënë që veç nga një pyetje, nuk i kam me vete.

KRYESUESI: Deputetja Zylfije Hundozi, pyetje për Kryeministrin Hashim Thaçi. Cilën nga këto pyetje, se i paske 6? Meqenëse është konstatuar kështu.

ZYLFIJE HUNDOZI: Unë, gjithashtu edhe këtë pyetje po e tërheq, se nuk jam e kënaqur me udhëheqjen e seancës. Nuk keni të drejtë t'ua merrni deputetëve fjalën. Ky është Kuvend. Për çka kemi ardhur këtu, të flasim apo ...?

KRYESUESI: Të gjithë duhet ta zbatojmë Rregulloren. Nuk ia merr askush...

ZYLFIJE HUNDOZI: Po, me Rregullore, ju duhet ta zbatoni Rregulloren.

KRYESUESI: Mbledhja vazhdon. Në rregull. Do të thotë, nuk doni të bëni asnjë pyetje. Deputetja Myrvete Pantina, pyetje për ministrin e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, Mahir Yagcilar. Ministri nuk është këtu. A doni ta lexoni pyetjen?

MYRVETE PANTINA: Po, faleminderit!

KRYETARI: Urdhëroni!

MYRVETE PANTINA: Ujërat nëntokësor në zonën e KEK-ut, janë të kontaminuara me fenol, gjë që paraqet rrezik të përhershëm për shëndetin e banorëve të kësaj zone. Zoti ministër, a janë bërë matje se sa janë të kontaminuara ujërat nëntokësorë në zonën e KEK-ut dhe a ekziston ndonjë projekt për pastrimin e këtyre ujërave?

KRYESUESI: Ministri, e dite që nuk është këtu, nëse doni mund ta lexoni pyetjen, përgjigje nuk ka.

Deputetja Donika Kadaj-Bujupi, pyetje për ministren e Energjisë dhe Minierave, Justina Pula-Shiroka. Ministria as deputetja nuk janë këtu. Ju faleminderit!

Deputeti Driton Tali, pyetje për ministren e Energjisë dhe të Minierave. Nuk është. Deputeti Driton Tali pyetje për Kryeministrin Hashim Thaçi, por nuk është këtu. Deputeti Naser Rugova, pyetje për ministrin e Punëve të Brendshme, Zenun Pajaziti. Ministri nuk është këtu. A doni ta bëni pyetjen? E ka fjalën deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Së pari, kërkojmë një udhëheqje më kompetente të seancës, sepse jemi Kuvend dhe jemi organi më i lartë legjislativ i vendit dhe qytetarët i kanë sytë tek ne. Së dyti, është një joseriozitet i Qeverisë, zoti Kryeministër kërkoj nga ju që kur të parashtrohen që një muaj pyetjet parlamentare, ministrat kanë obligim, t'u përgjigjen njerëzve të zgjedhur, sepse janë zgjedhur nga ky Kuvend. Kjo praktikë fatkeqësisht është duke vazhduar. Unë e kam një pyetje për ministrin. Po e lexoj se garant nuk do të jetë as në seancën e ardhshme.

Institucionet e Republikës së Kosovës kanë marrë vendim për fillimin e 18 misionëve diplomatike dhe konsullore. A e keni shqyrtuar mundësinë që qytetarët tanë në mërgatë të pajisen me karta të identitetit, pasi që gati një e treta e popullatës gjendet në mërgatë? Pra, këtyre njerëzve duhet t'u mundësohet të marrin pjesë në procesin e votimit. Kjo është një kërkesë legjitime dhe u takon, sepse kanë kontribuar shumë për Kosovën...

KRYESUESI: Ju faleminderit! Besoj që për elektoratin ishte pyetje e mirë. Deputeti Riza Smaka, pyetje për zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi dhe Ramë Manaj. Në rregull. Kam të drejtë në replikë atëherë. Unë jam duke e zbatuar saktësisht Rregulloren. Për çdo çështje të ngritur nga ana e deputetëve dhe grupeve parlamentare të shkruara, unë jam i detyruar t'i vë në rend dite dhe t'ua qesë ...

(Ndërhyrje nga salla)

Në rregull. Ma përmende emrin dhe fole për mua në fillim. Kjo ishte replika me ju. Deputeti Riza Smaka, pyetje për zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi ose Ramë Manaj. Zoti Smaka!

RIZA SMAKA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë shpreh indinjatë të thellë për mënyrën arbitrare të vendosjeve të shkeljes së Kushtetutës, të cenimit të të drejtave elementare të deputetit edhe në shenjë rezignance, e tërheq pyetjen. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Besoj që edhe tjetrën dëshiron ta tërheqë. Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Idriz Vehapin.

RIZA SMAKA: E njëjta vlen ajo që e thashë. Ju faleminderit! Po e tërheq në shenjë të dëshpërimit edhe të zhgënjimit.

KRYESUESI: Shkumbin Demaliaj, pyetje për zëvendëskryeministrin, Hajredin Kuçi.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Meqenëse është e treta seancë, unë kam menduar se kjo pyetje nuk do të vijë, në dy seanca bëhet pyetja dhe kjo është një shkelje e Rregullores së brendshme. Pra, do të thotë, dy seanca kanë kaluar, nga data 22.4, po unë pyetjen do ta bëjë edhe pse është menduar të vjetrohet kjo pyetje, është shumë aktuale. Kjo pyetje ka pasur të bëjë fillimisht me Kryeministrin e Kosovës, se nuk kam dashur të më përgjigjet Kryeministri, por zëvendëskryeministri në aspektin profesional se a është shkelur Kushtetuta e Republikës së Kosovës me rastin e lejimit të Presidentit të Serbisë,

Boris Tadiq, në Ditën e Pashkëve Ortodokse ta vizitojë Kosovën? Pres përgjigjen nga zëvendëskryeministri.

KRYESUESI: Zoti zëvendëskryeministër Kuçi, e keni fjalën! Pra, dëshiron të përgjigjet lidhur me këtë pyetje, Kryeministri zoti Thaçi. Zoti Kryeministër e ka fjalën.

Në kushtet kur nuk është Kryeministri në sallë dhe kur i autorizon për çështje kryesore të përgjigjen zëvendëskryeministrat, është në rregull dhe duke qenë Kryeministri këtu, unë, edhe me kërkesën e vet Kryeministrit, ia jap fjalën që t'i përgjigjet pyetjes suaj. Fjalën e ka Kryeministri Hashim Thaçi!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Ju faleminderit, i nderuari zoti kryesues!

Ju faleminderit, zoti deputet për pyetjen!

Të nderuar deputetë,

Pyetja është e parashtruar për Qeverinë e Republikës së Kosovës. Ke menduar pyetjen për Kryeministrin dhe kur është Kryeministri, mund të përgjigjet në emër të Qeverisë kurdo që do. Prandaj, nuk do t'i shtoja asgjë as më shumë, as më pak se sa deklaratës që e kam dhënë ditën e vendimit. Prandaj, ajo është çështje që i takon të së kaluarës, ne e ndërtojmë shtetin tonë dhe jemi sovran në vendin tonë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Pyetje shtesë? Zotit Demaliaj fjalën!

SHKUMBIN DEMALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues. Unë thashë edhe një herë kam pasur dëshirë të më përgjigjet zëvendëskryeministri. Faleminderit prej Kryeministrit që pati dëshirë edhe t'i përshtatet këtij muhabeti që po e organizojmë sot. Po atë ditë edhe Presidenti i Republikës nuk është deklaruar, as Kryetari i Parlamentit, ka qenë bashkë me Kryeministrin edhe për ne, Pashkët Ortodokse janë festë me ligj shtetëror të Kosovës. Askush nga Qeveria edhe institucionet e Kosovës nuk ka shkuar te institucionet fetare ortodokse në Kosovë që t'i vizitojë dhe t'ua urojë Pashkët, përpos me ndonjë letër. Vjen presidenti i Serbisë, sillet sikur të ishte president ynë edhe ne themi se në qoftë se fol keq, ai nuk do të vijë më në Kosovë, në qoftë se fol mirë, Kosova është e tij, a? Komente të pa rëndësishme shumë edhe shumë papërgjegjshmëri e institucioneve tona për atë ditë. Ne me ligj e kemi festën ortodokse të përshkruar brenda, është festë shtetërore e Kosovës. Ne ikim dhe neve na sillet Boris Tadiqi nëpër gjithë territorin e Kosovës. E falënderoj me këtë rast ministrin e ... (Ndërprerje)

KRYESUESI: E kryet, ju lutem. Zoti Kryeministër, a dëshironi ta vazhdoni përgjigjen?

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar, zoti deputet, Shkumbin. Unë e vlerësoj lart patriotizmin tuaj, por çdo vendim imi ka qenë në përputhshmëri me Ligjin dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

DEPUTETJA MYFERA SHINIK: Pyetje për ministrin e Shërbimeve Publike, Arsim Bajrami. E ka fjalën deputetja Myfera Shinik.

MYFERA SHINIK: Teşekkür ederim!

Teşekkür ederim.

Diller Kullanımı Yasası'nın 9.2 maddesinde 2.3 maddesine dayalı olarak belediye adları, köy, cadde ve diğer aleni yerlerin işaretlenmeleri resmi dil ve o belediyelerde yaşayan, resmi statüsü olan toplulukların dillerinde yazılmalıdır diye geçmektedir. Buna rağmen

Prizren belediyesinde işaret tabelaları değiştirilirken diğer diller arasında olması gereken Türkçe yazılar neden yok?

KRYESUESI: Ministri Arsim Bajrami, e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Ju faleminderit!

E falënderoj deputeten Shinik për pyetjen. Dëshiroj fillimisht të theksoj se çështja e barazisë së gjuhëve është rregulluar drejtpërdrejt me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për përdorimin e gjuhëve dhe është duke u bërë vërtet një monitorim shumë rigoroz rreth implementimit të plotë të barazisë së gjuhëve. Siç e dini, në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë gjuha shqipe dhe gjuha serbe, si dhe gjuhët e komuniteteve në pajtim me Ligjin.

Sa i përket rastit konkret që ju e cekni edhe që ky rast është në kompetencën e Ministrisë së Pushtetit Lokal, e cila është kompetente për të monitoruar barazinë e gjuhëve në nivel lokal, konkretisht në qytetin e Prizrenit. Pra, dëshiroj të theksoj se ne i kemi kërkuar prej kësaj Ministrie që të ushtrojë monitorimin e plotë të realizimit të barazisë së gjuhës turke në institucione publike, qoftë kur është fjala për përdorimin e kësaj gjuhe në institucionet e pushtetit lokal, qoftë të mbishkrimet dhe kemi kërkuar që kjo ministri të monitorojë plotësisht realizimin e gjuhëve në nivelin lokal. Ministria e Administratës Publike, që unë e udhëheq është kompetente për të monitoruar realizimin e barazisë gjinore në nivel republikan, në nivel të institucioneve të Republikës së Kosovës. Unë pres që ministri i Pushtetit Lokal të bisedojë me autoritetet e komunës së Prizrenit dhe t'i ndërmarrë të gjitha masat që gjuha turke atje të jetë plotësisht e barabartë, pra, në pajtim me Ligjin mbishkrimet në gjuhën turke të vendosen në të gjitha institucionet publike në shkolla, në institucionet e pushtetit lokal dhe në këtë drejtim, të raportojë plotësisht për realizimin e plotë të kësaj çështjeje.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër! A ka pyetje shtesë? Nuk ka pyetje shtesë. Ju faleminderit! Deputeti Enis Krvan, pyetje për ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Enver Hoxhaj.

ENIS KERVAN: Ju faleminderit, zoti Kryesues!

Sayın Bakan,

Türkiye Cumhuriyeti devletinin sağlamış olduğu bu devlet burslarından Kosovalı gençler Yüksek okul, Fakülte, Mastır ve Doktora eğitimlerini tamamlamak maksadıyla faydalanmaktadır.

Eğitimlerini tamamlayan kadrolarımız Kosova Cumhuriyetine döndüklerinde diploma denklik işlemlerini Eğitim Bakanlığımızda gerçekleştirmektedir.

Ancak sıkıntılar sayısı yirminin üzerinde olan Yüksek okul mezunu kadrolarımızla yaşanmaktadır. Uzun zamandan beri Yüksek okul mezunu olan gençlerimizin denklik işlemleri durdurulmuş, önceden Bakanlığınız tarafından “denkliğin işlemde oluşuna dair belgelerin” verilmesi bile ortadan kaldırılmıştır. Bu sıkıntılar neticesinde Yüksek okul mezunu gençlerimiz devlet kurumları tarafından açılan iş konurlarından maalesef yararlanamaz olmuştur ve bu hak ellerinden alınmıştır.

Sayın Bakan, konuyla ilgili son yapılan çalışmalar ve gelişmeler nelerdir ve ihtiyacımız olan bu kadrolarımız denkliklerini ne zaman elde edebilecekleridir?

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zoti ministër e keni fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAI: I nderuar, zoti Kryesues!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuari deputet,

Një pyetje të tillë realisht më duket se teknikisht nuk ka ... në Ministri të Arsimit, por jam i informuar për çështjen të cilën po e shtroni.

Fillimisht dua ta falënderoj Republikën e Turqisë, e cila çdo vit ndanë bursa për studentë nga Kosova. Ne si Ministri e Arsimit, jemi duke bërë përpjekje maksimale që nostrifikimi i diplomave vërtet të mos jetë një proces shumë i gjatë, mirëpo procedurat janë të tilla ku Ministria e Arsimit këto diploma i dërgon në Universitet të Prishtinës, Universiteti i Prishtinës formon Komision dhe shpeshherë nuk jemi në gjendje që t'i detyrojmë profesorët që brenda dy muajsh, te muajsh, vërtet, ta bëjnë një nostrifikim të diplomës. Sa për informatë, nostrifikimi i diplomës edhe në vendet perëndimore, të paktën edhe mua personalisht më ka marrë më tepër se sa duhet 6 deri 9 muaj, kështu që është një procedurë e cila shpeshherë qytetarëve të Kosovës iu shkakton nervozë, mirëpo është një procedurë e cila duhet të kryhet.

Dua, po ashtu, t'ju jap edhe një informatë, i nderuari deputet sidomos për formulimin preciz që përdorët. Në një vend modern arsimit i lartë përbëhet prej universiteteve dhe shkollave të larta. Universitetet ofrojnë grada universitare, shkollat e larta ofrojnë certifikata dhe diploma profesionale. Shpeshherë kemi problem në nostrifikimin e diplomave, sepse njerëzit nuk janë në gjendje ta dallojnë çfarë është kualifikim dhe se çfarë është gradë universitare. Pra, kemi pasur edhe 2 – 3 raste nga Republika e Turqisë, në Republikë të Kosovës ka barazi të gradave dhe të vlerave mund të përdoret një diplomë dhe është e barabartë ...Dikush nuk ka gradë universitare, ne nuk jemi në gjendje që atij t'ia japim një gradë universitare, ose ka raste ku dikush e ka dhënë një provim të gjuhës angleze ose frënge dhe provimin e gjuhës e interpreton këtu si gradë të fakultetit për të dhënë mësim në shkollat e mesme dhe fillore. Pra, ne jemi të detyruar që qytetarëve të Kosovës t'i bëjmë të qartë që ka dallim mes gradave universitare dhe kualifikimeve. Kuvendi i Kosovës vitin e kaluar e ka miratuar Ligjin për kornizën kombëtare të kualifikimeve, strukturë ligjore kemi, mirëpo duhet pakëz të informohen më saktësisht që ne si vendi i ri kemi diverzitet të gradëve dhe të certifikatave.

KRYESUESI: Faleminderit!

A ka pyetje shtesë? Jo. Vazhdojmë, deputetja Suzan Novobrdaliu, pyetje për Kryeministrin Hashim Thaçi.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, kryesues!

Unë isha e gatshme t'ia parashtroj pyetjen, por Kryeministri doli. S'e di që nuk pati durim të rrijë më tepër, kështu që, ndoshta, kthehet edhe ndërkohë e bëj pyetjen.

KRYESUESI: Në rregull.

Pyetjet që i keni me radhë, tri do të thotë, i tërhiqni. Tërhiqen për seancën e ardhshme.

Deputeti Hajredin Hyseni, pyetje për ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Valton Beqiri. Ministri nuk është këtu. A dëshironi ta lexoni pyetjen? Tërhiqet për seancën e ardhshme.

Deputetja Sanije Aliaj, pyetje për Kryeministrin Hashim Thaçi. A dëshironi ta lexoni pyetjen? Urdhëroni!

SANIJE ALIAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Për shkak të përgjegjësisë që e kam marrë për gjendjen e pensionistëve nga një takim në komunën e Ferizajt, pyetjen do ta shtroj dhe kërkoj mundësisht të përgjigjet zëvendëskryeministri, Hajredin Kuçi.

Më 6 prill 2009 në Ferizaj u mbajt një takim i organizuar nga Kryesia e Sindikatës së rajonit të Ferizajt me anëtarësinë e gjerë, ku ishin të pranishëm edhe deputetët nga ky rajon. Nga ky takim dolën disa konkluzione që të zbatohen rekomandimet e Komisionit për Punë dhe Mirëqenie Sociale, të miratuara më 7 korrik 2005. Punëtorët e pensionuar përjetojnë padrejtësitë e së drejtës për pension. Mosrealizimi i kësaj të drejte sanksionohet me Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Pensionistët e Ferizajt duhet.....

KRYESUESI: Edhe një minutë, ju lutem, t'i vazhdohet deputetes.

SANIJE ALIAJ: Faleminderit! Zoti zëvendëskryeministër, pse nuk zbatohen rekomandimet e Komisionit për Punë dhe Mirëqenie Sociale, të miratuara më 7 korrik 2005? A mund të përshpejtohet procedimi i Projektligjit për sigurimin pensional dhe invalidor në Kuvend, në mënyrë që kjo e drejtë të realizohet në bazë të ligjit? Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti zëvendëskryeministër nuk dëshiron të paraqitet me qenë se pyetja ka qenë e drejtuar, e adresuar diku tjetër. Deputetja Myrvete Pantina, pyetje për ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Idriz Vehapi. Deputetja Pantina.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Sipas të dhënave të Ministrisë së Bujqësisë, hapësira e planifikuar për mbjelljet bujqësore këtë vit ka shënuar rënie në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2008, që do të thotë se prej 300 mijë hektarëve sipërfaqe bujqësore, sa ka kapacitet Kosova, këtë vit janë planifikuar të mbillen 109.118 hektarë, përkundër faktit që pjesa më e madhe e produkteve bujqësore importohen.

Zoti ministër, kur do të ketë Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural strategjinë e zhvillimit për sektorin e bujqësisë? Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër,

MINISTRI IDRIZ VEHAPI: I nderuar zoti kryesues,

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra, deputetë,

E nderuara deputete,

Kjo shifër që përmendet ju 109 mijë e 118 hektarë është planifikim për mbjellje pranverore dhe është për disa hektarë më pak se sa vitin e kaluar, mirëpo këtë nuk mund ta krahasojmë me 300 mijë hektarë, sepse mbjelljet vjeshtore mbillen rreth 100 mijë hektarë. Plus sipërfaqja e tokës që nuk është e privatizuar është rreth 15 mijë hektarë, pastaj sipërfaqet me vreshta dhe me plantacionet e pemëve, kështu që shihen se prej 300 mijë hektarëve mbillen vetëm 109 mijë hektarë, domethënë kjo nuk është e saktë. Kjo

është vetëm për mbjellje pranverore, e di se ju keni parë në një gazetë ditore dhe ato kanë qenë keq të interpretuara.

Ndërkaq sa i përket asaj se a ka Ministria një strategji duhet t'ju përkujtoj se Ministria e Bujqësisë planin për zhvillim rural dhe bujqësor e ka prej vitit 2007 dhe është për periudhën 2007 – 2013 dhe ky plan është azhurnuar dhe është bërë plani i zhvillimit bujqësor rural 2009 – 2013. Kjo është përgjigja për pyetjen tuaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A keni pyetje shtesë?

MYRVETE PANTINA: Ministër, e dimë që ekziston plani për zhvillim për periudhën që e cekët, por a mendoni që Kosova duhet ta ketë edhe strategjinë për zhvillimin e bujqësisë?

MINISTRI IDRIZ VEHAJI: Zonja deputete, në këtë plan janë përfshirë të gjitha masat dhe prioritetet që janë të përcaktuara dhe ne pastaj prej atyre 8 masave që janë të përcaktuara me planin e zhvillimit rural jemi munduar t'i përzgjedhim dhe t'u japim përparësi atyre që janë më emergjente. Planin e zhvillimit rural është një dokument mjaft voluminoz në të cilin kanë punuar ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë.

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Naser Rugova, pyetje për ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, Sadri Ferati. Nuk është as njëri, as tjetri..

Deputetja Drita Maliqi, pyetje për ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Nuk është as njëri, as tjetri.

Deputetja Njomza Emmini, pyetje për ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Enver Hoxhaj.

NJOMZA EMINI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Këtu kemi parasysh një sërë tekstesh të të gjitha lëndëve që tashmë janë nëpër shkollë që nuk i plotësojnë standardet e një teksti shkollor, pa marrë parasysh ndonjëherë edhe përgatitjen akademike të një autori që përgatit, dhe të hartuesit edhe nëse do të ketë standarde për hartimin e teksteve shkollore po ashtu nuk janë definuar qartë. Atëherë, unë parashtroj pyetjen- Çfarë pret Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë pas formimit të Këshillit Shtetëror për Kurrikulin e Kosovës, veçanërisht kur është fjala për hartimin e teksteve shkollore pas një rishikimi të Kurrikulit nëpër nivele? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti ministër e keni fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit, zoti kryesues!

E nderuara zonja deputete,

Ministria e Arsimit para dy muajsh ka bërë botimin e standardeve dhe kritereve se si hartohet një tekst shkollor. Ne jemi të vetëdijshëm që tekstet shkollore që përdoren në Republikën e Kosovës nuk janë në nivelin e duhur, prandaj me qëllim që ta përmirësojmë cilësinë në arsim, sivjet jo vetëm që kemi bërë botimin e standardeve se si, në të ardhmen, autorët në përputhje me këto standarde të hartojnë tekste të reja, mirëpo kemi

filluar edhe procesin e rishikimit të Kurrikulit, procesin e zhvillimit profesional të mësimeve dhe ndërlidhur me këtë edhe hartimin e teksteve të reja shkollore.

Qëllimi kryesor është që në Republikën e Kosovës të tejkalohet qasja e shkollës memorizuese, kur nxënësit vetëm i memorizojnë faktet, mirëpo ta kemi një shkollë analitike ku fokusi do të jetë në mësimin e gjuhëve, mësimin e matematikës dhe në mësimin e IT. Po ashtu, dua t'ju informoj që qëllimi ynë është ta kemi një klasë e cila është shkarkuar nga lëndët e tepërta, meqë sot në një botë perëndimore praktikohet që njerëzit të marrin shkathtësi mendore, shkathtësi personale, shkathtësi të të nxënies dhe shkathtësi funksionale që të mësohen të funksionojnë në një sistem.

Deri më 1 shtator të vitit 2010 procesi i rishikimit të Kurrikulit dhe të teksteve shkollore do të përfundojë dhe jemi duke operuar me mundësinë, mirëpo është vetëm në rrafshin e mundësisë që ta hetojmë mundësinë e përkthimit të teksteve që nuk kanë të bëjnë me lëndët që i referohen identitetit të qytetarëve të Kosovës, lëndët e biologjisë, të matematikës nga gjuhët e tjera në gjuhën shqipe. Pra, Kosova, si treg i vogël realisht nuk e ka mundësinë që vërtet të ketë tekste kualitative dhe trend i fundit është që në vendet e zhvilluara perëndimore tekstet shkollore merren nga një vend që janë më të mira dhe përkthehen për nxënësit në atë vend.

Këshilli Shtetëror i Kurrikulit është i përbërë nga ekspertët më të mirë të Universitetit të Prishtinës, nga Fakulteti i Edukimit, Departamenti Pedagogjik dhe ekspertë ndërkombëtarë të cilët janë duke bërë një punë shumë të madhe që të kemi edhe tekste kualitative, mirëpo edhe një shkollë më të integruar, në të cilën mësimeve do të jenë në qendër të procesit mësimor. Pra, realisht nxënësi do të jetë në qendër të procesit mësimor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Pyetje shtesë?

NJOMZA EMINI: Pyetja shtesë: Çfarë plani dhe kriteresh do të ketë Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në këtë kontekst kur do të mund të vihet në dyshim mungesa e ekspertëve për hartimin e teksteve shkollore të standardizuara të lëndëve përkatëse të arsimit fillor dhe të mesëm? Këtu kemi parasysh edhe mungesën e recensentëve për këto tekste shkollore.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Standardet për hartimin e teksteve shkollore janë standarde evropiane edhe pse në Bashkim Evropian nuk ka një standard, për shumë fusha ka standard se si hartohet një tekst, mirëpo nuk ka standard për tekste shkollore, mirëpo kanë qenë ekspertë të Bashkimit Evropian që kanë punuar në Kosovë dhe tash do të fillojë zbatimi i standardeve të tilla.

Sa u përket recensioneve që bëhen për tekstet shkollore, ne mendojmë që në të ardhmen grupi i recensuesve nuk duhet të jetë i përbërë vetëm nga mësimeve tematik të një libri të caktuar, mirëpo duhet ta kemi parasysh edhe aspektin pedagogjik, do të thotë se sa në një proces mësimor vërtet pasqyrohen në mënyrën më të mirë në një tekst shkollor, sa është i kuptueshëm dhe se sa i përgjigjet moshës së nxënësit.

Po ashtu, dua t'ju informoj që ne si Ministri e Arsimit parashohim edhe hartimin e mjeteve mësimore shtesë ose të materialeve mësimore. Më lejoni të përmend që në një

botë moderne sot përdoret shpeshherë edhe shtypi i mirë për proceset mësimore nëse flitet për politika të ambientit dhe biologji. Një artikull i mirë i botuar në shtypin ditor shpeshherë e ka efektin shumë më të fuqishëm se sa një libër i cili është shumë teknik në përcjelljen e informatave dhe statik.

Qëllimi kryesor është të ketë tekste moderne dhe të ketë edhe një shumëllojshmëri, një lloj diversiteti në përdorimin e materialeve mësimore në shkollat e Republikës së Kosovës edhe në nivelin fillor edhe në nivelin e mesëm, tek shkollat profesionale ku kemi të bëjmë me profesione të ndryshme, kuptohet që aty jo patjetër tekstet kryen punë, mirëpo kryejnë punë doracakë të ndryshëm të cilët vinë shpeshherë edhe nga vetë ekonomia.

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputetja Edita Tahiri, pyetje për ministrin e Transportit dhe Postë- Telekomunikacionit, Fatmir Limaj. Meqë ministri nuk qenka këtu, a dëshironi ta bëni pyetjen? Deputetja Edita Tahiri.

EDITA TAHIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Nuk do ta bëj pyetjen, sepse desha që ministri të jetë këtu, por duhet të kihet kujdes që mos të vjetrohen apo fshihen, se ka ndodhur pyetja e pa vjetruar është hequr, ndodhin këto gjëra, por të gjendet një formë e menaxhimit më efikas, kështu që edhe ne të kryejmë punë, edhe ministrat mundësisht të jenë këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

E vetmja mundësi jona është që pyetjet t'i botojmë në Buletinin e Kuvendit. Kjo na është lënë në kompetencë, si Parlament, në Rregullore, mund ta kërkojmë. Deputeti Naser Rugova, nuk është. Deputetja Drita Maliqi, pyetje për ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Nenad Rashiq. A dëshironi ta bëni pyetjen? Nuk është. Deputetja Nerxhivane Dauti, pyetje për ministren e Drejtësisë, Nekibe Kelmendi.

NERXHIVANE DAUTI: Zoti kryesues,
Pyetjen do ta parashtroj në seancën tjetër.

KRYESUESI: Faleminderit!

I keni dy pyetje. Deputetja Gjylnaze Sylja, pyetje për ministrin e Shërbimeve Publike, Arsim Bajrami. Nuk është deputetja. Deputetja Synavere Rysha, pyetje për ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, Sadri Ferati, por ai mungon. Deputetja Sanije Aliaj, pyetje për Kryeministrin Hashim Thaçi. A dëshironi ta lexoni pyetjen?

SANIJE ALIAJ: Edhe ashtu s'po është në mesin tonë kur po na nevojitet.

Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi, Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione i adresohen peticione të vazhdueshme për shqyrtim, ku dominojnë çështjet që i shqetësojnë punëtorët e ndërmarrjeve shoqërore për shkeljen e së drejtës së punës dhe keqpërdorimin e pasurisë kombëtare.

Konkretisht, në takimin e fundit shqyrtuam peticionin e punëtorëve të Fabrikës së Tubave në Ferizaj, si dhe peticionin e punëtorëve të "Trepçës"

Institucionet e Kosovës kanë vendosur me një vendim në bazë të informacioneve që i kemi nga takimi i drejtpërdrejtë me hartuesit e këtyre peticioneve, se institucionet kanë

shpallur moratoriumin që të mos keqpërdoret pasuria kombëtare e “Trepçës” për tri vjet dhe përkundër kësaj “Trepça” s’mund t’i shmanget krizës globale dhe rënies së çmimeve të metaleve të çmuara. Pyetja është si vijon:

-Zoti Kryeministër,

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe një minutë.

SANIJE ALIAJ: Zoti Kryeministër, a është duke hartuar ndonjë projekt apo strategji Qeveria e Republikës së Kosovës së bashku me Drejtorinë e “Trepçës” dhe Agjencionin Kosovar të Privatizimit, në mënyrë që pas kalimit të këtij moratoriumi trevjeçar të mbrohet pasuria kombëtare e “Trepçës”? Le të jepet përgjigja në” Buletin”. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Arsim Rexhepi, nuk është, pyetje për ministrin Fatmir Limaj.

Deputeti Xhevdet Neziraj, pyetje për ministrin e Komuniteteve dhe të Kthimit, Nenad Rashiq. A dëshironi ta lexoni pyetjen?

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Në bazë të Rregullës 26 pika 2 të Rregullores së Kuvendit, bëj këtë pyetje për përgjigje me gojë në këtë seancë.

Zoti ministër,

Pasi viteve të fundit ka shumë pjesëtarë të komunitetit egjiptas që janë kthyer nga disa vende perëndimore dhe sidomos nga Gjermania, pyes: -Sa pjesëtarë të komunitetit egjiptas janë të kthyer, çka është duke bërë Ministria juaj, pra Qeveria për këta njerëz të kthyer të cilët po ballafaqohen me probleme si në rindërtimin e shtëpive, punësimin dhe probleme tjera sociale, ekonomike, arsimore dhe shëndetësore?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Poštovani gospodine poslaniče Neziraj,

Pitanje deportovanih, odnosno vraćenih lica jeste od važnih pitanja i zahteva odgovor svih relevantnih ministarstva u Vladi Kosova.

Međutim, to je pitanje međunarodnih dogovora i sporazuma koje se direktno tiče Ministarstva inostranih poslova i Ministarstva unutrašnjih poslova. Naravno, što se tiče Ministarstva zajednica i povratak, pošto se radi o građanima Kosova, međutim Ministarstvo zajednice i povratak isključivo se bavi pitanjem raseljenih lica tokom i nakon konflikta, takođe, njihovim povratkom, kao i integracijom istih.

Drugi deo pitanja koje se tiče pristupa javnim službama, naravno da pripadnici Egipćanske zajednice imaju isti tretman kao i pripadnici svih ostalih zajednica. Što se tiče ostalih problema koji su navedeni u vašem poslaničkom pitanju, postoji vladina strategija o RAE zajednicama, za integraciju, RAE zajednicima i svako rešenje na ove probleme može se naći implementacijom ove strategije. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!

A keni pyetje shtesë, deputet Neziraj?

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Ministri e bëri edhe një gabim. Pra, më vjen mirë që këtu janë 2 zëvendëskryeministrat dhe anëtarët e Komisionit Kushtetues. Dua të them që nuk ka "RAE -zajednice" po ka komunitete me radhë, siç janë të pranuar: serbë, shqiptarë, turq, egjiptianë dhe romë. Dhe, dua një herë edhe këtu publikisht t'ju them edhe juve si ministër, por edhe gjithë të tjerëve, edhe mediave elektronike dhe të shkruara. që nuk ka "RAE". Nuk di a është, po them edhe një herë, Agjencion Evropian apo çka është? Të gjitha komunitetet janë të pranuar edhe me ligj edhe me Kushtetutë. Kjo është e para.

E dyta, Zoti ministër, ju nuk keni shënime as për të kthyerit nga diaspora, po s'keni shënime as për të kthyerit nga Mali i Zi dhe Maqedonia. Për këtë shkak edhe Këshilli i Evropës kërkon nga ju databazë dhe nuk jeni në gjendje që ta formoni. Prandaj, nuk di pse Ministria për Komunitete merret me çdo gjë, por me komunitete jo, dhe do ta shtroj një nën pyetje: Pasi me komunitete nuk merret, atëherë me çfarë biznesi merret Ministria juaj?

KRYESUESI: Zoti ministër, keni koment?

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Ministarstvo zajednice i povratak se bavi pitanjima svih zajednica. Kada kažem RAE zajednice, mislim na zajednicu Roma, zajednicu Aškalija i zajednicu Egipćana i svi su uključeni u aktivnostima, odnosno sve aktivnosti Ministarstvo za zajednice i povratak se odnose prema svim zajednicima podjednako. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputetja Luljeta Shehu, pyetje për ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Enver Hoxhaj.

Ju lutem, shtypeni sustën kur ta merrni fjalën.

LULJETA SHEHU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Çështja është kjo: Maturantët e Gjimnazit "Gjon Buzuku" të Prizrenit, më 10.5.2009, pas përgatitjeve të bëra u nisën për ta përmbushur ekskursionin me karakter pune, të paraparë sipas planit dhe programit shkollor. Mirëpo, ndodhi e papritura, nxënësit bashkë me mësimmshënësit për 14 orë të plota u ndaluan në pikën kufitare Kosovë- Vermicë, për ta vazhduar udhëtimin falë këmbëngulësisë së tyre. Pyetja është, i nderuar ministër- Ku qëndron arsyeja dhe çfarë keni ndërmarrë ju si Ministri karshi kësaj përgjegjësie kur dihet se Ministria juaj ka mekanizma dhe udhëzime të ndryshme me të cilat është rregulluar çështja e ekskursioneve të maturantëve që kanë karakter pune?

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti ministër e keni fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

E nderuara zonja deputete,

Ne kemi qenë tërë kohën në kontakt me qeverinë komunale të Prizrenit, mirëpo edhe me pikën kufitare Kosovë – Shqipëri, në ato 14 orë sa kanë pritur nxënësit. Edhe pse një situatë e tillë nuk është përgjegjësi direkte e Ministrisë së Arsimit, kemi hartuar një udhëzim administrativ ku parashihet roli i komunave, i drejtorive komunale për arsim, i shkollave, i drejtorëve të shkollave në mënyrën e organizimit të ekskursioneve. Shkaku kryesor i pritjes së nxënësve në kufi ka qenë që kompania e cila ka qenë përgjegjëse për transport nuk ka pasur licencë dhe Shërbimi Policor i Kosovës është duke zbatuar Udhëzimin administrativ të Ministrisë së Arsimit në përpikëri. Pra, të gjithë ato kompani që nuk kanë licencë, realisht, nuk mund ta kalojnë kufirin. Po ashtu, kjo kompani nuk ka pasur sigurimin e paguar dhe është shkaktuar një situatë e cila vërtet ka qenë e panevojshme, mirëpo me intervenimin e Qeverisë qendrore dhe të zëvendëskryeministrit Kuçi edhe me intervenimin tonë, ne kemi mbërri që ata nxënës realisht të mos presin shumë gjatë në kufi.

Dua po ashtu t'ju informoj që para 5 javësh ne ua kemi dërguar një letër qarkore të gjithë kryetarëve të komunave sa i përket organizimit të ekskursioneve, të piknikëve, të shëtitjeve të ndryshme, meqë e kemi shqetësim që emocionet e nxënësve në fund të fitit shkollor dhe lëvizjet e tyre të shpeshta mund t'i kushtojnë shpeshherë dikujt edhe me jetë. Ministria e Arsimit do të bëjë përpjekje maksimale që të jetë pranë komunave, edhe pranë prindërve, edhe pranë nxënësve në situatat e tilla, edhe pse nuk është ndonjë përgjegjësi direkte jona që të merremi vërtet me organizimin e ekskursioneve, mirëpo do të bëjmë përpjekje maksimale që t'i respektojmë standardet se si organizohen ekskursionet.

Po ashtu, për çdo ekskursion që organizohet jashtë Republikës së Kosovës, Inspektorët e Ministrisë së Arsimit, inspektojnë kohën e ekskursionit, nxënësit, me qëllim që të ruhet shëndeti i tyre dhe t'i kalojnë sa më mirë këto ditë pushimi.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër,
A keni pyetje shtesë?

LULJETA SHEHU: Faleminderit!
Shpresoj që herëve të tjera nuk do të ketë pritje të tilla. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Zoti Tali, keni dy pyetje, s'ishit këtu, megjithatë kohë kemi, në qoftë se doni t'i lexoni, as Kryeministri nuk është këtu, nuk është as ministrja e Minierave, Justina Pula. Pra, zëvendëskryeministri nuk mund t'u përgjigjet pyetjeve të ministres. Po, deputet Tali, pyetja e fundit është.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!
Madje kjo pyetje është tamam për zëvendëskryeministrin. Pyetja është: Pse nuk respektohet infrastruktura ligjore në të cilën definohet saktësisht se sekretarët dhe kryeshefat ekzekutiv nuk mundën kurrsesi të jenë ushtrues detyre më shumë se 6 muaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti zëvendëskryeministër Kuçi, e keni fjalën!

HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti kryesues!
I nderuar deputet Tali,
Të nderuar deputetë,

Kjo është një e vërtetë, ngase ka qenë problemi ligjor në funksionimin e Këshillit për Emërime të Larta. Pas 15 qershorit të vitit të kaluar ka kaluar mandati i tre anëtarëve të këtij Këshilli nga ndërkombëtarët apo nga UNMIK-u dhe më pastaj nuk ka pasur bazë ligjore si të zëvendësohen. Ne kemi bërë një propozim në Kuvend dhe Kuvendi ka konsideruar që nuk ka arsye të bëjë një ndryshim të tillë. Tani jemi për një zgjidhje që kemi menduar t'i propozojmë ne, do t'i emërojë Presidenti dhe duhet të besoj që me miratimin e Ligjit për Qeverinë dhe për shërbyesit civil do të zgjidhet kjo çështje. Është punë ditësh që do të zgjidhet ky problem.

KRYESUESI: A ka pyetje shtesë? Jo.

Konstatohet që pika e dytë e rendit të ditës me pyetjet e deputetëve për ministrat përfundoi.

Vazhdojmë me pikën e tretë sipas miratimit të rendit të ditës, që në rendin paraprak të ditës të shpërndarë është nën tetë.

- Shqyrtimi i Raportit të Rregullatorit për Ujëra e Mbeturina

Komisioni Parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim, Rural dhe Planifikim Hapësinor në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës ka shqyrtuar Raportin e Rregullatorit për Ujëra e Mbeturina për vitin 2008 dhe ka rekomanduar shqyrtimin e tij në seancë plenare.

Raporti i Rregullatorit dhe Rekomandimi i Komisionit u është shpërndarë deputetëve.

Kryetari i Komisionit Funksional, zoti Lulzim Zeneli apo raportuesi i komisionit sipas radhës e ka fjalën. Nuk ka zëvendës, Lulzimi, si duket.

Kryetarët e komisioneve të përhershme e kërkojnë fjalën sipas radhës. Po ashtu, kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Zoti Koci e ka fjalën.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Nuk e kisha ndërmend të flas, sepse materialit u janë bashkëngjitur edhe rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe në këtë pjesë të këtij raporti Komisioni ka dhënë vlerësimet e veta se duhet të miratohet në Kuvend raporti i këtij agjencioni.

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Komisionit për Buxhet kjo ishte. Deputetja Elhame Hetemi, në emër të Komisionit apo?

ELHAME HETEMI: Në emër të Komisionit edhe si deputete.

KRYESUESI: Faleminderit!

ELHAME HETEMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe në emër të Grupit Parlamentar, gjithashtu.

Të nderuar deputetë,

Raporti i Zyrës së Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina është një raport i detajuar duke filluar nga korniza ligjore që rregullon këtë fushëveprimtari dhe duke përfunduar në punë praktike që zbatohen në terren.

Ky raport nxjerr në përfundim disa çështje që paraqiten si problematike në zbatimin e ligjeve ose paqartësi rreth kompetencave të organeve që zbatojnë ligjin.

Vlen të ceket se ligjet që kanë të bëjnë me këtë fushëveprimtari kanë kolizion njëri me tjetrin. Në këtë kontekst unë mendoj se nga ky raport mund të nxjerrim përfundime për t'i qartësuar këto kompetenca, në mënyrë që mos të paraqiten paqartësi që pengojnë në zbatimin e ligjit. Për shembull Ligji për mbeturina përcakton se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është autoritet përgjegjës për licencimin e personave juridikë që menaxhojnë mbeturinat. Kjo bie ndesh me dispozitat e ligjit 03/L-086 sipas të cilit licencimi i ofruesve të shërbimeve të mbeturinave është përgjegjësi e Zyrës së Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina.

Komunat në anën tjetër sipas Ligjit për mbeturina janë përgjegjëse për administrimin e mbeturinave në territorin e tyre dhe për përcaktimin e tarifave për shërbimet e mbeturinave.

Edhe kjo përgjegjësi e komunave bie ndesh me dispozitat e ligjit 03/L-086 sipas të cilit përcaktim i tarifave për shërbimet e mbeturinave është përgjegjësi e Zyrës së Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina.

Këtu kundërthënie paka shumë janë eliminuar me Rregulloren 2006/31 në të cilën është dekretuar Ligji për mbeturinat dhe e cila e ka konfirmuar përgjegjësinë e Zyrës së Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina me rregullimin ekonomik të ofruesve të shërbimeve të mbeturinave.

Megjithatë është e nevojshme që të harmonizohen këto dy ligje me qëllim të evitimit të paqartësive sa i përket rolit dhe përgjegjësisë institucionale në sektorin e mbeturinave.

Përderisa nuk ndodh ky harmonizim Zyra e Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina zbaton përgjegjësinë e vetë në bazë të ligjit nr. 03L/086 për licencimin e kompanive publike të shërbimeve të grumbullimit dhe të deponimit të mbeturinave, si dhe për përcaktimin e tarifave për kompanitë publike të grumbullimit dhe të deponimit të mbeturinave.

Sektori i Shërbimit të Ujit - Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina, ka konsideruar se ka nevojë të shqyrtohet, po ashtu, edhe çështja e përgjegjësive të komunave në lidhje me ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit e përcaktuar me Ligjin për vetëqeverisjen lokale. Me qenë se në praktikë kjo përgjegjësi është vështirë që të aplikohet, duke pasur parasysh se Republika e Kosovës është pronare e aseteve të ndërmarrjeve publike të ujësjellësit dhe kanalizimit në bazë të Ligjit për ndërmarrjet publike.

Të nderuar deputetë,

Zoti kryesues, unë mendoj se duhet të dalin rekomandime apo përfundime nga ky Kuvend që këto ligje të harmonizohen, në mënyrë që të mos bie ndesh njëri me tjetrin rreth kompetencave, paqartësive që dalin. Këtu kemi disa komuna të cilat kompanitë e shërbimeve të ujësjellësit dhe mbeturinave janë kompetencë e tyre. Një çështje tjetër që kisha dashur këtu ta ngre dhe nuk është në raportin e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina, është se në Kosovë, sipas raportit gojor në Komisionin funksional të drejtorit të Zyrës së Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina, kemi rreth 600 ujësjellës në zonat rurale të cilët, një pjesë e tyre janë të licencuar në një formë menaxhohen, ndërsa një pjesë tjetër janë të palicencuar dhe nuk kontrollohen. Duhet të ngritët si shqetësim dhe duhet t'u rekomandohet organeve kompetente, gjegjësisht Ministrisë së Mjedisit dhe

Planifikimit Hapësinor që në planin e saj të ketë edhe menaxhimin dhe kontrollimin e këtyre ujësjellësve, sepse nga këta ujësjellës furnizohen me ujë të pijes, pos tjerash, një numër i madh i qytetarëve të Kosovës.

Këtu ishin shqetësimet që desha për t' i ngritur. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Armend Zemaj është paraqitur.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,
Zëvendëskryeministra,
Kolegë deputetë,

Duke pasur parasysh se kjo zyre për herë të parë që nga themelimi paraqet raport të aktivitetit në Kuvend, ne si Grup mendojmë se i plotëson kushtet dhe kriteret e raportimit. Rëndësia e kësaj zyre është esenciale, sidomos në monitorimin dhe vlerësimin e performancës së kompanive të ujit dhe mbeturinave dhe përcaktimin dhe mbikëqyrjen e standardeve të shërbimit, rregullimi i raporteve ndërmjet ofruesve të shërbimeve dhe konsumatorëve.

Grupi Parlamentar e ka shqyrtuar, por ekzistojnë disa probleme në mes të komunave dhe Zyrës së Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina, për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, ndërsa ajo çka është më esenciale, është shumë e paqartë performanca e ujit të përdorshëm. Pra, ne mendojmë që nuk e kanë arritur nivelin e kënaqshëm, prandaj, kjo ka të bëjë edhe me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike dhe me Ministrinë e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor. Prandaj, edhe në raport nuk është e qartësuar përmirësimi i kësaj performance apo rezultatet devijojnë apo janë të ndryshme.

Vërejtje tjetër që ne mendojmë ka të bëjë shumë me humbjet e ujit, këtu hyn edhe kualiteti dhe shkalla e arkëtimit. Sipas ligjit nr. 03-L86, Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor është përgjegjës për hartimin e politikave dhe strategjive, prandaj, është shumë e domosdoshme që Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina dhe Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor të jenë në koordinim me njëra-tjetrën dhe ajo që është shumë esenciale, Ligji për ndërmarrjet publike që është në menaxhimin, domethënë Njësia për Politika dhe Monitorim në Ministrinë për Ekonomi dhe Financa.

Grupi Parlamentar i LDK-së i jep përkrahje dhe pret që edhe nga deputetët e tjerë të kenë vërejtje esenciale apo të domosdoshme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Haset Cakolli.

HESET CAKOLLI: Ju faleminderit, zoti Kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,
Të ndruajë kolegë deputetë,
Komisioni Parlamentar Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, më 5.5.2009 e ka shqyrtuar Raportin vjetor të Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina për vitin 2008 në praninë e drejtorit të kësaj zyre.

Debati rreth këtij raporti që është zhvilluar në Komisionin funksional, ka sqaruar shumë çështje të ngritura nga anëtarët e Komisionit dhe është konstatuar se kjo zyrë funksionon dhe i përmbush obligimet e parapara me ligj. Kjo zyrë ka për qëllim kryesor rregullimin e shërbimeve për ujëra dhe mbeturina të ngurta në mënyrë efikase dhe transparente në pajtim me praktikën më të mira evropiane, të cilat sigurojnë që ofruesit të shërbimeve të ujit dhe të mbeturinave, të japin shërbime kualitative me çmime të përballueshme për qytetarët e Republikës së Kosovës, por, njëkohësisht, duke mbrojtur shëndetin publik dhe ruajtjen e mjedisit.

Raporti për ujëra dhe mbeturina është gjithëpërfshirës dhe mjaft real i cili në të vërtetë paraqet gjendjen reale ekzistuese në terren që nuk është në nivelin e dëshiruar. Nga raporti mund të konstatohet se mbeturinat e ndryshme edhe më tutje nuk menaxhohen mirë dhe në mënyrë profesionale. Për shembull, vajrat e përdorura te automjetet, bateritë e ndryshme si dhe mbeturinat e ndryshme, fatkeqësisht përfundojnë nëpër kanalet e ndryshme.

Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor ka përgatitur 22 udhëzime administrative që e rregullojnë këtë fushë, por mungojnë inspektorët mjedisor në nivelin komunal që do t'i zbatonin këto udhëzime në praktikë.

Zyra e Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina ka përgjegjësi që të sigurohet kualiteti i ujit që iu ofrohet konsumatorëve nga kompanitë e licencuara të ujësjellësit dhe ai të jetë në pajtim me standardet në fuqi në Kosovë. Mirëpo, përcaktimin e standardeve dhe monitorimin e kualitetit të ujit e bën Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë. Nga tabela, në faqen 23 shihet se testet e bëra për kualitetin e ujit të pijshëm që nuk i kanë plotësuar standardet për vitin 2008, krahasuar me vitin 2007 kemi një përmirësim, do të thotë nga 3.2% në 3% në nivel të vendit. Ndërsa, testet e bëra në kompaninë “Bifurkacionin” në Ferizaj, tregojnë se kemi përkeqësim të kualitetit të ujit të pijshëm nga 4.4% sa ka qenë në vitin 2007, në 8.3 në vitin 2008 dhe unë mendoj se duhet të ndërmerren masa urgjente që kjo gjendje të përmirësohet sa më parë sepse përqindja prej 8.3% e testeve të dështuara është shumë e lartë. Edhe shkalla e arkëtimit nga kompanitë e licencuara për shërbimet e ofruara për qytetarët, është në nivel jo të kënaqshëm dhe paraqet vështirësi për kompanitë e licencuara. Prandaj, është e nevojshme edhe mbështetje nga institucionet relevante në kuptim të sundimit të ligjit dhe subvencionimit të pagesës për rastet sociale.

Problem shqetësues edhe më tutje mbeten humbjet e ujit të pijshëm që në vitin 2008 kanë qenë diku rreth 56%. Prandaj, Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të përgatis një plan strategjik për menaxhimin e ujërave dhe mbeturinave në Kosovë për një periudhë afatmesme dhe afatgjate me qëllim që të përmirësohet gjendja në terren në të ardhmen.

Raportin vjetor për vitin 2008 të Zyrës së Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina, Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re, në parim e mbështetë. Ju faleminderit, zoti Kryesues!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të AAK-së, do dikush ta marrë fjalën? Zoti Maloku!

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni Parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor e ka pasur Raportin në shqyrtim dhe e ka vlerësuar si një prej raporteve më të mirë që këto mekanizma të pavarura i sjellin në Kuvendin e Kosovës.

Si Grup Parlamentar i AAK-së mbështesim raportin. Do të votojmë pro dhe rekomandimet e Komisionit. Ju faleminderit, kryesues!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Ne emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, nuk është askush.

Grupi Parlamentar “7+”, zoti Murati.

DŽEZAIR MURATI: Hvala, gosopdine predsedavajući!

I mi u načelu podržavamo ovaj Izveštaj Kancelarije regulatora za vodu i otpatke, ali istovremeno konstatujemo da ova oblast na Kosovu još uvek nije dobila neki, ja mislim nacionalni strateški značaj u smislu pojašnjenja mnogobrojnih problema koji postoje na ovom planu. Recimo, u sredinama gde mi živimo, izazivaju veoma često nedoumice, rasprave i tako dalje, tako da želimo da se ova oblast pojasni i da se jasno naznače kompetencije kome da odlaze. Ljudi često lutaju između kompetencija lokalnih, saveznih običajnih pravila i tako dalje. Nadamo se da ćemo u periodu koji je pred nama shvatiti značaj koji imaju vode i da će sve to poprimiti legitiman i mislim zakonski oblik tumačenja, objašnjenja kako ne bismo, kao što je to do sada bilo, zavisili od nekih, ja bih rekao, nasledjenih problema i tako dalje. Dakle, insistiramo da se ova oblast malo više pojasni i da joj se posveti više pažnje jer za pitku vodu u svetu postoje ogromni interesi, posebno njen nedostatak, posebno to što nemamo stručno otpadne vode kako da ih odvajamo od onih koje se pitke, odnosno koje su industrijske i tako dalje. Tako, mislim da nam u ovoj oblasti predstoje ogromne obaveze.

Ja opet ponavljam, mi u načelu prihvatamo ovaj izveštaj, ali podržavamo i metodu da se o ovome malo više stručnog znanja i edukacije posvetimo na terenu. Hvala! Toliko.

KRYESUESI: Ju valeminderit!

Grupi Parlamentar SLS, zoti Halili,

HALILI: Dobar dan, gpospodine predsedavajući,

Gospodo ministri,

Dame i gospodo poslanici,

Ispred Parlamentarne grupe SLS želim da kažem da je ovaj izveštaj pozitivan, da postoji da je sveobuhvatan i da zadovoljava stanje u razvoju institucija na Kosovu.

Naravno, naša Parlamentarna Grupa želi da istakne potrebu za izradom jedne strategije za upravljanje vodom na Kosovu, jer je to strateški potrebno Kosovu. Iz toga, ovom prilikom želim da uputim predlog, znači naše Parlamentarne grupe, da se obrati pažnja i da ova komisija i sve nadležne institucije odrede jednu strategiju koja će pomoći razvoju i upravljanju voda i naravno otpadnih voda jer je to veoma bitno za očuvanje životne sredine na Kosovu.

Napominjem ponovo da ćemo mi kao Parlamentarna grupa podržati ovaj izveštaj jer je veoma pozitivan. Hvala!

KRYESUESI: Grupi parlamentar „Zajedno“ Vezira Emruš.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala ljepa!

Pozdravljam Predsedništvo i kolege poslanike. Pred sobom imamo po prvi put od strane Kancelarije Regulatornog ureda za vodu i otpad, skraćenica RUVO, po prvi put imamo izveštaj Komisije. Ova Komisija je formirana 2004. godine, znamo na osnovu Uredbe UNMIK-a 2004/49 i zatim na osnovu Zakona o vodama i otpadu, ova Komisija je nastavila da radi u ovom svom sastavu u kakvom je dala i opisala svoju odgazonu šemu, gde je dala i finansijski budžet iste te Kancelarije kji je u suštini 221 hiljada eura, od čega je finansirano od strane iste te Kancelarije Agencija sa 117 hiljada eura od strane Kosovskog budžeta i samo ima svoj doprinos, prihode od 17 hiljada eura.

Finansijski je održiva, dala je dobar prikaz oba sektora, kada je u pitanju sektor vode i sektor otpada, ali i namenski je dala svoje funkcije, sa funkcijom izdavanja licencije, praćenja kvaliteta vode, donošenjem uredba, medju institucionalna saradnja sa ministarstvima pod čijem je nadležnošću i smatramo da je, pošto prvi put dobijamo ovaj izveštaj, jedan od dobrih izveštaja, ali moramo da naglasimo kao grupa da se jako malo bavi kvalitetom vode, što je čini mi se i malo izbegnuto, nije dala do znanja, mi sve znamo ovde da nije ni dovoljno hlorisana voda, vidimo iz ove standardizacije da je voda ispod kaliteta. Znači, malo da kažem više da se da potencijal za kvalitet vode, jer ona je od jako velikog značaja, ne samo za životnu sredinu, nego i za život svih naših gradjana, kao i to da razvrsta i odgovornosti kada su u pitanju otpad i deponije i klasifikiranje otpada, što je isto to jako uočljivo na terenu kada vidimo da ta oblast nije organizovana institucionalno i oko toga bi trebalo da daje ova kancelarija ideje, da ima nacionalni plan i program kako da reši ove dve oblasti. U suštini smatramo da je izveštaj dobar i mi kao Grupa u suštini podržavamo ovaj izveštaj. Hvala puno!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës tani janë deputetët e paraqitur. Deputetja Myrvete Patina e ka fjalën.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Në përgjithësi mund të them se raporti i Zyrës së Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina është gjithëpërfshirës. Me të dhëna të shumta pasqyrohet gjendja në këtë sektor si dhe problemet me të cilat përballen sektorët e ujit dhe të mbeturinave. Por, mendoj se raportit i mungojnë rekomandimet konkrete për të ndryshuar gjendjen në këta sektorë, meqenëse ka humbje të mëdha të ujit, por edhe probleme në grumbullimin e të hyrave nga taksat e licencimit. Mirëpo këto rekomandime plotësohen nga rekomandimet e Komisionit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe Ambient.

Në raport ceket se në Kosovë nuk kemi të përcaktuara qartë politikat nacionale për sektorin e ujit dhe të mbeturinave. Mungesa e këtyre politikave dhe strategjisë së Qeverisë në fushën e ujërave dhe mbeturinave paraqet hendikep për zhvillimin e këtyre sektorëve, po ashtu, dhe për punën e Zyrës së Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina, për vetë faktin se me politikën dhe strategjinë qeveritare do të definohej korniza e investimeve të nevojshme që do të mundësonin që Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina të ketë punë më efikase.

Po ashtu, sa i përket të hyrave nga taksat e licencimit ceket se për vitin 2008 Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina ka faturuar kompanive të licencuara të ujit dhe të mbeturinave në emër të taksës së licencimit vlerën totale prej 802.906 euro, ndërsa, prej kësaj vlere të faturuar janë grumbulluar ose janë arkëtuar vetëm 208.000 euro. Pagesa

nga ana e kompanive të ujit ka qenë më e mirë – 85.8%, derisa problemi është më i madh tek kompanitë e mbeturinave, prej të cilave janë arkëtuar vetëm 13% të vlerës së faturuar të obligimeve të tyre ndaj Zyrës së Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina.

Edhe pse Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina ka të drejtë ta revokojë licencën e shërbimit në rast të mospagesës së taksës së licencimit, Zyra e Rregullatorit nuk e ka ndërmarrë një gjë të tillë, prandaj kërkohet që Zyra për Ujëra dhe Mbeturina të ketë vendim të prerë në mënyrë që të zbatojë në këto kompani obligimet e tyre.

Po të ishte arkëtimi më i mirë nga ana e këtyre kompanive si të ujit e sidomos të atyre të mbeturinave, do të ndikonte që ky rregullator të financonte shpenzimet e veta dhe do të kursehej buxheti i Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Diskutuesi i fundit, Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

Raporti i Zyrës së Rregullatorit për Ujëra dhe Mbeturina është raporti më komplet që i ofrohet këtij Kuvendi dhe kujtoj se duhet të jetë e të shërbejë si shembull për agjencionet e tjera të cilat i raportojnë këtij Kuvendi.

Natyrisht, u shfaqën edhe nga diskutuesit të tjerë shumë prej problemeve me të cilat përballet kjo zyrë. Unë do të përmend disa edhe një herë sa për t'i pasur në vëmendje, janë problemet me disa komuna ose paqartësi përkitazi me kompetencat që janë në mes të kësaj zyre dhe institucioneve të tjera. Po ashtu, konsideroj se Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina do të duhej të kishte parasysh edhe marrjen e licencave për kompani të cilat nuk i kryejnë detyrat dhe obligimet e veta, sikurse që parashihet. Për shembull, te mbeturinat, të cilat gjithnjë e dimë se në çfarë gjendje janë. Po ashtu, kjo zyrë duhet të ketë në konsideratë edhe mbrojtjen e konsumatorëve. Këtu kam parasysh shkyçjet kolektive që u bëhen furnizuesve nga ujësjellësi, e që janë si pasojë e mospagesës individuale të shpenzimeve. Zyra duhet të sigurojë shërbim të konsumatorëve pages dhe për këtë nevojitet edhe vendosja e ujëmatësve dhe jo të kemi pagesa paushall për të gjithë, pavarësisht sasisë se sa harxhojmë. Po ashtu, duhet të kihet në konsideratë edhe keqpërdorimi i ujit të pijes që te ne është me të madhe, në veçanti, nga ana autolarjeve në Kosovë, shumica nga të cilat furnizohen me ujin e pijes dhe natyrisht shkaktojnë probleme te qytetarëve. Ka nevojë për përkrahje kjo zyrë, që ta kryejë misionin e vet më mirë se sa deri tash. Natyrisht ka nevojë për përkrahje financiare, sikurse që duhet të kihet parasysh edhe me ligj krijimi i bordit për këtë zyrë, sepse të gjitha agjencionet e tjera kanë bord dhe është e vetmja zyrë e cila nuk ka bord. Megjithatë, konsideroj se ky raport duhet të mbështetet si i tillë dhe natyrisht nevojitet një përkrahje edhe ligjore më e madhe nga ana e Kuvendit të Kosovës, në mënyrë që zyra të jetë më e lirë në kryerjen e funksioneve të veta. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haziri, pas kohe je paraqitur, por urdhëroni!

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë desha, meqë zoti Makolli e përmendi pjesën e kryesore që desha edhe unë ta thosha, problemin që dua ta paraqes për shkak të prezencës së Qeverisë që zotëri zëvendëskryemistër ka të bëjë me dy çështje kritike sa i përket kësaj zyre. E para, pjesa teknike. Me vetë faktin se ka logon në gjuhën angleze, strukturën dhe angazhimin, tregon

qartë se ka nevojë të fillojë kujdesi dhe angazhimi konkret që kjo zyre të ristrukturohet e organizohet, sepse legjislacioni aktual e detyron vendimmarrjen në sektorin e ujërave, e ndanë, e bartë përmes Bordit të drejtorëve në nivel komunal dhe regjional edhe pse legjislacioni ynë... si organ i ri, por bashkimi i komunave në emërimin e bordeve të drejtorëve si vendimmarrës e rregullon këtë çështje mirë.

Sa i përket çështjes së menaxhimit të mbeturinave këtu është gjendja shumë e keqe.

Unë dua për t'ia bashkangjitur si pjesë rekomandimit tim se Qeveria me urgjencë derisa të ndërmarrë masa të tjera, ta shtojë kujdesin, sepse investimet në deponitë sanitare që kanë ndodhur në Kosovë po shkojnë në kolaps të plotë për shkak mosmenaxhimit të drejtë, mosmenaxhimit të mirë dhe problemin që e ka zyra e veçantë për menaxhimin e mbeturinave, zyra që është titullar në emër të Qeverisë, për t'u kujdesur.

Investimet e mëdha që kanë ndodhur në Kosovë në këto deponi janë shumë të shtrenjta si pjesë e investimeve kapitale mund të rrezikohen seriozisht nëse nuk menaxhohen mirë ose nuk kemi kujdes dhe raporti i borxhlinjve, raportet e paraqitura financiare dhe problemet e tjera nëse i shikojmë me kujdes do të shihni se ka probleme serioze në menaxhimin dhe organizimin sa i përket mbeturinave dhe deponive sanitare.

Sidoqoftë, unë desha vetëm t' i përmend këto dy probleme kryesore dhe le të fillojë Qeveria një kujdes më të madh, përmes ministrisë përkatëse në veçanti dhe kujdesit të vetë kryeministrit që në këto dy rrafshe mendoj se mund të përmirësohen derisa nuk ndërmarrë veprime të tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ju lutem prezencën e deputetëve. Diskutime të tjera nuk ka. Në sallë janë prezent 82 deputetë. Vazhdojmë me votimin e Raportit të Rregullatorit për Ujëra e Mbeturina për vitin 2008.

Regjia gati për votim dhe votojmë tani.

Konstatoj se me 81 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet Raporti i Rregullatorit për Ujëra e Mbeturina për vitin 2008.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës, në agjendën tuaj është shënuar si e nënta:

- Debati lidhur me privatizimin e procesit, sipas kërkesës së grupit të deputetëve

Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 6 prill 2009 me kërkesë të grupit të deputetëve ka kërkuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit që të përgatisë një informatë për procesin e privatizimit dhe të njëjtën t'ia paraqesë Kuvendit.

Kërkesa e grupit të deputetëve dhe Informata e Agjencisë Kosovare të Privatizimit iu është shpërndarë deputetëve.

Përfaqësuesi, sipas radhës, i grupit të deputetëve si propozues për debatin e ka fjalën për të debatuar për procesin e privatizimit, zoti Arsim Rexhepi.

ARSIM REXHEPI: I nderuar zoti kryesues, faleminderit!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolege dhe kolegë deputetë,

Me kërkesën time të mbështetur edhe nga një numër i konsiderueshëm i kolegëve deputetë jemi thirrur në bazë të Rregullës 6 pika 5 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës dhe kemi kërkuar që në debat, zoti kryesues, ne kemi kërkuar që në debat të marrë pjesë personalisht ministri i Ekonomisë dhe Financave, zoti Ahmet Shala dhe drejtori i Agjencionit, Dino Hasanaj.

Unë po e shoh që as njëri e as tjetri nuk janë këtu. Ju kisha lutur, edhe në emër të grupit që e ka sponsorizuar këtë kërkesë, për shkak të rëndësisë që e ka kjo dhe për shkak të interesimit shumë të madh që është në opinion, që ta bëjmë një pauzë, nëse është e mundur, t'i thërrasim këta dy zotërinjtë e kërkuar për të qenë të pranishëm në debat dhe të vazhdojmë pastaj pas një pauze. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ne kemi hyrë në pikën e rendit të ditës. Ne do të vazhdojmë debatin, në qoftë se ata nuk vijnë, është problem i tyre. Ata kanë qenë të njoftuar për debatin e sotëm dhe ne do ta vazhdojmë atë debat. Kryetari i Grupit Parlamentar, për procedurë, nëse ka diçka ose nëse je i autorizuar.

(Reagim)

Do me thënë, Parlamenti nuk mund ta detyrojë as ministrin, as Kryeministrin dhe as atë që të vijë në debat. Ne e kemi ftuar. Data e debatit është caktuar, kurse ne mund edhe të mos diskutojmë.

(Reagim)

Po, për çka e ke fjalën, Emrush? Mirë, ne mund ta shkarkojmë, por jo ta detyrojmë. A po paraqitesh për pikën në fjalë të rendit të ditës?

(Reagim)

Po, urdhëro zoti Emrush Xhemajli, një minutë për procedurë.

EMRUSH XHEMAJLI: Shikoni, këtu prej grupit të deputetëve nënshkrues është bërë kërkesë për debat për procesin e privatizimit në Kosovë. Edhe këtu, sipas asaj që duhet të marrin pjesë ministri i Ekonomisë e të Financave edhe drejtori, Dino Hasanaj, gjithashtu, edhe për faktin se këtu ceket qartë se duhet sqaruar edhe për ndërmarrjet publike, nuk ka informatë fare për ndërmarrjet publike. Është vetëm pjesa e informatës për ndërmarrjet që privatizohen sipas AKP-së, kështu që këtu duhet të vijë edhe pjesa tjetër e informatës. Nuk është e saktë dhe nuk është e plotë. Prandaj, ju kisha lutur që të sillet edhe pjesa tjetër. Kjo është kërkuar, le të bëhet edhe çka është kërkuar.

KRYESUESI: Vazhdojmë me debatin. Unë nuk e ndërpres seancën dhe ju kisha lutur që të fillojmë sipas renditjes me kryetarët e grupeve parlamentare. Kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së nuk dëshiron për të diskutuar.

(Reagim)

Kush e kërkon? Po, silleni me shkrim. Unë nuk mundem përmendësh të punoj dhe shikoni, nuk është Parlamenti këtu për të bërë shaka dhe kush çka të dojë të propozojë. Është një proces i cili ka kaluar dhe kërkesa juaj ka kaluar nëpër komisionin përkatës, ka kaluar në Kryesi, është prezent në mbledhjen në Kryesi kur është miratuar rendi i ditës, kanë qenë edhe kryetarët e grupeve parlamentare dhe tani nuk e marr parasysh asnjë lloj kërkesë tjetër. Kush do të diskutojë, le të diskutojë. Mund ta përsërisni kërkesën për debat në variantin tjetër dhe në radhën tjetër. E ka fjalën, sipas radhës, kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit!

Kërkesa ka të bëjë me një grup deputetësh. Mocioni është miratuar nga Kryesia sipas procedurës që ka ardhur. Zoti kryesues, nëse nuk vijnë dy autoritetet në këtë debat nuk ka kuptim. Nëse ky Parlament nuk ka autoritet t'ua caktojë kohën e ardhjes së këtyre dy autoriteteve, atëherë ne nuk kemi kuptim të debatojmë. Unë nuk mund të flas në emër të grupit të deputetëve, sepse nuk e kam mbështet mocionin e tyre. Nuk është kërkesë e Grupit Parlamentar, parimisht po flas. Ne qëndrojmë prapa procedurave, angazhimeve dhe obligimeve që kemi si institucion. Nëse ata nuk kanë kohë për të ardhur ose nuk kanë qenë të informuar, s'besoj që nuk kishin për të ardhur, por s'kanë qenë të informuar që të vijnë, atëherë le të shtyhet për një termin tjetër, për një angazhim tjetër. Edhe ashtu u shtyn shumë pika, por ajo më e vogla që mund të bëjmë mund ta lëmë pas miratimit të ligjit për FMN- që ministri duhet me qenë patjetër këtu, ose zëvendëskryeministri që prezenca e tij mund ta mbulojë këtë ligj. Pas miratimit të këtij ligji duhet parë a ka mundësi të mbahet a jo. Në të kundërtën, këta mund të debatojnë dy- tre deputetë, mbyllet debati me kaq dhe asgjë kurrkujt. Nuk mund të them asgjë tjetër më shumë.

(Ndërhyrje)

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së kush do të flasë? Shkumbin Demaliaj e ka fjalën.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Përkrahim plotësisht çka tha parafolësi më herët, zoti Lutfi Haziri, kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së, mirëpo me mundësi vazhdimi edhe në qoftë se vjen ministri edhe pas kësaj pike të rendit të ditës, që e kemi të radhës.

KRYESUESI: Atëherë, ne duhet ta kemi parasysh se në emër të Agjencisë Kosovare të Privatizimit nuk merr pjesë në debat- kryetari, sepse nuk është e drejtë e tij të marrë pjesë në debat. Për debat janë institucionet e caktuara të cilat vijnë. Meqenëse kërkesë e deputetëve është që të vijë e të jetë prezent ministri i Ekonomisë dhe Financave, unë duhet t'ju njoftoj se ministri i Ekonomisë dhe Financave është në një takim shumë të rëndësishëm, i cili është duke e nënshkruar një marrëveshje protokollare....

(Ndërhyrje e deputetëve)

Ju lutem, atëherë, propozoj një pauzë për drekë deri në orën 14:00, me qëllim që të miratohet edhe ligji e pastaj të vazhdojmë debatin.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Të nderuar deputetë,

Kushtet për të vazhduar debatin janë plotësuar, por paraprakisht dua t'ju njoftoj se Kryesia e Kuvendit të Kosovës gjatë pauzës ka mbajtur një mbledhje të saj. Sot gjatë pauzës së kësaj seance shqyrtoi propozimin e Grupit Parlamentar të AAK-së për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe vendosi që Kuvendin ta njoftojë gjatë kësaj seance. Pra, fjala është për zëvendësimin e deputetit Xhevdet Neziraj me deputetin Haki Shatri, për anëtar të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Vazhdojmë me debatin e filluar më herët. Ka mbetur pa folur shefi i Grupit Parlamentar të AAK-së. Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini është paraqit, nuk është këtu. Lidhur me informatën e Komisionit për privatizim të Kosovës, zoti Maloku është paraqitur.

NAIM MALOKU: Faleminderit, zoti kryesues!

Më lejoni që në fillim të përgëzoj në emër të Grupit Parlamentar deputetët e nënshkruar që kanë kërkuar që kjo çështje të vihet në debat në njërin për seancave të Kuvendit të Kosovës.

E dyta, zoti kryesues dhe të nderuar deputetë, më lejoni që...

(reagime nga salla)

KRYESUESI: Veç ta pyes Naimin, A do të vazhdosh, apo je dakord ta ndërpresësh dhe t'ia lësh fjalën ...

NAIM MALOKU: Zoti kryesues,

Sipas Rregullores së Punës së Kuvendit, nëse është kërkuar që të jetë ministër dhe debati është shty, ishte dashur një prej kërkuarëve, një prej iniciuesve të flasë. Unë propozoj që të flasë zoti...

KRYESUESI: U krye, u krye. Vazhdo, zoti Rexhepi!

ARSIM REXHEPI: Faleminderit, shumë zoti kryesues!

Faleminderit për mirëkuptim!

I nderuar zoti kryesues,

Kabinet qeveritar,

I nderuar zoti ministër,

Kolege deputete, kolegë deputetë,

I vetëdijshëm se ky terren paraqet kontekst shumë të minuar dhe të rrezikshëm për t'iu qasur, të pa qasur deri më sot, bashkë me një grup deputetësh nga të gjitha partitë e mëdha në këtë Kuvend, iu përkushtuan idesë për të sjellë këtë çështje në debat në Parlament.

Shumë kujt ka mund t'i tingëllojë si një përpjekje e kotë kjo, një aventurë e gjykuar për të dështuar në një kuvend dhe në një kohë të cilëve ju mungon debati. Dikush prej nesh edhe mund të ketë dyshuar që me rastin e nënshkrimit të kësaj kërkesë, jo në faktin se kjo kërkesë do të mund të mos zinte vend në njërin nga seancat e radhës, se kjo me gjithë vonimin disa javorë tash po ndodh, por në faktin se tema që parashtron kjo kërkesë për debat është më e ndjeshmja që mund të sfidojë këtë Kuvend dhe Qeverinë.

Kjo kërkesë ka për qëllim zbardhjen e mekanizmit tjetërsues të pasurisë së vendit tonë, e cila me djersë, me mund dhe flijim të etërve tanë është krijuar, madje në një realitet dhe në një shtet aspak miqësor për këtë popull.

Ky mocion synon të kërkojë të vërtetën e shumë kërkuar nga të gjithë qytetarët e këtij vendi. Si janë tjetërsuar e privatizuar, nga kush, kur, në çfarë kushtesh njësitë ekonomike të Kosovës, si po funksionojnë ato tani, a i kanë përmbushur kushtet e kontratave të privatizimit dhe, po ashtu, si po vazhdojnë të privatizohen njësitë tjera ekonomike të Kosovës.

Ju, të nderuara kolege, të nderuar kolegë, keni pranuar një, ta quajmë, si njoftim për gjendjen e tanishme dhe punën që mund të jetë duke u bërë nga AKP-ja, njoftim ky i nënshkruar nga kryetari i Bordit të drejtorëve. Dhe, besoj që edhe ju, sikur unë, nuk jeni iluminizuar dhe nuk keni zgjeruar më shumë horizontin tuaj të njohurive.

Për më shumë se njoftim, ky është edhe një nga ato të ashtuquajtura raporte të radhës, që nënçmojnë këtë parlament, që nënçmojnë demokracinë e këtij vendi, që nënçmojnë në këtë rast edhe këtë pak qetësi sociale që mbretëron në Kosovë.

Raportin po e quajmë, kushtimisht raport më kujton Pontio Spilatin, qeveritarin romak të Jerusalemit, që kur e sollën Krishtin për ta dënuar, në mungesë të fakteve fërkoj duart edhe kërkoj ujë për t'i larë duart dhe ua dha Krishtin rabinëve që ta dorëzonin.

Dhe, ky raport s'thotë gjë tjetër veç se ne nuk dimë çka ka ndodhur para nesh, ne nuk kemi fakte se çka kanë bërë ata para nesh, ne nuk kemi ide se ç'është bërë me privatizimin, të tjerët e kanë gozhdur ekonominë e Kosovës. Kështu thotë kjo letër e drejtorit të AKP-së, i cili nuk është i pranishëm në këtë sallë.

Janë djegur dokumentacionet, s'ka arkiv, kështu dëshiron të klith kjo letër dhe të shndërrojë në fakt një inskenim makabër për gjëja mungesën e Arkivit të privatizimit.

Por, përtej pyllit të kësaj gënjeshtre dhe përtej duarve të pilatëve, ky Parlament, të nderuar kolegë dhe kolege, duhet të besoj në të vërtetën që e kërkojnë i gjithë populli. Ne duhet të besojmë se mund dhe duhet të gjejmë një përgjigje për ekonominë e shkatërruar të Kosovës, për qindra mijëra të mbetur pa punë pikërisht nga ky proces famëkeq.

Zonja dhe zotërinj,

Unë vijë nga Drenica, nga fshati Gofile dhe dajat i kam aty afër, në fshatin Fortesë. Të dyja këto fshatra janë plot fëmijë jetimë nga gjenocidi i fundit serb, plot me pleq dhe plaka që e ngrysin jetën e tyre në varfëri dhe dhembje të thellë. Plot me gra të veja që me thërime i risin fëmijët, dëgjo mirë Gani se ty të bien më së shumti të dëgjosh, ka Prellopç, Gofile tash po i thonë. E di unë katundin tim. Plot me gra të veja, jo veç kishte qenë mirë më shumë të dëgjoni se të ndërhyini, plot me gra të veja që me thërime i rrisin fëmijët e tyre, student që nuk kanë të holla për të ardhur në Prishtinë në ligjërata, njerëz të papunë gjithandej. Ata të gjithë pyesin, siç më pyesin edhe bashkëqytetarët e mi në Vushtrri, çka po ndodh me privatizimin dhe si është puna me të, si po ndodh që ne të varfrit të bëhemi edhe më të varfër dhe të pasurit edhe më të pasur. A ka qenë kjo ëndrra e atyre që kanë rënë për këtë vend, a ka qenë kjo ëndrra e heronjve tanë.

Procedurat e privatizimit të të mirave ekonomike të popullit të Kosovës kanë qenë të zhvilluara larg nga veshi dhe syri i qytetarit të Kosovës, shumë nga njësitë e privatizuar shënojnë procedurat e pakëndshme dhe jo transparente. Po ashtu, edhe rezultatet e dala nga shumica e privatizimeve në Kosovë janë më se të pakëndshme dhe lënë vend për dyshim.

Numri dërmues i kontratave të privatizimit shënon mosplotësim të obligimeve të dala nga kontratat. Rasti më eklatant, të nderuara kolege dhe të nderuar kolegë, është Ferronikeli në Drenas. Ne e patëm dje raportin e tij. Një shitje shumë madhore dhe me interes kombëtar, e cila është privatizuar me një çmim dhe kushte përçmuese për vendin tonë, në krahasim me rajonin.

Madje, kontrata e privatizimit e kësaj njësie është aq e dëmshme për ekonominë kosovare, sa vetëm nga shfrytëzimi i tarifave speciale të furnizimit me energji, ekonomia kosovare dëmtohet për çdo vit me miliona euro.

Po ashtu, ndotja e ambientit në një rreze prej 50 kilometrash katrorë nga tymtarët e kësaj fabrike është aq e madhe dhe e rrezikshme për jetën e banorëve dhe të trevave përreth, sa që pasojat do të jenë të paimagjinueshme. Jo zyrtarisht mësohet se në këta tymtarë të Ferronikelit nuk funksionojnë filtrat, gjë që rezulton që në ajër dhe në ambient lirohet përveç plumbit, dioksid karboni dhe një sasi e materieve radioaktive, të cilat në planin afatgjatë mund të ndikojnë shumë rëndë në shëndetin e brezave që vinë. Deri më sot askush s'ka denjuar të bëjë një kontroll të kësaj problematike.

Një dhembje tjetër për ekonominë kosovare është, po ashtu, edhe puna me Llamkosin në Vushtrri, i cili për shkak të mosdefinimit të pronarit dhe të çështjeve tjera jotransparente në kontratë, ka dështuar si privatizim, duke mos shënuar asnjë investim, asnjë përparim dhe në fund duke përfunduar si një dizastër ekonomik, me ç'rast janë goditur 470 punëtorë të asaj ndërmarrjeje. Për procesin e tanishëm, për ritenderimin e Llamkosit duhet pa tjetër të ndodh e të shënoj një transparencë së paku në këtë kontest.

Një dhembje tjetër e kësaj natyre është sidomos privatizimi i tokave bujqësore dhe I njëjësive gastronomike anekënd Kosovës, të cilat janë një dëshmi në vazhdim të një procesi të dështuar. Ne kurrë nuk e kemi kuptuar, as ju dhe as unë, si deputet, me gjithë kërkesën time ku kam shkuar personalisht në AKP, se kush ka privatizuar x tokën e kooperativës y. Përveç kësaj, çmimi për metër katror i privatizimit të këtyre tokave është për çdo dyshim dhe me një nënçmim i radhës që i bëhet vegjëlisë në Kosovë.

Në prag janë privatizimet e mëdha: KEK-u, PTK-ja, ANP-ja e kështu me radhë. Për të fokusuar interesimet tona në këtë proces jetik dhe për të vënë gishtin mbi një çështje vendimtare për ekonominë e vendit tonë, ne me këtë rast...

KRYESUESI: Faleminderit!

Sipas radhës, në radhë është Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, kryetari i grupit apo dikush tjetër në emër të grupit do të thotë diçka lidhur me këtë? Jo! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës? Jo! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, zoti Pacolli.

BEHXHET PACOLLI: I nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë,

Ky debat është shumë me vend dhe sigurisht meriton respekt më të madh. Si e dini, privatizimi në Kosovë ka shkaktuar dëme të mëdha të pariparueshme deri tani, ka gjeneruar varfëri, papunësi, mos kënaqësi, rënie ekonomike dhe, sigurisht, konsekuencat do të jenë edhe më të mëdha në të ardhmen.

AKR-ja është gjithmonë në monitorim të situatës në Kosovës dhe në theksim të vazhdueshëm të programit të vet. Çdo ditë shikon, nënvizon gjërat që duhet të bëhen dhe ato që janë bërë.

Programi ynë ia kushton një hapësirë të konsiderueshme privatizimit. Ka pasur disa debate me qytetarët dhe jemi munduar edhe këtu të potencojmë në Parlamentin e Kosovës problematikën e privatizimit, si duket, pa sukses.

Është dashur të procedohet si duhet me privatizimin dhe është dashur të mendohet mirë çka dëshirojmë të arrijmë me privatizim. Çka dëshirojmë të prodhojmë, çka dëshirojmë të gjenerojmë. Nuk kemi studiuar kujt ia shesim objektet tona shoqërore, ku prindërit tanë, veteranët tanë punuan me ndjerës dhe i ngritën ato. Askush s'ka menduar që të kërkojë prej blerësit një fizibilitet ekonomik, ku shihet si do të financojë ai person ose subjekt blerjen e objekteve, si mendon ta rindërtojë atë, gjegjësisht ta fus në prodhim, dhe si mendon të ruaj vendet e punës ose të gjenerojë vende të punës.

Prandaj, ne në Kosovë, në vend se të kemi rritje dhe zhvillim ekonomik, stimulim të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, zbutje të varfërisë, rritje të punësimit, ne kemi pasur të kundërtën. Dhe, privatizimi si i tillë nuk shënon kurrfarë impakti pozitiv, po të kundërtën, impakt negativ, gjeneroi varfëri, papunësi, korrupsion e shumë gjëra të tjera të pahijshme, që nuk i ka hije një shoqërie civile të shekullit njëzetentë.

Nuk studiohet fare kujt po ia shesim ndërmarrjet tona, nuk u kujdesëm kush është blerësi i tyre dhe çfarë fuqie ka ai. Ne ia morëm paratë atij pa e pyet se a i mbetën atij ende para që të rimëkëmbë atë që e bleu. Nuk e bëmë atë, prandaj sot ndërmarrjet tona janë shndërruar në hangarë të ndryshëm, janë shndërruar ndoshta edhe në salla të bixhozit dhe të lojërave të fatit.

Nuk ishim në gjendje që të kërkonim një fizibilitet ose, si ta quaj, një faktibilitet ekonomik si, sa, kur dhe çka do të gjenerohet prej atij privatizimi.

Nuk vlerësuam fare çka shesim, sa është vlera e tij, sa ka kushtuar, çka përmban ajo që shesim dhe për sa do ta shesim. Nuk punuam me blerësit potencial, ne zgjodhëm vetëm çmimin më të lartë dhe nuk u morëm fare me atë se çka do të ndodh. Nuk i ndihmuam blerësit fare që ai të fus në përdorim atë që e bleu. Prandaj, sot fëmijët tanë, gjeneratat e reja kanë të drejtë të na fajësojnë dhe të na thonë se ne nuk kemi punuar për interesin e tyre.

Krejt kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së një platforme ligjore. Sot Kosova ende nuk posedon një platformë ligjore dinjitoze që rregullon privatizimin, gjegjësisht marrëdhënien e operatorëve të privatizimit. Sot ne vetëm kemi dëgjuar ndoshta prej mediave thashetheme dhe nuk e dimë as çka do të thotë procesioni, as çka do të thotë biote, që është, do të thotë, ngrite, futu në prodhim dhe transferoje, nuk dimë si bëhet komercializimi, ne e kemi ditur vetëm një gjë - të shesim, të marrim para dhe t'i harxhojmë ato, impakti për gjeneratat e ardhshme zero.

Prandaj, edhe një herë ju them se gjeneratat e reja nuk do të përfitojnë, gjegjësisht nuk kanë përfituar asgjë prej asaj çka etërit, vëllezërit, motrat e tyre me ndjerës e ndërtuan.

Si tha parafolësi, jemi tani në një fazë kur duhet të ndodhë diçka e madhe dhe ato pak objekte shoqërore, publike që kanë mbetur, tentohet të privatizohen në të njëjtën mënyrë, pa impakt pozitiv për shoqërinë. Prandaj, unë e them edhe një herë, para se të bëhen këta hapa, të mendohet dhe së shpejti të kontraktohet dikush që di ta përpilojë Ligjin mbi privatizimin e ndërmarrjeve publike. Ne sot nuk kemi as Ligj për shoqëritë aksionare, as Ligj për letrat me vlerë, as Ligj për emetimin dhe ekzistencën e aksioneve, as Ligj mbi tregun e aksioneve, nuk kemi Ligj mbi themelimin dhe funksionimin e bursës, përcaktimin e vlerës reale të faktorëve ekonomikë.

Prandaj, ne kemi folur, ia kemi filluar prej së larti e teposhtë, është dashur të bëhet e kundërta, kemi folur për Ligjin e shpronësimit, që edhe ai mungon tani, mirëpo është dashur disa ligje të tjera të rregullohen e mandej të flitet, të rregullohet edhe Ligji i shpronësimit e të procedohet më tutje me privatizimin e ndërmarrjeve publike. Kjo është dashur me të vërtetë të ndodhë qysh para privatizimit, por tani e them, të ndalemi këtu dhe të mendojmë pak. Ne nuk guxojmë të trajtojmë këto objekte publike si Aeroporti, KEK-u e tjera, ashtu siç kemi trajtuar me objekte shoqërore deri tani.

Por, insistoј dhe Grupi im Parlamentar insiston që sa më parë të procedohet me hartimin e Ligjit mbi privatizimin, ligj ky që do të rregullojë marrëdhëniet e të gjithë faktorëve që kanë të bëjnë me privatizimin.

Prandaj, edhe një herë insistoј që privatizimi mos të jetë vetëm punë, gjegjësisht monopol i Qeverisë, por ai të trajtohet si pronë, gjegjësisht monopol i krejt kosovarëve, e sidomos të gjeneratave të ardhshme. Çka përfitojnë gjeneratat e ardhshme prej asaj që u bë deri tani, sa shkolla ngritëm ne deri tani me paratë e privatizimit, sa spitale i ngritëm deri tani me ato para dhe, në fund, kisha për të pyetur - ku janë ata para? Ato gjenden diku jashtë dhe gjysma e tyre më duket se kanë humbur nëpër fonde të ndryshme investive për shkak të krizës ekonomike. Askush nuk është në gjendje sot të thotë diçka. Dhe, unë insistoј prej këtu që ...

KRYESUESI: E do edhe një minutë? Në qoftë se do ta përfundojë, edhe një minutë deputetit Pacolli.

BEHXHET PACOLLI: ... do të insistoј që të dija sa më parë, të dimë çka ka ndodhur me të vërtetë me privatizimin, gjegjësisht me paratë që janë grumbulluar prej privatizimit. Kujt janë duke i shërbyer ato, ku gjenden ato, sa kanë mbetur, sa keni humbur dhe, ajo çka është me rëndësi, Qeveria paraqet një ligj sa më parë në Parlament, jo për privatizimin e ndërmarrjeve publike, por për hartimin e bazës ligjore për privatizimin e ndërmarrjeve publike që kanë mbetur shumë pak për të privatizuar dhe gjeneratat e ardhshme prej kësaj të kenë një interes, gjegjësisht të përfitojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Pacolli!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, më parë e pati fjalën zoti Maloku.

NAIM MALOKU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që të përgëzoj, siç thashë më parë, grupin e deputetëve që e kanë iniciuar këtë çështje që të vijë në debat në Kuvend të Kosovës. Unë ftoj deputetët për një qasje serioze këtij debati.

Zoti kryesues,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që vetëm të citoj disa fjali të informatës që e kemi marrë nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, faqe 1, pasusi i parafundit. “Kjo ka shkaktua që Agjencia e re të përballet me vështirësi të jashtëzakonshme, sepse gjendjen në të cilën kemi hasur është që nuk ka pasur asnjë pajisje në zyrat e selisë, kemi hasur në gjurmë të dokumenteve të djegura, në dokumentet të ndryshme të hedhura, dhe më brengosëse ka qenë fakti se ka munguar i gjithë dokumentacioni i vendimeve të Bordit të drejtorëve të ish AKM-së” .

Të nderuar deputetë,

I nderuari zoti kryesues,

Vetëm kjo çka lexova unë kishte për të qenë fakt për një shtet ligjor që të ngrihen hetime dhe të merret policia hetimore me të gjithë ata që kanë punuar me Agjencionin Kosovar të Privatizimit. Është fakt se AKM-ja, Agjencioni Kosovar i Privatizimit, aktual, Bordi i tashëm, nuk ka faj dhe nuk mund të fajësohet për punën e ish-AKM-së, pra këtu duhet të ketë një ndarje të qartë të përgjegjësi.

Më lejoni të citoj nga raporti në faqen 2, pasusi i parafundit: “Më duhet të them se fillimisht kemi vërejtur defekte nga e kaluara, pra nga ish AKM-ja, që kryesisht kanë pasur të bëjnë me një parakualifikim dhe selektim të dobët të investitorëve potencialë dhe eventualisht të pronarëve të... të këtyre ndërmarrjeve, të privatizuara me anë të spinoffit special, që ju ka mundësuar blerjen e këtyre ndërmarrjeve në disa raste edhe kompanive që nuk kanë ndonjë ekspertizë të caktuar në lëmitë përkatëse”.

I nderuari kryesues,

Vetëm këtë çka e lexova unë kishte për të qenë për një shtet ligjor argument i mjaftueshëm që të thirren para drejtësisë të gjithë ata që kanë punuar me AKM-në dhe që janë marrë me privatizimin dhe, mund të them, i kanë bërë dëme të paimagjinueshme sektorit shoqëror dhe ekonomisë kosovare.

I nderuari zoti kryesues,

Të nderuar deputetë,

Në faqen 3 për privatizimin e Ferronikelit ka 7 rreshta, për një prej aseteve më të çmueshme që i ka pasur Kosova dhe që ka dalë nga lufta pa obligime financiare. Ka qenë 100% pronë e Kosovës. Janë 7 rreshta në faqen e tretë si informatë që i jepen Kuvendit të Kosovës dhe aty thotë: 20 milion euro kanë qenë të parapara për investime, 1000 punëtorë të punësuar, janë raportuar 59 milion euro investime nga investitori ose blerësi, pa na dhënë informacion se cilat asete janë shitur të Ferronikelit, çka është shitur në Ferronikel, cilat janë marrëveshjet e Ferronikelit me KEK-un, cilat janë dhe çfarë marrëveshje është me hekurudhat e Kosovës, sa shkojnë këto në dëm të buxhetit, sa humb buxheti i Kosovës me afarizmin aktual të Ferronikelit? Nuk bëhet fjalë për fitim, sa humbin, sa investojmë ne sot në Ferronikel sot. Pra, kur merret parasysh sa humbje ka KEK-u dhe që të plotësohet nga buxheti i Kosovës, kur merret parasysh sa humbje ka

Hekurudha e Kosovës dhe që plotësohet nga buxheti i Kosovës, pra sa humbje, sa investohen nga buxheti i Kosovës në afarizmin e Ferronikelit?

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së të kërkoj, si vijon: që në fund të këtij debati të kërkohet informatë e saktë si është privatizuar Ferronikeli dhe kjo të silltet në Kuvend. Cilat asete janë shitur, cila ka qenë dhe si ka qenë marrëveshja, ne nuk e kemi ende as opinionin, as Kuvendi i Kosovës nuk e dinë marrëveshjen e privatizimit të Ferronikelit. Të na silltet në Kuvend marrëveshja e Ferronikelit aktual me KEK-un, kush e ka bërë, kush e ka nënshkruar dhe si është raporti i çmimi dhe sa humb KEK-u në këtë marrëveshje. Të silltet marrëveshja e Ferronikelit aktual me hekurudhat e Kosovës dhe, normalisht, të silltet raporti i Ministrisë për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor se si është mbrojtja e ambientit, pra e ajrit dhe ndotja e ambientit në rrethinën ku funksionon Ferronikeli. Dhe, kërkoj që në fund të këtij debati të kërkohet urgjentisht ndarja e 20% punëtorëve, pra të ish punëtorëve të të gjitha ndërmarrjeve të cilët kanë punuar dhe të cilat janë privatizuar.

Unë kërkoj pra, i nderuari zoti kryesues,
Të nderuar deputetë,
që me këto kërkesa të mbyllet ky debat dhe me një afat të caktuar që këto informacione t'i marrim nga organet kompetente të cilat duhet t'i raportojnë Kuvendit.

Dhe, në fund, kërkoj dhe duhet të kërkojë ky Kuvend rolin e secilit veç e veç, pra, në krejt storien apo tregimin e AKM-së dhe punën që e ka bërë gjatë krejt funksionimit të saj. Faleminderit, kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Maloku!
Fjalën e ka në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputeti Blerim Ramosaj.

BERIM RAMOSAJ: Faleminderit, zoti kryesues!
Veç një përmirësim gabimi, nuk jam Blerim Ramosaj po Berim Ramosaj.
Të nderuar kolegë deputetë,
Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së dëshirojmë në pika të shkurta të japim edhe ne përkrahje kërkesës së këtij grupi të deputetëve, e cila kërkesë është padyshim kërkesë e shumicës së deputetëve të këtij Kuvendi, respektivisht e gjithë qytetarëve të Kosovës për një çështje kaq të rëndësishme, siç është problemi i privatizimit.

Më lejoni veç në pika të shkurta të paraqesim aspektin historik të këtij procesi dhe objektivat që i ka realizuar.

Vërtet, të hynim në procesin e privatizimit menjëherë pas luftës ishte kërkesë e gjithë qytetarëve të Kosovës. Aq ishte kërkesa e madhe sa që te fytyra apo te raporti me ndërkombëtarët vërehej si një presion. Erdhën me një projekt të ashtuquajtur të Letrës së bardhë të Xholi Diksonit ku, në fakt, propozohej për një proces të mirëfilltë të privatizimit. Një gjë e tillë nuk është arritur.

Duke e parë raportin e tillë të kërkesave të qytetarëve të Kosovës, UNMIK-u bërë një kompromis në këtë drejtim dhe themeloi Agjencionin e Mirëbesimit, i cili agjencion është themeluar më një rregullore të posaçme, e cila ishte në mbështetje të Administratorit të UNMIK-ut dhe të Zyrës Ligjore në Nju Jork. Edhe procesi i privatizimit që hyri, respektivisht Korniza Ligjore është bërë në emër të kompromiseve,

sepse qëllimi apo intenca e asaj periudhe ishte ruajtja e gjendjes status-kvo e ekonomisë së Kosovës, respektivisht mbetja në pozitën e njëjtë që UNMIK-u me çdo kusht kërkonte një gjë të tillë. Mirëpo, qytetarët e Kosovës vërtet dëshiruan t'i hynë këtij procesi që me një farë forme arritën me krijimin e një kornize të re ligjore dhe është formuar Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit. E pati kuptimin e një agjencioni të mirëbesimit, mirëpo nuk e ka realizuar atë qëllim të mirëbesimit, duke marrë parasysh edhe objektivat që ka realizuar edhe procesin e tërësishëm të privatizimit.

Së pari, duke marrë parasysh se objektiv e privatizimit është ndërrimi i strukturës së titullarit apo i strukturës së pronësisë së ekonomisë të një vendi, një gjë të tillë nuk e arriti ta realizojë.

Objektivi i dytë është ndërtimi i një strukture të re ekonomike dhe objektivi i tretë është krijimi i një ekonomie të tregut, respektivisht të një strukture ekonomike e cila gjeneron ekonominë funksionale të mirëfilltë, duke u mbështetur në ligjet e tregut dhe ekonominë e lirë, e cila ishte edhe objektiv i tërë qytetarëve të Kosovës. Asnjëri prej këtyre objektivave nuk janë realizuar.

Sa i përket çështjes së privatizimit, procesi ka shkuar shumë ngadalë dhe në mënyrë shumë selektive dhe ai selektim i ndërmarrjeve është bërë duke u mbështetur me interesa individuale apo grupe, e jo në bazë të një procedure të rregullt, respektivisht të një rrjedhe të natyrshme të zhvillimit ekonomik të Kosovës. Krejt ato që i thanë parafolësit e mi qëndrojnë në aspektin e defekteve që nuk dëshirojmë edhe një herë t'i përsërisim.

Objektivi që ato mjete të grumbulluara nga privatizimi të cilat, tek e fundit, janë mbledhur nga blerësit potencial të ndërmarrjeve që u shitën, edhe ato çka fitoi Kosova dolën jashtë qarkullimit. Në vend që ato mjete të biznesmenëve kosovarë, qoftë si persona fizikë, qoftë juridikë, që i futën në procesin e privatizimit, të gjenerojnë vende të reja të punës dhe të nxisin zhvillimin ekonomik, ato sot janë të mbyllura hermetikisht dhe janë të kushtëzuara nga një gjykatë apo nga një zyre e cila do të vendosë se ndërmarrja x, y a ka përfunduar në procesin e privatizimit apo jo. Nuk ka filluar ende procesi i likuidimit që kishte për t'i paraprirë një procesi të shitjes së tërësishme të të gjitha atyre aseteve që nuk janë ekonomikisht të qëndrueshme. Edhe kjo nuk është realizuar.

Mandej, ajo çka është e fundit, që sot po japin pak social, 20% i mjeteve të qytetarëve, të cilët kanë kontribuar në ato asete të ndërmarrjeve shoqërore, ende nuk është shpërndarë ose shpërndahet sot në mënyrë shumë selektive dhe pas presioneve të qytetarëve apo presioneve të kolektiveve punonjëse që i bëjnë sot në formë të grevave pranë zyrave të Agjencionit Kosovar të Privatizimit. Krejt këto janë proces i dështimit që aq sa është përgjegjës një zyrë, jemi përgjegjës të gjithë. Vetë fakti që ka arritur një pikë e tillë kaq e ndjeshme kaq me vonesë në Parlamentin e Kosovës, tregon sa jemi azhur. Me këtë tregohet edhe azhuriteti i një Qeverie, e cila ka premtuar kthimin, respektivisht ngjalljen, nxjerrjen e të gjitha atyre mjeteve që janë jashtë qarkullimit, të hynë në qarkullim, qoftë këto të privatizimit, qoftë ato që janë mbledhur në procese të tjera të grumbulluara që mbahen, qoftë në vend, qoftë jashtë vendit për ekonominë e Kosovës janë humbje e madhe. Për një ekonomi të zhvilluar, kaq mjete jashtë qarkullimi janë dëm i madh, e lëre më edhe ekonominë e Kosovës, e cila sot është në nivel të tillë të shkallës së ulët të likuiditetit dhe mosrealizimit të projekteve kapitale. Kjo është e paarsyeshme dhe e pa tolerueshme.

Në fund, në vend të përfundimit, më lejoni të them se krejt ky proces sot ku ka ardhur, ka ardhur si rezultat i projeksioneve të ndryshme politike të neglizhencës së qeverive të Kosovës, deri në këtë të sodit, që kanë qenë pjesë përbërëse të atyre agjencioneve në formë të participimit, me ato agjencione dhe nuk iu ka ndier zëri deri te kjo Qeveri, e cila sot nuk mund të arsyetohet se UNMIK-u po e pengon, sepse e kemi krijuar Agjencionin Kosovar të Privatizimit, që asnjë vonesë më nuk mund të tolerohet.

Ne, si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, nuk jemi të kënaqur veç me një debat të thjeshtë dhe të dëgjohet vetëm nga ministri në fjalë, por jemi të interesuar të nxjerrim një deklaratë të Kuvendit të Kosovës, e cila do të ketë karakter obligativ për Qeverinë e Kosovës dhe Agjencionin Kosovar të Privatizimit, që këtij procesi t'i hynë pa neglizhenca, pa ndikime politike dhe të jetë i mirëfilltë se, tek e fundit, procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe publike është një proces imanent që zvogëlon edhe korrupsionin, zvogëlon edhe ngadalësimet ekonomike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala predsedavajući!

Pozdravljam inicijativu grupe poslanika koji su pokrenuli ovo pitanje. Takođe sam iznenađen pristupom ovoj temi od strane subjekata koji čine većinu u ovom parlamentu. Sigurno da niko nije na Kosovu, mislim ne postoji čoveka na Kosovu koji je protiv privatizacije, ali je većina protiv ovakve privatizije koja se provodi na Kosovu ovih zadnjih godina i nije kriva samo ova Vlada nego od početka, znači svi oni koji učestvuju u procesu privatizacije i do perioda dok su to stranci vodili, a i od perioda kako taj bord vode, agenciju vode domći predstavnici.

Privatizacija je i u regionu protekla sa problemima, u zemljama u okruženju privatizacija je takodje bila praćena raznim štrajkovima, protestima radnika, nezadovoljstvima, mnogi su ostajali bez posla, prodavana su preduzeća u bescenju, isto se to gotovo djogadja na Kosovu. Meni se čini da Kosovo ima najbolje stanovništvo na svetu, u Evropi svakako, to je stanovništvo koje godinama nema penzije, nema zdravstveno osiguranje. Nakon privatizacije ostaje bez posla, bez zakona o radu i još sve to podnosi i trpi. Mislim da boljeg stanovništva nema na svetu i mislim da trebamo da budemo zadovoljni koliko smo ih ponudili kao ljudi koji su izabranai od njih.

Ja neću govoriti o ovim velikim firmama koje su bile predmet privatizacije do sada i koje nisu dale očekivane rezultate i običnim procesom i spinoffom, i ostalim, znači koliko je radnika dobio 20%, ono što je bilo garantovano i tako dalje.

Ja želim da govorim o onoj trećoj tački koju je pomenuo u izveštaju predsednik Agencije, Dino Hasanaj, koji je govorio poljoprivrednom zemljištu. Tu će biti problema u sredinama u kojima žive manjinske zajednice. U Dragašu je „Šar Proizvodi“ ili „Shar Prodhimi“ na albanskom, još 1960. godine, od opštine Dragaš dobila na upravljanje, korišćenje 29 hiljada hektara zemljišta. To nije zemljište koje je tek ta opština ili neko zaradio, to je zemljište na koje imaju pravo sela još u srednjovekovnim dokumentima. Od Sinan Paše, ...Bega do danas svako je selo imalo svoj atar, imalo je svoju planinu na koje je raspolagalo, to im Kralj nije oduzeo, dao im je tapije, takodje u periodu kraljevine i tako dalje, komunitsi su ih prevarili, dali su na korišćenje „Šar proizvodima“,

„Šar proizvodi“ su bezpravno upisali to u svoje knjige i danas se javljaju kao neki nosioci i vrše pripreme za privatizaciju.

Ukoliko su izvršni privatizacija ovih 29 hiljada hektara, od čega 23 hiljade pripada selima koji čine bošnjačku-goransku zajednicu, manjinsku zajednicu, u tom slučaju ova će sela ostati bez mogućnosti da čuvaju stoku, ostaće bez svojih groblja, zato što se na toj teritoriji nalaze njihova groblja, njihove utrine, njihovi pašnjaci, absolutno kompletno teritorija. Na taj način će biti prekršena i Medjunarodna konvencija, član 16. koji garantuje da se zadrže etnička struktura stanovništva i pored ..., znači kada se vrši privatizacija. Ukoliko se ovo izvrši, onda će to biti narušeno i to će biti kršenje svih medjunarodnih konvencija.

U svakom slučaju, pozivamo znači Agenciju da vodi računa kada su u pitanju, ovo nije jedna prodavnica pa se neko javio da kupi, nije ovo neka radnja u centru Prištine ili nekom gradu, ovo je zemljište, ovo je direktno vezano za opstanak stanovništva, za zadržavanje, za povratak i mislim da oko toga treba da se vodi računa. Najbolje rešenje je da ta zemlja bude vraćena opštini, da opština raspolaže i da menadžira tom zemljom. Inače, ako to kupi neki privatni bord, on može sutra da protera stanovništvo. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, Bojan Stojanoviq.

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala, predsedavajući!

Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke je razmotrila ovaj izveštaj i naravno mi podržavamo inicijativu vezano za bilo šta, za što treba kosovska javnost da bude upoznata. Naravno, izveštaj kao izveštaj mi ga podržavamo u potpunosti jer je dato ono što je traženo od ljudi koji trebaju da podnesu izveštaj i to je to, to je ta forma. Znači, tražili smo šta je sa Feroniklom, šta je sa Lamkosom, šta je sa poljoprivrednim zemljuštem i to je u redu. Medjutim, mi ovakve debate možemo praviti koliko god hoćemo, i ... je rekao da hoćemo da pravimo još jedno politikanstvo, da stavljamo so na ranu narodu koji je ionako nezadovoljan, a znamo da mi nismo privatizovali mnoge svetske svetske banke, koje su doživele kolaps i ne znam šta se sve dešava u svetskoj privredi i ekonomiji, i ovi vuku korene još od daleko u prošlosti, nema veza sa nikakvim režimima, to je sistem vlasničkih odnosa, bila je svačija, a mi smo mislili da je ničije, pa smo svi redom uzimali šta smo hteli, i sada kada taj sistem ne funiksioniše, kada mora da se kompletno restruktura, mi nekako želimo da izvučemo neku priču kao da ćemo to rešiti preko noći. Verujte mi da je po meni i kako neki svetski i evropski trendovi pokazuju, bolje je i loša privatizacija, nego zadržavanje statusa kvo ili neznam čega, pa i dok smo napravi neki klub ili diskoteku u nekoj fabrici, ako ta fabrika ne može da radi, imaćemo bar neku korist pa ćemo napraviti na drugom mesto nešto drugo.

Moramo da napravimo jedan plan i program u ekonomskom razvoju i da poboljšamo privatizaciju i sve ovo što nam je ostalo kao breme. Naravno, ako pričamo konkretno o Lamkosu, mene čudi da je Feronikal, na primer uspeo, a Lamkos nije, kada znamo da je to Fabrika pocinkovanog lima, koja je na Balkanu bila jedan veliki gigant i da niko u regionu maltene nije proizvodio lim, pogotovo ne takvog kvaliteta, a s druge strane izveštaja Agencije za privatizaciju jasno kaže da je to poništeno. Znači, onaj koji nije izvršio obavezu, onaj koji je preuzeo završava se u ... Zašto ne pohvalimo feronikal, ako je ovo tačno ovde, znači tri puta više nego što su hteli da ulože, oni su oložili, zaposlili su veći broj radnika nego što jeste, pa što je trebalo da ... da se ne privatizuje.

Naravno, na dva miliona stanovnika ... da je nas dva miliona sposobno da vodimo Agenciju za privatizaciju, ali malo nas ima sposobnih da radimo i najlakše je kritikovati. S druge strane, ja stvarno nemam neki poseban razlog da branim ovu Vladu niti da krivim bilo koga, niti bilo koju vladu, ali ako vidimo kada se dešavala privatizacija, ovde ispada da sam ja poslanik koji podržava ovu Vladu 6-7 godina. To nije tačno, mandat ove Vlade je od 19 januara 2008. godine.

Treća stvar, evo ja stvarno ne volim da ljude koji su učestvovali u procesu privatizacije optužujem puno zato su to ljudi koji žive na Kosovu i koji su to možda uradili u najboljoj nameri, ali mi imamo pogrešne informacije, dovodimo u pitanje i njihov integritet i njihovih porodica jer možda ljudi koji su nezadovoljni uopšte, iako im niko od tih ljudi nije u bilo koju nameru uradio ništa, dovodimo ih u situaciji da mogu biti izloženi možda i napadu ne samo verbalno, nego i fizički, jer ovde se dešavaju razne stvari. I to je činjenica. Ja pričam onako da bi me narod razumeo.

Vezano za privatizaciju zemljišta, tu imam određene primedbe. Znamo da ili smo mi najrazvijenija poljoprivredna zemlja, pa kod nas uspeva da se postavimo armaturu i blok pa zalijemo betonom i nikne zgrada, ili nešto nije u redu. Imaćemo puno primera, onda ako se neko pozabavi ovo pričom, da dodjemo do analize da poljoprivredno zemljište koje je dato na korišćenje, više nije poljoprivredno zemljište nego su tamo nikli velelepni objekti. To je opet drugo pitanje. Da li je kriva sama Agencija privatizacije ili postoje neke druge institucije. Znači, tamo nigde ne piše zabranjeno je nešto urediti. Da li smo mu kao poljoprivredno zemljište, on nije ispoštovao, ako nije ispoštovao, postoje zakonske posledice koje moramo preuzeti prema njemu. I jednostavno imam utisak kao da ovde ne postoji tužilaštvo. Stalno se bavimo nekom skupštinskom pričom. Hajde da analiziramo na osnovu izveštaja tužilaštva, da vidimo da li je neko kriv ili nije, znači pa tek onda da bacimo kamen. Ne da ljude pre nego se pokrene bila kakva optužnica, mi ih unapred osudjujemo.

Mi ćemo podržati Izveštaj ovakav kakav jeste, bez obzira što verovatno ima puno problema i puno radnje koje nisu u skladu sa zakonskim procedurama ali odgovaraće oni koji su to uradili. Ne treba da se bavimo nekim velikim politikanstvom oko cele te priče, nego... konkretne mere. Da vidimo šta ćemo sada da pareduzmemo, hoćemo li raditi ovde još 20 delegata, završiti ovaj izveštaj, usvojimo ga ili ne i šta onda, obično moramo čekati 5-6 poslanika da podnesu podnesak neki i da rasprave ovde u beskonačnoj debati a nećemo ništa rešiti tim ljudima koji ovde u diskusiji pominjemo. Te gladne, te koji su ostali bez posla, koji su ostali bez radnih mesta, mi moramo i da im obezbedimo radna mesta ili privatizacijom ili razvojem privrede i ekonomije. To ne zavisi direktno od nas i to moramo da kažemo da koliko mi možemo da uradimo i kolike su mogućnosti, treba da se trudimo da uradimo i da damo svoj maksimum. Znači, nivo razočarenja ne zavisi od nivoa iščekivanja. Mi smo svi ovde dovoljno ozbiljni, dovoljno stari da bi verovali u deda mraza. Ja naravno ne verujem. Biće puno poteškoća da bi napravili jednu dobru priču, ali naravno moramo da se trudimo i da radimo. Hvala.

KRYESUESI EQREM KRYEZIU: Ju faleminderit, zoti deputet! Në emër të grupit Parlamentar “Zajedno”, zonja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepo na datu reč!

Pošto smo mi kao poslanička grupa zadnji, jako je teško posle ovakve diskusije da kažem nešto a da bude interesanto i da bude korisno za sve nas. Ja sam slušala debatu, u

potpunosti podržavam ovu debatu i čini mi se da smo mi kao poslanici dosta zakasnili kada je u pitanju ovakav vid debate.

Dans se radi o jako važnom pitanju za Kosovo kada je u pitanju imovina, kada su u pitanju građani Kosova. Mi znamo, da ne bi ponovljali ovde da je na ime Uredbe, Uredbe UNMIK-a 2002/12 osnovana Kosovska poverilačka agencija za privatizaciju i ja ću da pročitam jedan pasus: „Poverilačka agencija je osnovana da bi očuvala i povećala vrednost održivosti korporativnu upravu nad društvenim i javnim preduzećima na Kosovu“. Znači, da bi povećala i sačuvala vrednost, što je namenski bila potrebna za to što je bila situacija opšte haotična posle rata, tako da je ova Kosovska poverilačka agencija bila jako potrebna kosovskom društvu.

Međutim, šta se dešavalo? Počela je, ja mogu da kažem, da me izvine svi ovde prethodni govornici, na Kosovu je počela baš od strane, da kažem ove Poverilačke agencije, koja nije bila sama, znamo da je u odboru, upravnom odboru imala u svom sastavu četiri međunarodna direktora i četiri stanovnika, direktori Kosova. Znači, svesno ja kažem, da su krenuli u jednu divlju privatizaciju, kao što je to bio slučaj pre 25 godina sa Rusijom, koja danas ima na spisku najveći broj bogataša milionera zahvaljujući takvoj divljoj privatizaciji.

Šta se dešava? Kosovska poverilačka agencija nije ispoštovala uredbu koja daje do znanja kako može da se sačuva društvena i javna imovina, gde neću da čitam negde oko 14 članova transformacije javnih i društvenih preduzeća, korporacija, akcionarsko društvo, zajedničko preduzeće, poverilačko preduzeće, svi te transformacije i na kraju dolazi likvidacija i pradaja. Kosovska poverilačka agencija je to radila metodom spinkos, što znači da je morala da ima ekonomski i socijalni plan i program za privatizaciju da bi zaštitila imovinu i radnike. Ona čini mi se da nema takav plan i program razvoja, da je imala samo od prodate vrednosti da bira kupca sa najvećom cenom, od prodate vrednosti da sleduje 20% radnicima, gde mnogi investitori nisu ispoštovali osnovna načela ugovora koje su imali sa Poverilačkom agencijom, koja je preuzimala društvenu imovinu, društvena preduzeća, zemljište i ostalo.

Ova agencija znamo da je formirana Uredbom, a i svi zaboravljamo, a najviše je zaboravila Kosovska poverilačka agencija sama da je na ime ove Uredbe bila i Uredba o posebnoj komori. To je bio Vrhovni sud Kosova, koji je imao nadležnosti gde je Kosovska poverilačka agencija imala nadležnost da tuži investitora kada se nije pridržavao ugovora koji je bio vezan sa rokovima, do kog datuma da isplati cenu kao investitor, šta treba u preduzeće da uloži, da li da obnavi proizvodnju, da li da zapošljenima da jedan deo od 20% i svi ti članovi iz ugovora nisu bili ispoštovani, a ta agencija nije našla za potrebno da utuži nijedno preduzeće. Jedno.

Drugo, Uredba o korišćenju postoji na ime ove generalne uredbe, Uredba o korišćenju zemljišta. Mi oko nas vidimo da se društvena svojina i zemljište, najbolje zemljište, poljoprivredno zemljište A kategorije pretvara danas u velike zgrade i verujete mi da će to biti jedan dan investicija koja neće biti više rentabilna, nego će možda ta investicija da dovede građane Kosova u jako teškoj socijalnoj poziciji.

Jedno što hoću da kažem konkretno, da ne bi ponavljali ovde kako su sve kršena prava kada su u pitanju radnici, kako su kršena prava kada su u pitanju zakoni. Dobro se kaže ovde da Kosovska poverilačka agencija znači vrši nadzor nad preduzećima i kada ona

daje na svojoj Web stranici daje u privatizaciju preduzeća, jako daje značaj stranim ulaganjima, ali na ime Zakona o staranim ulaganjima, na ime Zakona o Kosovskoj poverilačkoj agenciji, na ime Zakona o dugu društvenih preduzeća, gde mora da se precizira, na ime Zakona o carini i akcizama na Kosovu, porezu na prihode i korporacije na dodatnu vrednost, porez na lični dohodak i na poslovnim društvima, gde nema nigde Zakon o zapošljavanju, Zakon o zaštiti radnika, Zakon o penzijskom i invalidskom osiguranju, znači agencija samo se brine za imovinu, a ne brine za ljudski resurs.

Da li danas mi imamo neku dobit ako smo ostavili od toliko preduzeća radnike na ulicu. Ja ću sada da dam jedan konkretan primer da bi našim građanima bilo mnogo jasnije. Ja pošto znam kako se privatizovalo preduzeće Drateks, to je bilo tekstilno preduzeće u Dragašu, koje je imalo do 700 radnika, nikad manije od 400 radnika, i kada nije moglo da posluje pošto je tekstilna industrija imala krizu. Ja samo dajem do znanja da sam imala ugovor „Kuk-komerca“ koje je kupac Drateksa na 99 godina, koji iznosi 368 hiljada eura. Molim vas, da me pratite dobro, 368. hiljada eura je bio ugovor o zakupu na 99 godina. To je jako ogromna fabrika sa velikim mašinskim parkom. Na ime ovog ugovora investitor je dobio kredit koji dalje plaća, to su kupci „Kuk-komerc“ i gospodin Baljaj iz Restavice.

Kada su ušli u fabriku, nije ispoštovano do danas 20% davanja na ime dela radnika, a u fabrici je prodat mašinski park, koji je vredeo više od milion ipo dinara. Danas je ta fabrika prazna, zatvorena, jedan deo je dat Turskom investitorom za tekstil pod zakup. Znači, šta smo mi sa ovim dobili. Ja imam konkretno pitanje, da li je dalje Kosovska poverilačka agencija vodila računa kako završava kapitalna imovina, ne sada kada su zgrade i zemljište, nego štu su sve fabrike imale unutra, kakva je sve ovo prodaja vršena, kakva je zloupotreba vršena, to možemo da uočimo, zato što postoji knjigovodstvena aktiva i pasiva šta su sve preduzeća imala od osnovnih i obrtnih sredstava. Znamo da postoji Zakon o amortizaciji i revalorizaciji, znamo da ima, ako su oba zakona prevaziđena, Zakon o utvrđivanju stvarne tržišne cene. Evo, tu su elementi koje ne možemo ovde da osporimo. Ja imam jedan konkretan predlog. Ne možemo da krivimo mi današnju vladu za ovaj proces privatizacije kakav je bio, ali možemo da tražimo reviziju nad procesom privatizacije na svim preduzećima, da formiramo jednu specijalnu Skupštinsku komisiju, kako ćemo je nazvati, kako ćemo je transformisati, to će znati bolje pravnici, i da na terenu utvrdimo i sa dokumentacijom gde i kako je učinjeno pogrešno, koliko su oštećeni radnici i koliko je oštećen budžet Kosova. A najviše me brinu 400 miliona iz Fonda za privatizaciju, koji su vani, kako će da završe, da li će da završe sa umanjenjem gde su investirani, da li će da završe sa umanjenjem od 33% kao Penzioni fond, to su pitanja sa kojima mi moramo da se pozabavimo. Unapred hvala!

KRYESUESI: Ju falemidnerit!

Konstatoh që deklarimi i kryetarëve të grupeve parlamentare është kryer. Tani fillojmë me debatin që e kanë deputetët e paraqitur. Sipas radhës, i pari është deputeti Naim Rrustemi.

NAIM RRUSTEMI: Ju faleminderit, kryesues!

Para se të filloj, unë kisha për të thënë një fjalë, që kisha pasur qejf që të ishte prezent edhe drejtori i Bordit të drejtorëve të Agjancionit Kosovar të Privatizimit, sepse ndoshta e kishte dëgjuar ndonjë fjalë të mirë edhe prej nesh. Besoj se ka dikush diçka për të thënë. Por, sido që të jetë, aty nuk është prezent drejtori i Bordit, por është prezent

ministri i Financave dhe Ekonomisë, që së paku njëra prej pjesëve të debatit e vlen që të diskutohet.

Të nderuar, të përkujtojmë një çështje që është shumë me rëndësi, që procesi i privatizimit që po e diskutojmë ne këtu, nuk ka të bëjë asgjë me një qëndrimi, me një grup parlamentar, me në një parti, sepse në këtë proces janë të përziera të gjitha grupet politike që janë prezente këtu në Kuvend. Me fjalë të tjera, nuk ka nevojë që argumenti të jetë pro ose kundër ndonjë vizioni partiak, por kjo është çështje individuale për të gjithë ata që kanë qenë të involvuar në procesin e privatizimit.

Kjo do të thotë se nuk ka nevojë të mbrohet Qeveria, po as nuk ka nevojë që të sulmohet Qeveria, sepse ata që sot janë në opozitë, dje kanë qenë në Bordin udhëheqës të Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit, kështu që edhe kanë qenë pjesëmarrës drejtpërdrejtë në procesin e privatizimit. Janë emra publik, kanë qenë dy përfaqësues të qeverisë së atëherëshme, kanë qenë përfaqësues, por unë nuk jam i orientuar drejt sharjeve të njërës apo të tjetrës qeveri sepse, tek e fundit, procesi i privatizimit ka të bëjë diçka me pasuri, e pasurinë nuk besoj që askush, nëse e ka bërë në forma të paligjshme, ia ka çuar partisë. Secili e ka për veti.

Gjatë inicimit të këtij debati, ne kemi kërkuar që të jetë prezentë, sepse kemi dëshiruar që të diskutojmë procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, si një kapitull në vete, por edhe të ndërmarrjeve publike, si një kapitull në vete.

Unë, fillimisht po filloj me ndërmarrjet shoqërore. U tha shumë prej atyre fjalëve çka unë pata ndërmend t'i them lidhur me procesin e privatizimit. Këtu prej raportit janë dhënë disa raste suksesi, por një raport shumë i thjeshtësuar, i tej thjeshtësuar, që nuk bartë kurrfarë informacionesh. Informata e tilla që i kemi këtu, kemi mundur t'i gjejmë pa asnjë problem edhe ka qenë mirë e shkruar, por njerëzit serioz nuk e bëjnë një shtrim këtillë. Ka bërë një punë të jashtëzakonshme, mirëpo mbetet edhe shumë për t'u bërë, thua se është duke shkruar poezi. Këtu kemi të bëjmë me procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore.

Të nderuar,

Në Ligjin për privatizimin, në Ligjin për Agjencionin e Privatizimit të Kosovës, ne e kemi themeluar një bord, Bordin e drejtorëve, është themeluar nga Kuvendi. Është drejtori i Bordit të drejtorëve, kurse drejtori menaxhues, ka një vit që është miratuar ligji, ende nuk është zgjedhur. Ky është një konflikt i interesit brenda Agjencionit Kosovar të Privatizimit, sepse me përmbushjen e obligimeve dhe të kontratave merret detyrimisht dhe gjobiten, merret drejtori menaxhues. Arsyeja pse drejtori i Bordit të drejtorëve nuk e ka zgjedhur drejtorin menaxhues, unë nuk e di, por nuk ka pasur asnjë arsye, së paku legale.

Për punën e Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit ka shumë çka të thuhet, por më së miri kishte për të qenë edhe që të përkrahet një ide që aty të bëhet një investigim i thellë, një investigim i thellë nga ana e Prokurorisë së Kosovës, sepse asnjë prej ndërmarrjeve të privatizuara deri më tani me spinoff special nuk ka treguar rezultate, asnjë prej tyre. I vetmi që, siç e thonë këta, sukses aksessori, si storie e suksesshme ka tentuar të prezantohet Ferronikeli, kurse nga diskutimet tona dhe nga njerëzit që merren aktivisht me zhvillim ekonomik, e shohin që Ferronikeli nuk ka gjeneruar fitime, ka gjeneruar humbje, sepse dhe ka gjeneruar diçka që i merr fukarasë ia jep të pasurit dhe disa

individëve, sepse me rastin e privatizimit me spinoff kompanitë kanë qenë të obliguara që t'i përmbushin detyrimet që i kanë me kontratë të ofruar. Nëse mospërmbushja e detyrimeve ka ofruar dyshime të bazuara se atje mund të ketë edhe korrupsion, sepse ato kompani kanë qenë të obliguara që të raportojnë në përmbushjen e detyrimeve që i ka marrë mbi vete. Dhe, unë aq sa e kuptoj, nëse i mbyll sytë dhe nuk e lexon Raportin, diçka ka. Pse nuk e ki lexuar ti raportin? Raportet janë të obligueshme dhe janë të mbuluar nga dikush, nga atëherë AKM-ja, kurse tash nga AKP-ja. Duhet të na frikojë, sepse nuk bëhet përmbushja e këtyre obligimeve. Për shembull, rasti i "LLamkosit" apo Fabrika e duhanit në Gjilan apo Fabrika e radiatorëve "Jugotermi" në Gjilan, prapë, kanë falimentuar, por edhe nuk e dinë kush as prejardhjen e pasurisë se kah ju ka ardhur. Ka qenë rast hetimor në Prokurori, rast me të cilin edhe ne prapë se prapë tentojmë të transmetojmë se janë raste të suksesshme. Apo, për shembull, kemi raste që nuk janë dhënë me spinoff special, ke raste ndonjë formë tjetër të privatizimit, e kemi komercializimin e rastit të Sharcemit. Me sa unë jam në njohuri, kontrata i ka skaduar. A është ndalur për t'u privatizuar Sharcemi apo kemi raste edhe të tjera, për shembull, e kemi privatizuar "Ilirinë", hotelin "Iliria", afër aty është një kompani tjetër, një kompani tjetër që është Lidhja turistike e Kosovës, a merr qiranë, çka bën, pse nuk del. Kush e bën këtë program të privatizimit të kompanive shoqërore në Kosovë, aty duhet të bëhet ndonjë program.

Edhe një rast shumë i rëndësishëm që kishte për të qenë edhe që ngjallë dyshime, dyshime të bazuara se diçka ka ndodhë aty, po flasin njerëzit, kanë qenë të involvuar në procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe pas procesit të privatizimit, personat kanë shkuar janë bërë drejtorë në organizatë. Unë nuk e di pse të marrë, ti të jesh në proces të privatizimit edhe të kthehesh të jesh i përzier në proces të privatizimit edhe të shkosh të udhëheqësh, të jesh në menaxhment të ndërmarrjes së re të krijuar, është dyshuese, na bën të gjithëve të dyshojmë. Për këtë arsye tash vijmë në një situatë ku ndërmarrjet shoqërore që janë privatizuar, disa falimentojnë, disa e fillojnë procesin e falimentimit, nuk dihet çka bëhet, punëtorët mbesin në rrugë, por shpërndarja e 20%-shit nuk është mirë e realizuar.

Nuk po lëshohem në rastin e Ferronikelit, se u fol dhe besoj se edhe shumë të tjerë do ta përmendin, sepse është një që është pak më e madhe, më lirë kishte për të na kushtuar sikur ta kishim mbyllur, se sa që e kemi shitur. Kjo është njëra pjesë sa iu përket ndërmarrjeve shoqërore. Po kthehem te iniciimi i procedurave për privatizimin e ndërmarrjeve publike.

Ne e kemi një ligj, e kemi Ligjin për ndërmarrje publike. Ministri e Ekonomisë dhe Financave është përgjegjës dhe qëndron në krye të Komisionit të privatizimit që e formon Qeveria. Ne deri më tani, në këtë sallë e kemi pranuar veç një kërkesë, sepse vota formale e Kuvendit nevojitet para se të fillohet të iniciohet procedura, para se të iniciohet procedura. Me fjalë të tjera, ta japim edhe ne një votë këtu, e kemi dhënë për distribuim, rrjetin dhe distribuimin e një pjese të KEK-ut.

Të nderuar, unë do ta vë në pah se kjo është veç njëra formë e privatizimit, se format tjera të privatizimit të ndërmarrjeve publike edhe ekzistojnë. Për shembull, e kemi rastin me Konzorciumin e Post-Telekomit të Kosovës në Shqipëri. Absolut, asnjë ligj nuk u respektua në atë moment. Hiq, edhe gjejnë vend që, qysh thonë ekonomistët, është proces i privatizimit. Secili disbalanc mes pronës publike dhe pronës private që krijon ndonjë formë të disbalancit, kuptohet si privatizim. Nëse në kompanitë më fitimprurëse

nuk respektohet asnjë ligj, po na humb besimi. Po na humb besimi që edhe ndërmarrjet publike që fillojnë të privatizohen, do t'iu ndodhë, do ta kenë të njëjtin fat qysh e kanë pasur ndërmarrjet shoqërore gjatë kohës së AKM-së. Për këtë arsye, edhe ky debat është shumë i rëndësishëm.

Këto ishin disa prej shqetësimeve të mia lidhur me procesin e privatizimit dhe, normalisht, edhe një gjë do të duhej theksuar dhe qitur në shesh. Është edhe çështja e transparencës gjatë procesit të privatizimit. Taktika e transparencës është shumë e rëndësishme në privatizim. Unë i dëgjoj dhe e shikoj televizionin, i shikojmë si të gjithë ne, lajmet. Shumë shpesh i ndodhë që KTV-ja, një prej televizioneve publike, e qet në plan të parë ish këshilltarin e Kryeministrit, Arila Fogel...

KRYESUESI: Ju faleminderit! Mirë, edhe gjysmë minute.

... edhe unë kisha pasur kërkesë të drejtpërdrejtë që të sqarohet ministri i Ekonomisë dhe i Financave, zoti Ahmet Shala, dhe drejtori i AKP-së lidhur me raportet e përparshme të Arila Fogel në procesin e privatizimit edhe raportet e sotme, të sqarohet sepse kërkojmë transparencë gjatë procesit të privatizimit. Fjala publike e ka peshën e vet së paku që mbetin në transkript. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka, deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti ministër,

Të çmuar kolegë deputetë,

Të gjithë parafolësit që diskutuan për një proces tejte të rëndësishëm për të ardhmen e vendit, për rimëkëmbjen ekonomike dhe për krijimin e një ambienti normal dhe të një ekonomie të tregut në Kosovë, po edhe vetë kjo informatë që na ka ardhur nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit, flasin për një storie të dështuar të këtij procesi. Po ta lexonim me vëmendje këtë informatë se në çfarë gjendje e kanë marrë Bordi i ri i AKP-së dhe AKP-ja, pasi që e kemi miratuar edhe Ligjin për Agjencionin Kosovar të Privatizimit, situatën në duar të tyre, kjo është dëshpëruese dhe, vërtet, këtu edhe disa kolegë deputetë e potencuan, duhet Prokuroria Publike e Kosovës dhe drejtësia kosovare të fillojë të hulumtojë në mënyrë detale se pse nuk është bërë pranim dorëzimi, si ka shkuar procedura, ku ka shkuar dokumentacioni. Këtu janë bërë edhe pyetje parlamentare drejtuar ministrit të Punëve të Brendshme se çka ka ndodhur me hulumtimin e atyre thashethemeve serioze publike për djegie të një dokumentacionit të vlefshëm. Fatkeqësisht, e gjitha mbetet misterioze dhe qytetari i Kosovës nuk e di të vërtetën dhe kjo është e dëmshme për një shoqëri dhe për një shtet demokratik ku sundon rendi dhe ligji që mëtojmë ta ndërtojmë.

Këtu kritikohet shumë ish AKM-ja, zoti ministër, dhe kritikohet edhe e tërë procedura e monitorimit dhe obligimet që i kanë pasur, sidomos pronarët që e kanë bërë privatizimin e ndërmarrjeve me spinoff special.

Këto konstatime flasin qartë për dështime serioze në këtë proces dhe dyshimet të bazuara të keqpërdorimit dhe të aferave korruptive, sepse lënë dilema kur vetë Bordi i AKP-së lë dilema të tilla, tregon për vonesa, mosrespektim të procedurave, mospërgjegjësi të këtyre pronarëve ndaj kërkesave dhe obligimeve kontraktuale ndaj ish-AKM-së dhe tani AKP-së, atëherë njerëzit që kanë qenë në AKM dhe ka mjaftë vendorë që kanë

pasur akcese në këtë proces të ndjeshëm që ka të bëjë me pasurinë kombëtare, duhet të flasin dhe qoftë edhe një informatë morale t'ju jepet njerëzve tanë që i kemi zgjedhur tani në AKP.

Por, më së rëndi është goditur ekonomia dhe punëtorët të cilët nga këto storie jo të mira të privatizimit, ngelën pa punë, ngelën në rrugë dhe ngelën në vijë të ekzistencës. Kemi obligim ligjor dhe moral që investitorët dhe pronarët që nuk i kanë përmbushur obligimet e parapara me kontratë, sipas spinoffit special, ndaj tyre të merren masa adekuate konform legjislacionit në fuqi, asgjë më tepër as më pak, konform ligjeve aktuale në fuqi dhe është koha e fundit që mos të shpërdorohet pasuria e qytetarëve të Kosovës.

Me këtë Informatë informohemi për Ferronikelin, Llamkosin, për tokat bujqësore, por aspak në pozitë më të mirë nuk janë edhe shumë ndërmarrje tjera të privatizuara me spinoff special. Çka po ndodhë me fabrikën e përpunimit të duhanit në Gjilan, me “Ballkan”-in e Suharekës. Kemi greva të përditshme dhe pakënaqësi enorme edhe të ish punëtorëve, edhe të punësuarve brendapërbrenda këtyre ndërmarrjeve. Por, çka po ndodhë tani me proceset në vijim të ndërmarrjeve publike, me PTK-në? A ka dikush informatë dhe a ka ky Kuvend dhe qytetarët e Kosovës transparencë për kontratën e famshme me Dardafonin. Pse mungojnë politikat prioritare të këtij procesi dhe transparenca, siç ka ndodhur në shtetet e regjionit dhe në shtetet që e kanë kaluar këtë proces në mënyrë transparente? Pse gjithë kjo enigmë, pse gjithë ky misteriozitet, çka po fshihet pas saj, dilemat janë të shumta?!

Sa i takon Ferronikelit, ky Kuvend duhet të dalë me konkluzë të veçanta. Kërkojmë nga AKP-ja kontratat e Ferronikelit me KEK-un, me komunat e Kosovës, të bëhen transparente. Kërkojmë të shohim ngastrat kadastrale të sipërfaqeve ku ndodhet xehja dhe eksploatimi i xehes, se në çfarë sipërfaqesh është privatizuar. Do të thotë, këto janë gjërat që po i shqetësojnë qytetarët e Kosovës dhe jam i bindur, edhe të gjithë deputetët e këtij Kuvendi të nderuar.

Mirëpo, parashtrohet pyetja: - Çfarë klime ekonomike po krijojmë për investitorët dhe pronarët e këtyre ndërmarrjeve? Cilat janë politikat e zhvillimit ekonomik dhe politikat e Qeverisë? Cilat janë politikat kreditore? Fatkeqësisht, që një vit e gjysmë që jemi të pavarur, nuk ka ndodhur asgjë në këtë drejtim. Sa i përket publikimit të listave të punëtorëve, ka abuzime, ka keqpërdorime, ka manipulime dhe 20%-shi nuk e di pse po prolongohet kaq shumë. Kemi pasur edhe shprehje të revoltave dhe manifestime në rrugë të punëtorëve. Ju lutem, ata kanë derdhur djersë, kanë punuar, kanë ndërtuar ato ndërmarrje publike dhe konform normave ligjore, 20%-shi ju takon. Është tani përgjegjësia e AKP-së që në mënyrë urgjente t'iu përgjigjet kërkesave legjitime të këtyre njerëzve.

Këtu thuhet që të ndërmarrjet, tani shoqërore, siç është “Gjateksi” në Gjakovë, për tendencën dhe shitjen e aseteve të ndërmarrjeve kosovare jashtë Kosovës, në Serbi konkret, AKP-ja thotë që i ka dërguar letër, do të thotë, Zyrës Ligjore të Presidentit, Kryeministrit, Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar dhe të EULEX-it. Thjesht, duhet të zhvillohen format, kontaktet, dialogimi dhe negocimi, sepse ajo është pronë e ndërmarrjes publike “Gjateks” nga Gjakova, e qytetarëve të Kosovës dhe e Republikës së Kosovës dhe, zoti ministër, çështja e ndërmarrjeve shoqërore në Gjakovë, duhet të hyjë në prioritetet e Agjencionit Kosovar të Privatizimit dhe, ju lutem, mos të ndodhë

me këto storie të dështimit, të shkatërrimit të këtyre ndërmarrjeve të suksesshme dhe të hedhjes së punëtorëve në rrugë, siç ka ndodhur me shumë ndërmarrje të suksesshme që i ceka më lart.

Pastaj, është në procedurë të privatizimit edhe Banja “Ilixha” në komunën e Istogut, një institucion që një kohë është menaxhuar edhe nga Ministria e Shëndetësisë. Ministri i Shëndetësisë është zotuar që do t’i dërgojë letër AKP-së, që bile pjesa shëndetësore mos të privatizohet, sepse ka nevojë për atë pjesë Kosova. Me qindra invalidë, veteranë të luftës dhe njerëz të tjerë në nevojë po japin shuma të caktuara të parave në banjat në Slloveni dhe në vendet tjera.

Të jeni të bindur, të nderuar deputetë, që Banja “Ilixha” në komunën e Istogut është ndër banjat më të mira shëruese, uji termal më cilësor dhe një vend që dikur Kosova është krenuar me të në Ballkan dhe jo vetëm në Ballkan, por edhe më gjerë. Në këtë kuptim, kërkoj përgjegjësi serioze. Është në rregull që të privatizohet pjesa turistike, të zhvillohet ajo është çdo gjë në rregull, mirëpo Qeveria e Republikës së Kosovës po shihet se ka mungesë vizioni, biznes plani, logjike racionale që, thjesht, disa objekte me rëndësi vitale për Kosovën të mbahen. Tani kemi edhe Ligjin për partneritetin publiko-privat, është një ligj i mirë, i cili lehtë mund të zbatohet dhe është i një rëndësie nacionale që për disa objekte të tilla me rëndësi, të ketë akses edhe vetë Qeveria dhe shteti.

Dhe, për fund, nuk jem i më IPVQ, institucione të përkohshme vetëqeverisëse, më nuk ekziston AKM-ja, jemi Republikë e Kosovës - shtet sovran dhe i pavarur, kemi Agjencionin Kosovar për Privatizimin, duhet të nxirren edhe ligje të tjera të nevojshme dhe mos të na ndodhë që pasuria e Kosovës dhe mjetet nga kjo pasuri që janë krijuar me mund, të shkojnë në adresat e gabuara, sepse tani adresat dihen: -Qeveria e Republikës së Kosovës, AKP-ja dhe institucionet tjera përgjegjëse dhe tash e tutje kërkojmë përgjegjësi më të madhe dhe unë insistoj që Prokuroria e Kosovës për të gjitha këto që u thanë nga deputetët e nderuar, të dalë dhe drejtësia ta thotë fjalën e vet. Ju faleminderit!

KRYESUES: Ju faleminderit! Fjalën e ka Agim Veliu.

AGIM VELIU: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Procesi i privatizimit në Kosovë teknikisht është përcjellë me një transparencë më të madhe se në vendet tjera në rajon. Metodrat që janë zgjedhur për privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore kanë qenë të tilla që kanë mundësuar involvimin dhe mobilizimin e mekanizmit të tregut të hapur në përcaktimin e vlerës së ndërmarrjeve që janë privatizuar.

Kështu, oferta dhe kërkesa e tregut të hapur ka përcaktuar çmimin e ndërmarrjeve. Tani nuk është koha për të bërë vërejtje për momentin kohor në të cilin është bërë privatizimi, por megjithatë duhet theksuar se shumica e ndërmarrjeve janë privatizuar gjatë viteve kur Kosova nuk e kishte të definuar statusin e saj.

Negociatat që zhvilloheshin në vijim dhe përgatitja e planit të Ahtisarit, ishin indikacion se kah do të shkojë Kosova në procesin e konsolidimit shtetëror, por në aspektin ekonomik, shumë investitorë potencial mund të mos kenë konkurruar fare në

procesin e privatizimit për shkak të mungesës së definimit të statusit përfundimtar të Kosovës. E gjithë kjo situatë ka bërë që vlera e shitur e shumë ndërmarrjeve të jetë dukshëm më e vogël sikur privatizimi të bëhej në një moment kohor kur do të ishte definuar statusi i Kosovës dhe të diheshin qartë...

KRYESUESI: Unë i kisha lutur deputetët dhe deputetet, në qoftë se kanë nisma ligjore, le t'i nënshkruajnë marrëveshjet pas seance, jo brenda seancës. Vazhdoni, më falni, ju lutem!

... sa për krahasim, merrni çmimin me të cilin janë privatizuar shumë ndërmarrje në vendet tjera të rajonit. Sidoqoftë, ajo që është me rëndësi, tani është përmbyllja me sukses e procesit të privatizimit. Kalimi i kompetencave nga Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, nuk ka kaluar rrjedhshëm dhe pa probleme. Marrja e kompetencave nga kosovarët, sigurisht se ka rritur llogaridhënien karshi qytetarëve për punën që e bën kjo Agjenci. Por, mungesa e ekspertizës mund të vërehet në punën që e bënë kjo Agjenci edhe tani.

Bordi aktual i Agjencisë së Privatizimit, me gjithë angazhimet e shumta në vazhdimin e rundeve të privatizimit, ende nuk ka strategji të qartë se si të veprohet me mjetet e grumbulluara të privatizimit. Këto mjete që janë grumbulluar nga privatizimi, në rend të parë duhet të kuptohet si tërheqje nga qarkullimi ekonomik dhe rrjedhimisht zvogëlimi i fuqisë blerëse dhe investuese të bizneseve kosovare, shto kësaj edhe efektet multiplikuese që do të kishte ekonomia kosovare, sikur këto mjete të mbeteshin në qarkullim. Rezulton se kostoja oportune për ekonominë kosovare është dy apo tri herë më e lartë se sa shuma e këtyre mjeteve.

Pakënaqësitë e punëtorëve vazhdojnë me të njëjtin intensitet në lidhje me mospagesën e 20%-shit të shumës së mjeteve nga privatizimi i ndërmarrjeve. Sindikatat e punëtorëve sikur janë pasivizuar në kërkesat e tyre. Në fakt, privatizimi i ndërmarrjeve ka nënkuptuar edhe shkapërderdhjen e punëtorëve dhe dobësimin e organizimit sindikal dhe, si rezultat, rënien e presionit tek Agjencioni nga ana e punëtorëve.

Problem serioz janë edhe ndërmarrjet që janë privatizuar me spinoff special. Te këto ndërmarrje nuk ka kontroll të rregullt se deri në çfarë mase po i përmbushin kushtet e kontratës. Mungesa e një kontrolli të vazhdueshëm mund ta bie Agjencinë para vendimit të padëshirueshëm mbi marrjen prapë të ndërmarrjes nga investitori që e ka blerë ndërmarrjen e caktuar. Një situatë e tillë është e padëshirueshme dhe e dëmshme për zhvillimin ekonomik sepse, në rend të parë, humben shumë vende pune.

Shumica e ndërmarrjeve që janë privatizuar, janë në industrinë e rëndë dhe përpunuese. Ato, për më shumë se 10 vite i kanë humbur tregjet, ku i kanë plasuar produktet e tyre në kohën kur kanë funksionuar. Si rezultat, shumicës së ndërmarrjeve të privatizuara iu është ndërruar edhe destinimi. Megjithëse kjo gjë përcaktohet nga kushtet e tregut, pra është pronari i ri ai që vendos se si do të vazhdojë ndërmarrja më tutje, duke parë mundësitë në treg.

Është shumë e rëndësishme dizajnimi dhe aplikimi i një pakoje shumë më complete e politikës fiskale për të nxitur funksionimin e këtyre ndërmarrjeve. Mbetja në treg e këtyre ndërmarrjeve është tepër e rëndësishme për të përmirësuar deficitin e thellë tregtar të Kosovës. Të dhënat në terren tregojnë se një përkrahje e tillë mungon

plotësisht. Shihni rastin e privatizimit, ta zëmë, të vreshtarisë në komunat e Suharekës dhe Rahovecit. Një pjesë e madhe kanë mbetur djerrina. Tani është i nevojshëm përcaktimi i një agjende të qartë kohore se kur do të mbyllet i gjithë ky proces dhe si do të veprohet me përmbushjen e kërkesave të punëtorëve dhe të pretendentëve mbi pronën e këtyre ndërmarrjeve, kështu që diskutimi do të duhet të orientohet më shumë rreth kësaj teme, sesa në aktivitetet e gjertanishme të Agjencisë. Agjencia duhet të vazhdojë me angazhimet e saj, duke rritur transparencën dhe aplikuar metoda inovative për tërheqjen e sa më shumë investitorëve të huaj në privatizimin e ndërmarrjeve. Kjo është shumë e rëndësishme, duke pasur parasysh kapacitetin e ulët financiar të bizneseve kosovare dhe mundësitë jo të favorshme për kredi në bankat vendore. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Regjia, e shleu krejt listën. Për fjalë ishte në radhë deputeti Gani Geci, nuk është këtu. Unë nuk mund ta shlyej. Ishte i paraqitur Gani Geci në radhë. Në qoftë se është e shkruar, le ta sjellin si ka qenë e shkruar.

GANI KOCI : Ma dhanë mua fjalën, zoti kryesues.

GANI GECI: Po na përziejnë, dajë, mua e ty. Megjithatë, ju faleminderit, zoti kryesues! Unë nuk dua të hyjë thellë në privatizim, sepse nuk është në profesionin tim, por unë do të hyjë aty ku secilin qytetar e prek, do të thotë, ne jemi si parti e qendrës... Lidhja Demokratike e Dardanisë dhe jemi për privatizim dhe jo kundër privatizimit, por të jesh për privatizim, nuk do të thotë që të jesh kundër punëtorëve. Unë kam pasur rastin, si deputet i Parlamentit të Republikës së Kosovës, të kontaktoj me punëtorë të “Ramiz Sadikut”, të cilët ishin buzë greminës me një social prej 60 eurosh. Shuma që është privatizuar “Ramiz Sadiku” deri me tani kapë shumën mbi 25 milionë euro, ndërsa 20%-shi i tyre kap shumën mbi 3 milionë euro. Nëse atyre nuk u janë paguar 3 vjet 3 milionë euro dhe janë investuar paratë e tyre në një bankë komerciale, atëherë jep për të kuptuar se fitimi ka qenë 10% i atyre 3 milionëve euro, që do të thotë 1, 5 euro diku kanë shkuar paratë e 20%-shit të punëtorëve të “Ramiz Sadikut”.

Po flas vetëm për punëtorët e “Ramiz Sadikut” dhe nuk po flas për punëtorët e “Trepçës”, që tani për tani “Trepça” është nën menaxhimin e AKP-së, ka qenë në menaxhimin e AKM-së dhe punëtorët e Trepçës vuajnë për bukën e gojës. Them sinqerisht sepse të kishte qenë dikush nga ne, shkon në Shalë të Bajgores dhe takohet me minatorët, takohet me ata që në vitin '89 ishin në grevë të urisë dhe për 8 ditë me radhë ndejnë në grevë dhe tani nuk kanë bukë, kjo është një marri për ne. Do të thotë, ne jemi të obligueshëm dhe na obligon edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës, edhe ligjet që i kemi aprovuar vetë, që ta kemi një kujdes më të veçantë për punëtorët, konkretisht për punëtorët e “Trepçës” apo për minatorët, sepse ata tani për tani janë duke hequr të zitë e ullirit.

Tjetër, çka është me rëndësi, nëse bisedojmë për Ferronikelin, që të gjithë nuk mund ta kalonim pa e përmendur, unë do të përmend vetëm një fakt dhe ky është një fakt që kontrata që KEK-u e ka lidhur me Ferronikelin ka një variabël çmimin 6 centë. Ju keni pasur mundësi që në vitin 2008 të paktën t'i vilni 6 centë nga Ferronikeli dhe as këtë nuk e keni bërë, keni pasur mundësi në çdo 28 shkurt t'i vilni 6 centë nga Ferronikeli dhe këtë nuk e keni bërë kurrë. Nuk e keni rishikuar kontratën kurrë dhe, nëse sipas diskutimeve të djeshme, Ferronikeli i ka shkaktuar dëm KEK-ut 50 milionë, atëherë 6 centë janë bukur të mëdha në ato 50 milionë që keni pasur mundësi, në bazë të kontratës që është nënshkruar në mes të KEK-ut dhe Ferronikelit. Kjo nuk është bërë

kurrë. Do duhej bërë dhe nuk e di pse nuk e keni bërë? Nuk e keni bërë se, si duket, në ata 6 centë dikush i ka marrë nja 2 edhe ato 2 centë janë bukur të mëdha, nëse dikush i ka marrë. Pas 28 shkurtit nuk ka mundësi të bëhet rishikimi i asaj kontrate, po flas në bazë të informatave që kam unë dhe nuk jam pa informata në këtë drejtim.

Kur flasim për ekonominë, pa privatizim nuk ka ekonomi të qëndrueshme dhe nëse ne dëshirojmë ta bëjmë në ekonomi të qëndrueshme, atëherë ne duhet ta monitorojmë dhe ta mbikëqyrim privatizimin. Edhe ato ndërmarrje që janë privatizuar, është dashur të mbikëqyren dhe të monitorohen se a i kanë përmbushur obligimet që kanë pasur për t'i përmbushur gjatë kohës sa ishte AKM-ja. Kanë pasur t'i përmbushin obligimet që me spinoff special secila ndërmarrje e re është dashur të paguaj shumën e caktuar apo të bëjë investime në shumën e caktuar të mjeteve. Disa prej ndërmarrjeve, ne kemi pasur rast të dëgjojmë nëpërmjet mjeteve të informimit, nuk i kanë përmbushur obligimet e tyre dhe nuk është ndërmarrë asgjë kundër tyre dhe kjo është e papranueshme. Mandej, ne kemi edhe disa punëtorët, si punëtorët e hotelit "Grand", as ata nuk e kanë marrë 20%, që është dashur t'i marrin. Këto vonesa me 20% janë para, dikush po manipulon, ato para diku po i çojnë. Ne e dimë që paratë e privatizimit nuk janë në Kosovë. A thua qenka Kosova aq fort e ngritur ekonomikisht që paratë tona të shkojnë në vendet perëndimore, kur e dimë që Kosova është vendi më i varfët jo vetëm në Ballkan, por gati edhe në botë. Diku atje me Bangladeshin edhe me vendet më të varfra të botës krahasohet, bile Bangladeshi qenka vend i pasur, po më thonë këtu.

Prandaj, të nderuar deputetë, kemi obligim si deputetë, kemi obligim që para punëtorëve të "Ramiz Sadikut", që e kanë ndërtuar edhe këtë ndërtesë që ne jemi tani këtu, t'ua japim të paktën 20%-shin sepse edhe tash sa kam informata unë, me ato ankesat që i kanë bërë punëtorët, ka edhe persona që kanë vdekur para 17 vjetësh dhe tash kërkojnë 20%. Duke u shtyrë nga disa njerëz, ndoshta që janë edhe këtu. Do të thotë, edhe këtu kemi manipulime me emra të njerëzve që nuk kanë punuar apo disa punëtorë që kanë marrë rroga në Beograd dhe tash prej Serbie kanë bërë kërkesat që t'i marrin emrat dhe t'i marrin paratë dhe 20% në emër të punëtorëve të "Ramiz Sadikut". Ndërsa, ata kanë jetuar në Serbi, atëherë kanë marrë rroga prej "Ramiz Sadikut" dhe tash jetojnë në Serbi, por kanë mundësi të bëjnë ankesa dhe ndoshta Gjykata Supreme do t'ua aprovojë ankesat e tyre për shkak se kanë marrë rroga dhe kanë qenë në listat e punëtorëve, edhe pse ndoshta kurrë nuk kanë ardhur në Kosovë as në kohën e Krahinës Socialiste, as në kohën e UNMIK-ut. Prandaj, unë ju kisha lutur, si deputetë, që të kemi kujdes me privatizimin dhe ato ndërmarrje të privatizohen, edhe ndërmarrjet tjera, tokës bujqësore që tani po privatizohet, të mos i ndërrohet destinimi.

Unë them, sinqerisht, se i di disa ndërmarrje që kanë qenë fabrika dhe tash janë depo të "smokave", depo të "smokave" dhe "shtapiqave" dhe aty absolutisht nuk është destinimi çfarë ka qenë. Kanë qenë fabrika, tash janë depo "shokash". Çfarë kuptimi ka kjo? Atëherë kanë punuar, ta zëmë, 130 punëtorë, tash punojnë 4 punëtorë. Çfarë kuptimi ka kjo dhe ky privatizim nuk i duhet Kosovës.

Ne jemi për privatizim, do të jemi për privatizimin, sepse ne nuk jemi socialistë, nuk jemi as komunistë, por dëshirojmë që privatizimi të jetë i mirëfilltë, që privatizimi të jetë si i ka hije një shteti demokratik, të jetë transparent dhe të dihet secili cent që është marrë dhe që po jepet, ku po shkon dhe kujt. Agjencioni Kosovar i Privatizimit duhet t'i japë llogari këtij Kuvendi dhe në qoftë se ne kemi kërkuar që drejtori i Agjencionit Kosovar të Privatizimit të vijë para këtij Kuvendi dhe ai ka injoruar këtë kërkesë, kjo është e

papranueshme dhe ne lirisht mund të kërkojmë edhe llogari, një llogari që duhet ta di edhe ministri i Financave se është dashur drejtori, nëse është kërkuar prej një grupi deputetësh, ai të vijë këtu sepse ne e kemi zgjedhur dhe nuk ka kurrfarë kuptimi që një njeri që ne e zgjedhim, nuk e përfillë organin më të lartë që e ka zgjedhë. Kjo që ka ndodhur, unë besoj se nuk do të ndodhë më në të ardhmen, sepse ne duhet të ndërgjegjësohemi, edhe Qeveria, edhe Kuvendi, edhe Ministria e Financave, edhe Agjencioni Kosovar i Privatizimit.

Ndërsa, sa iu përket ndërmarrjeve publike, siç është KEK-u, mandej është Aeroporti dhe Postë-Telekomi i Kosovës, unë nuk to të hyjë thellë aty, sepse disa prej deputetëve janë marrë me këtë çështje pak më tepër dhe edhe disa të tjerë ndoshta do të flasin në këtë kontest. Unë besoj dhe jam i sigurt në këtë drejtim që ky debat do t'iu nevojitet atyre që tani janë në Agjencionin Kosovar të Privatizimit, që t'i hapin sytë dhe të punojnë ashtu si duhet dhe llogarinë ta bëjnë ashtu si duhet para Kuvendit, para organit që i ka zgjedhur. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Dua t'ju lus, sepse me herët kanë qenë më shumë të paraqitur, që t'i shtypni kërkesat e juaja për diskutim, me qenë se është shlyer lista e mëhershme. Nuk e di pse, çështje teknike. Nga regjia e lypa listën, por nuk e kanë dhe nuk kam çka të bëjë.

Fjalën e ka deputetja, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për kryeministrin, zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Ekonomisë dhe Financave, që po qëndron sot me ne,

Përshëndetje për të gjithë deputetët brenda kësaj seance,

Në rast se e kalojmë çështjen e privatizimit nga AKM-ja në AKP, atëherë duhet të bëjmë një dallim të përgjithshëm. Gjendja aktuale e ndërmarrjeve të privatizuara gjatë kohës të AKM-së, me Rregullore për qeverisje dhe operacione të AKM-së, mbi Rregulloren, mbi qeverisjen e përdorimit të tokës, Rregullorja mbi odën speciale në Gjyqin Suprem, politikat operacionale të AKM-së, rregullat e tenderimit dhe të procedimit, atëherë mund të them me shumë keqardhje se privatizimi në kohën e AKM-së është i dështuar me një vlerë shumë të vogël, diku shumë më pak se 400 milionë euro. Kur shihet se çka kemi përfituar prej privatizimit në kohën e AKM-së, mund të themi se kemi përfituar një numër të madh të të papunëve dhe ata në moshën jo të duhur, ku nuk di kah do të orientohen. Mirëpo, pas 12 shkurtit, mund të them se tash kemi Agjencionin Kosovar të Privatizimit, ku kompetencat do të jenë shumë më të mëdha ndaj këtij agjencioni dhe do të marrë përgjegjësitë e veta, njëkohësisht edhe për 20% e punëtorëve, ku dihet mjaft mirë se deri më tani janë shpërndarë diku 18 deri 19 milionë euro për punëtorët e ndërmarrjeve të privatizuara, gjë që do të thotë se ka mbetur edhe një numër i madh i punëtorëve, diku rreth 80 milionë euro pa u shpërndarë.

Mirëpo, sa ka qenë përgjegjësia e njerëzve të cilët në kohën e AKM-së kanë bërë këtë privatizim jo të mirë, jo të qartë dhe me Rregullore, asnjëherë nuk është dhënë përgjegjësi. Mirëpo, të kalojmë te privatizimi i ndërmarrjeve publike, që dy vendime na kanë ardhur për privatizimin e ndërmarrjeve publike, ku mjaft qartë për një shtet, siç është Kosova dhe një shtet demokratik, pikë së pari nga ministri i Ekonomisë dhe Financave, që është prezent këtu brenda këtij Kuvendi, është dashur të vijë një strategji nacionale për zhvillimin ekonomik të Kosovës, të plotësohet infrastruktura ligjore për ndërmarrjet publike, për privatizimin e ndërmarrjeve publike dhe njëkohësisht të dihet

plani i veprimit gjatë privatizimit të kompanive publike të cilat janë pronë e qytetarëve dhe jo pronë e një qeverie, e cila tash është, në kohën e ardhme nuk dihet si do të rrjedhë situata. Mirëpo, me një shpresë që kemi njeriun e parë të Qeverisë këtu dhe njeriun e parë i cili duhet të merret me privatizimin e ndërmarrjeve publike, ministri i Ekonomisë dhe Financave, të përgatitë infrastrukturën e duhur ligjore, që do të thotë se brenda infrastrukturës ligjore të këtij Kuvendi nuk është Ligji i posaçëm, ministër, për privatizim të ndërmarrjeve publike, ku do të thotë se shumë qartë e ke Ligjin vetëm për ndërmarrje publike dhe me shitjen e disa aseteve nuk do të thotë se mund të bësh privatizimin.

Përgjegjësi e gjithë Qeverisë është që me kompanitë me zhvillim të madh nacional për Kosovën, dihet si të procedohet me to. Askush nuk është kundër privatizimit, por me një privatizim të mirëfilltë, mos të prodhojmë krizë sociale për qytetarët e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Për fjalë është paraqitur Kryeministri, zoti Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Të faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar deputetë,

E falënderoj grupin e deputetëve për iniciativën që e ka marrë për këtë debat, mendoj të dobishëm edhe për Kuvendin, edhe për Qeverinë, edhe për të gjitha institucionet.

Mendoj se një debat i tillë është shumë i mirëseardhur, jo vetëm në nivel të institucionit në Parlament, por i ndihmon edhe shoqërisë dhe të integrohet, natyrisht, në këtë debat edhe shoqëria civile, edhe mediet edhe të gjithë njerëzit e dijes, të shkencës dhe njerëzit të cilët mund të kontribuojnë në këtë proces.

Pse e them këtë? Sepse shumica e vendeve në tranzicion kanë pasur probleme dhe nuk kanë kaluar pa vështirësi procesin e privatizimit dhe nëse e krahasojmë me vende tjera, mendoj se ka ndodhur këtu një diçka më e mirë se në shumë vende tjera të tranzicionit demokratik, me përvojë shumë më të gjatë shtetformuese. Por, këtu duhet vlerësuar punën e mirë që është bërë prej nesh, por edhe këshillat e mira të miqve ndërkombëtarë.

Në anën tjetër, dëshiroj të theksoj se trendi i privatizimit, flas nga periudha që e qeverisë unë, është duke ecur në mënyrë shumë pozitive, që nga koha e themelimit të Agjencisë së Privatizimit të Kosovës në shtatorin e vitit të kaluar. Unë këtu nuk flas në emër të AKP-së, por aq sa jam i informuar dhe i informuar zyrtarisht, nuk kam pasur ftesë zyrtare për të qenë në Parlament, ftesë zyrtare, flas. Ndërsa, nuk e arsyetoj ardhjen, mosardhjen, por aq sa jam i informuar zyrtarisht, ata nuk kanë pasur ftesë zyrtare për të qenë në Parlament dhe, nëse nuk kanë pasur, nuk i arsyetoj, nëse kanë pasur, gjithashtu. Në anën tjetër, dëshiroj të theksoj se gjatë kësaj periudhe gati njëvjeçare janë përgatitur 7 valë të privatizimit dhe deri në shtator do jenë edhe tri, pra 10 valë.

Kjo nënkupton se procesi i privatizimit është duke ecur, është duke u menaxhuar në mënyrë shumë transparente. Por, ajo që dëgjova edhe sot në Parlament, vlerësimin më të lartë për secilin prej juve, është ajo se shumë diskutime më kanë përngjarë në periudhën kur ne i kemi ngritur problemet kur kemi qenë në opozitë, për problemet janë krijuar në atë kohë që po flasim edhe sot, se këtu po flasim për periudhën e mëhershme.

Këtu kemi të bëjmë me dy filozofi. Po, po, me dy filozofi. Filozofi politike, filozofinë politike mund ta them në kuptimin e asaj të ekonomisë të lirë të tregut dhe të asaj centraliste. E theksoj, të ekonomisë së lirë të tregut dhe të saj centraliste. Unë do të vazhdoj me ekonominë e lirë të tregut nga të udhëhequrit e Qeverisë së Kosovës. Në anën tjetër, u përmend... unë jam jo shumë ithtar i ideologjive apo aspak ithtar i ideologjive, por edhe të proklamohet dikush si i djathtë dhe të flasë me mentalitet centralist të së kaluarës apo socialist, apo komunist, nuk shkojnë bashkë, por kam deklaruar qartë, filozofia ime është për ekonominë lirë të tregut dhe privatizimi do të vazhdojë.

Në anën tjetër, dua të theksoj se u përmendën këtu veprimet e mëhershme.

Mjetet e privatizimit janë dërguar jashtë vendit në kohën e Qeverisë së kaluar, unë po punoj për t'i rikthyer në vend. Veprimet e mëhershme në kohën e kaluar që u përmendën këtu, kanë qenë në periudhë kur ministrat e Qeverisë së kaluar kanë qenë anëtarë të Bordit, nënkryetar të Bordit të Privatizimit dhe flas për ministrat, pastaj kush ka qenë aty, ka qenë punë e madhe.

Pra, papërgjegjësitë, e flas, papërgjegjësitë dhe veprimet që kanë ndodhur më herët në kohën e kaluar, në kohën e qeverisë së kaluar, kur ministrat kanë qenë anëtarë dhe nënkryetar të Bordit të Privatizimit, nuk i marrë përsipër ato pasoja. Nëse ka shkelje ligjore dhe verifikohen në këtë drejtim, unë nuk e sulmoj askënd, nuk e akuzoj askënd. Nëse ka shkelje ligjore, unë gjithashtu nuk do ta mbrojë askënd, po këtë duhet ta thonë vetë organet e drejtësisë.

Ju e dini, menjëherë me formimin e qeverisë aktuale, kam vendosur që ministrat, për të shkëputur nga ato veprime jo të qëlluara dhe shumë kritike nga opinioni publik, por edhe për të larguar ndikimin nga vendimet në procesin e privatizimit, kam vendosur që ministrat të mos jenë anëtarë të Bordit, pra për t'iu ikur ndikimeve nga Qeveria, që është dallim jashtëzakonisht i madh nga Qeveria e kaluar, që ishin drejtpërdrejt ministrat në Bordin e Privatizimit dhe ndikonin dhe me procesin aktual, që nuk janë ministrat dhe nuk kanë mundësi të ndikojnë. Menjëherë kam kërkuar dhe po paguhet 20% për punëtorët. Gjithashtu, kam kërkuar që të rishikohen a janë realizuar të gjitha obligimet nga kontratat.

U përmendën këtu edhe disa raste të cilat i kemi ngritur qysh herët si problematike dhe veprime jo shumë të qëlluara apo edhe me ndikime, 2 – 3 raste këtu u përmendën, të cilat dua t'i përmend edhe unë sot.

U përmend Ferronikeli dhe flitet për dobësi, për ndikime, për mbrapshti, për proces jotransparent. Ai vendim i atij procesi të Ferronikelit, pa dashur të sulmoj, akuzoj askënd, ka ndodhur më tepër se para 2 vitesh, ka qenë një privatizim, u theksua, i disfavorshëm, është e butë të thuhet i disfavorshëm, por është një vendim i ministrave që kanë qenë në Bordin e Privatizimit të Qeverisë së kaluar.

U përmend marrëveshja e disfavorshme e energjetikës. Pajtohem plotësisht ka qenë një marrëveshje jo vetëm e disfavorshme, por tepër e keqe, e dëmshme dhe kemi ngritur zërin edhe më herët dhe pajtohem plotësisht. Po edhe kjo marrëveshje ka ndodhur më tepër se para dy vitesh, po nuk mund të adresohet në adresën që pretendohet të adresohet sot.

U përmend nga deputeti i Drenicës çështja e Drenasit dhe e helmimit të qytetarëve të Drenasit. Edhe ajo marrëveshje ka ndodhur para dy vitesh e gjysmë dhe pajtohem plotësisht dhe duhet ndodhin përmirësime. Tash, kjo çështje, në mënyrën më të sinqertë të mundshme ju pyes, a ngrihet për interesa tepër të ngushta apo parimore. Do me thënë, para 3 vitesh, dy vite e gjysmë, kanë qenë çështje parimore, tash janë interesa tepër të ngushta. Ne po përpiqemi për t'i përmirësuar ato gabime që kanë ndodhur në të kaluarën, të nderuar deputetë. Unë nuk mbyll ndërmarrje, por edhe nuk i përsëris gabimet e të tjerëve, se nuk nënshkruaj marrëveshje në disfavor të vendit, disfavor të punëtorëve, për t'i helmuar njerëzit për interesa të ngushta të kujto qoftë, asnjëherë.

U përmend mbrapshtia e "LLamkosit". Edhe ajo marrëveshje është e para 2 – 3 viteve e më tepër, që gjithashtu ju e dini shumë mirë se cilët ministra kanë qenë në Bordin e Privatizimit. Unë, me procesin e privatizimit nuk e akuzoj askënd, por aty ka ndodhur një mbrapshti të cilën ...

KRYESUESI: Le t'i vazhdohet Kryeministrit edhe pak kohë.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Prandaj, ato mbrapshti që kanë ndodhur më herët, nuk mund të adresohen në Qeverinë aktuale.

U përmend, gjithashtu, procesi i privatizimit të distribuimit të KEK-ut, i Valës, koncesioni i Aeroportit. Po, do të ndodhin, por dallimi është se do të ndodhin në mënyrë shumë transparente. Gjithashtu, ka vërejtje, e di, kur ndërtohen rrugët ka vërejtje, mos të ndërtohen rrugët. Duhet të vazhdohet me ndërtimin e rrugëve. Ndërtohen shkolla, pse po ndërtohen shkolla. Duhet të ndërtohen shkollat. Tash e theksoj edhe një herë, duhet të bëjmë dallimin dhe ne do të vazhdojmë me këtë proces, por mbrapshtitë e kaluara le të mbesin në të kaluarën, ndërsa punët e mira që bëhen, le të vlerësohen. Dua të theksoj se ky proces do të vazhdojë, unë do ta respektojë ekonominë e lirë të tregut, procesi është shumë transparent, të sundimit të ligjit, të luftimit të dukurive negative në proces dhe mentalitetin centralistë le ta mbajë secili që dëshiron ta mbajë. Kështu që, kemi dy filozofi politike, filozofi për të cilën populli na ka votuar dhe dikë e ka ndëshkuar për diçka të keqe, gjithashtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Rexhepi është paraqitur për replikë.
Deputetit Arsim Rexhepi, mikrofonin, ju lutem!

ARSIM REXHEPI: I nderuar zoti Kryeministër,
Ju, me praninë tuaj veç vërtetuat edhe një herë përgjegjësinë që duhet ta ketë kjo Qeveri përballë këtij problemi më madhor që e ka shoqëria e Kosovës.

Unë, bashkë me shokët që e kemi nisur këtë, po, po me shokët që kam një ideologji, gjithçka është ideologji, që e kemi nisur këtë iniciativë, ne që e kemi nisur këtë iniciativë, nuk e kemi nisur në asnjë mënyrë me tendencën që ta njollosim dikë, as që të bëjmë barriera ndoshta të panevojshme kësaj qeverie. Qëllimi ka qenë krejtësisht human dhe s'do ta teproja të them patriotik, mbi të gjitha për ta vënë gishtin mbi një plagë dhe mbi një hall që ky popull e flet te shtëpia, e flet në sofër, e flet në rrugë dhe e flet gjithkund. Do të thotë se procesi i privatizimit, nëse ka shkuar para dy vjetësh shumë keq, zoti Kryeministër, dy vjet e këndej çka keni përmirësuar, qe dy vjet e këndej do me thënë, çka keni përmirësuar? Ferronikeli edhe merr rrymë po aq të lirë sa e ka marrë para 2 – 3 vjetësh. "Llamkosi" po mbyllet krejtësisht.

Kemi pastaj, mos të flasim për 20%, që nuk është kthyer hiq dhe tek kur ia ka nisur kjo iniciativë për këtë debat, ka lëvizur AKP-ja me një informatë se gjoja, brenda javës do të japim diku rreth 1 milion e gjysmë euro nga ...

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti Kryeministër ka një sqarim.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuari deputet Arsim,

Ne ndajmë opinione të njëjta për problematikat të cilat i ke ngritur dhe më vjen mirë që i ke ngritur. Ju falënderova në fillim për ngritjen e kësaj problematike.

Pasojat e atyre vendimeve jo të mira, jo të drejta, të papërgjegjshme, të dëmshme janë duke i përjetuar të gjithë qytetarët e Kosovës, e në kuadër të kësaj edhe ne. Por, ne po mundohemi t'i përmirësojmë dhe t'i tejkalojmë ato pasoja, po përgjegjësi si Qeveri nuk marr për veprimet e dëmshme të së kaluarës dhe e bëj vinë e kuqe të ndarjes dhe besoj që pajtohesh edhe vet. Unë, nuk desha të hyjë në disa sqarime tjera shtesë të cilat ju i keni ngritur në fjalimin tuaj, se ju e keni ngritur edhe një çështje pak më të gjerë të mos zhvillimit prej nga vjen ti, qysh ka shkuar puna, që nuk është investuar kurrë hiq këta 10 vjet e tutje, që ju i ngritët.

Tash, dua të theksoj se dallimi është i madh. Kanë ndodhur, e përmenda, shtatë valë, do të ndodhin edhe tri valë deri në shtator, por ma gjejë vetëm një rast, vetëm një rast nga këto 7 valë që janë të dështuara apo të dëmshme dhe jo transparente, ma thuaj vetëm një rast, të lutem. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka Ibrahim Makolli!

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

(Reagim nga salla)

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Seriozisht, është një temë e qëlluar dhe nuk do të ishte mirë që të devalvojë e gjithë kjo që u tha deri tash. Natyrisht, tash ne po merremi me pasojat e shkaktuara kaherë. Po më vjen keq ta them, por ka këtu një pjesë të njerëzve të cilët janë fajtor të drejtpërdrejtë për këtë gjendje të shkaktuar, ndërkaq e thashë, sa për t'u arsyetuar para qytetarëve, afër fushatës zgjedhore po bëjnë përpjekje që krejt këtë faj ta qesin në një rrafsh tjetër.

Ajo që mua më intereson më së shumti, po besoj edhe secilit qytetarë të këtij vendi, është të dihen pronarët që kanë privatizuar ndërmarrjet në Kosovë, duke përfshirë edhe tokën bujqësore të mbrojtur me ligj, e që kundërligjshëm është shndërruar në tokë ndërtimore. To të ishte mirë, sepse në opinion qarkullojnë lloj-lloj fjalësh, që të dihet publikisht se të cilët janë ata njerëz që kanë privatizuar me qindra e qindra hektarë toke të bukës në Kosovë edhe ndërmarrjet që i kanë shndërruar në diskoteka ose në garazhe, e para.

E dyta, që u përmend shumë herë këtu, ne kemi gati për çdo ditë, edhe para këtij Kuvendi, po në veçanti para selisë AKM-së, tash Agjencisë Kosovare të Pronës, kemi me qindra punëtorë të cilëve nuk iu është realizuar e drejta e tyre e 20%-shit, e që

padrejtësisht këta njerëz i detyrojnë të lëvizin herë para Agjencionit, herë para Qeverisë, duke ia gjuajtur fajin njëra-tjetrës, se kush do të duhej... Kujtoj që këto të dyja pikërisht do të duhej të ishin një shembull i mirë, që këto ndërmarrje që kanë mbetur të paprivatizuara dhe që do të privatizohen në të ardhmen, të kenë një pasqyrë të qartë dhe të ketë një transparencë serioze para qytetarëve të vendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Zëvendëskryeministër, ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Personalisht nuk do të doja që sot ta kem rolin e prokurorit, apo të prokurorëve në këtë rast, sepse mendoj që ata që dinë për keqpërdorime, duhet ta kenë guximin intelektual dhe qytetarë që t'i paraqesin ato në organet e drejtësisë.

Në këtë rast, shkoi edhe zoti Kryeministri, kjo vlen edhe për të, duke pasur parasysh se personalisht ka deklaruar zero tolerancë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, e jo vetëm të na deklarojë se kanë qenë veprime të papërgjegjshme dhe të dëmshme dhe askush të mos përgjigjet deri më sot.

Për mua si deputet, ajo çka do të ishte me rëndësi të informohem nga informata e kërkuar, është se cilat janë efektet e privatizimit, në përgjithësi, dhe a janë mbushur objektivat e premtuara, jo vetëm për Ferronikelin dhe Llamkosin, po ne kemi shumë ndërmarrje të cilat janë privatizuar me spinoff special, por për procesin e rritjes apo të mos rritjes ekonomike të vendit tonë. Po, janë disa çështje: cila është rritja e eksportit në Kosovë? A ka rezultat të ngritjes së të hyrave doganore? A është zbutur papunësia dhe varfëria në Kosovë, në këtë rast, duke marrë parasysh ndërmarrje, nga ndërmarrjet të privatizuara dhe është jo e kuptueshme, për mua, se si është lejuar mosaktivizimi i një numri të madh të ndërmarrjeve të privatizuara me spinoff të rregullt dhe nuk është bërë monitorimi i tyre se cila është gjendja në to.

Mendoj, të nderuar kolegë deputetë, unë mendoj se ky model i privatizimit duhet të rishikohet së shpejti nga Qeveria dhe Kuvendi, sidomos hartimi i legjislacionit në përputhshmëri me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, sepse ky legjislacion i ndërlikuar ka ndikuar dhe do të bartë probleme edhe në të ardhmen, sidomos me pronat e konfiskuara nga sistemi jugosllav, këtu mendoj nacionalizimi i tokës bujqësore në atë kohë. Prandaj, e shoh të domosdoshme hartimin e Ligjit mbi rikthimin e pronës, si në të gjitha vendet apo shtetet në tranzicion që kanë kaluar në Evropën Lindore për të eliminuar ndërlikimet dhe eksproprijimin e tokës në veprimtari të tjera. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka Ardian Gjini!

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit! Mendoj se duhet dy ose tri çështje të përmenden shpejt e shpejt këtu. Ju kujtohet kur kemi folur për bordet, të gjitha, posaçërisht për Bordin e Agjencionit të Privatizimit, e kemi pas tërhequr vëmendjen se nëse ministrat janë në Bord, Kuvendi ka të drejtë t'i ftojë këtu përpara vetit dhe të diskutojë, t'i marrë në përgjegjësi në njëfarë forme dhe kemi thënë që nëse ministrat, nëse anëtarët e Bordit nuk janë njerëz të cilët mund t'i thërrasë Kuvendi, ata kanë për t'iu përgjigjur vetëm një njeriu, vetëm një parti edhe kështu po ndodhë. Tani duhet Kryeministri t'i arsyetojë veprimet e dikujt tjetër dhe definitivisht që duhet, se i ka emëruar vet. Kjo është pika e

parë, do të thotë, nuk ka të keqe që njerëzit nëpër këto borde të jenë politik për shkak se ne i thërrasim këtu para nesh dhe ky ka qenë argumenti. Do të thotë, nuk është kurrëgjë e mirë nëse ata nuk janë politik, është bash e keqe se i kontrollon vetëm një njeri ose vetëm një grup i vogël i njerëzve, një klan.

Çështja tjetër është se u përmend Ferronikeli dhe duhet të flasim për Ferronikelin, do me thënë kur Kryeministri i Kosovës ka qenë opozitë, ka qenë tepër i zëshëm për të gjitha aferat rreth Ferronkelit, ndërsa kur është hapur, ka shkuar ia ka prerë shiritin. Tani këtu është një çështje që duhet dhënë përgjigje ne, a ka qenë krejt ajo çka ka thënë për Ferronikelin para se t'ia presë shiritin farsë, apo nuk ka ditur se çka po ndodhë vetëm, e ka... Qeverinë atje apo çka ka ndodhë, se diçka në rregull nuk është. Nëse dikush prej nesh sot këtu nuk zgjedh fjalë për ta denigruar një proces dhe në fund shkon ia prenë shiritin vet, atëherë diçka në rregull nuk është dhe me siguri dikush duhet dhënë një përgjigje këtu. Do me thënë, me qenë se vetëm u përmendën njerëzit e ish Qeverisë dhe u përmendën të tjerët, le të tregojnë pse kanë shkuar, le të tregojë dikush pse po mbyllet Llamkosi, kush i ka fajet që po mbyllet.

Edhe një çështje tjetër, e fundit, se e di që edhe të tjerët donë të flasin dhe është bërë njëfarë kohe, po ju them një pyetje që e bëri deputeti Arsim Rexhepi. Hajde, po supozojmë për një moment që krejt çka ka ndodhur në të kaluarën, ka qenë keq. Sa vjet i duhen Qeverisë aktuale për t'i kthyer mjetet që janë dalë jashtë, që po thotë ne po punojmë për t'i kthyer. Sa vjet i duhen, 10 vjet, 15 vjet, 20, por le të na tregojë. Sa vjet i duhen për t'i ndërruar procedurat - 5, 6, 7,8, 10, se një e gjysmë nuk po i mjafton. Sa vjet duhen për të ndërtuar transparencë, sa mandate, le të na tregojë prapë, se me siguri një mandat nuk po i del. Dhe, e fundit është, kushdo që i njeh qeveritë dhe ka shumë njerëz këtu në Kuvendin e Kosovës, edhe në qeveri që e njohin sistemin e qeverisjes, që i njohin qeveritë, e dinë që nëse një Qeveri për 6 muaj nuk ndërton diçka që preket, nuk kanë për t'i mjaftuar as 6 vjet për të ndërtuar diçka që preket. Është e kotë. Edhe tani e themi se do të ishte mirë që në raportet që bëhen e që na vijnë për çka do qoftë, le të flasë secili për temën e vet për shkak se po na nxjerrin tema totalisht të paarsyeshme, të pavlefshme dhe të padobishme për vendin për t'u shtyrë me fjalë, pa treguar asnjë gjë të vetme. Ne dëgjuam duke folur kreun e Qeverisë dhe nëse dikush e kthen traken dhe thotë çka ka folur, çka na ka treguar sot, çfarë të reje kemi marrë – asnjë gjë të vetme, asnjë fakt, asnjë të arritur, asnjë send, vetëm skajshmërisht retorikë për ish-Qeverinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar kryesues,
Qeveritarë dhe deputetë të respektuar,

Unë jam një nga peticionarët e mocionit për këtë temë, kurdoherë e kam konsideruar temë të rëndësishme- topike. Fillimisht, zotëri Ramosaj e dha një historik të shkurtër, por të dobishëm për auditorin. Veç do të kisha theksuar se spinoffin edhe vetë personalisht Xhon Dikson, një personalitet shkencor dhe politik i rëndësishëm me relevancë e ka kundërshtuar në mënyrë më të përshtatshme edhe si duket ajo i ka kushtuar nga pozicioni. Dua të them se abinicio, nga fillimi, sistemi i privatizimit nuk ishte në rregull, ka shumë defekte si sistem e si koncept dhe se andejmi janë edhe pasojat, rrjedhat negative, sepse gjithsesi ishte dashur të ishte transformimi i pronës e jo privatizimi medoemos, se edhe shteti duhet të ketë prona, asete e tjera. Edhe me këtë edhe shumë faktorë të tjerë është krijuar një oportunitet tepër i volitshëm për apropiacione abuzive që janë bërë. Shumë

prona me vlera janë privatizuar, janë përvetësuar, janë apropriuar nga entitetet e dyshimta dhe të panjohura. Kishte këtu mjaft diskutues që potencuan se do të duhej të dinte populli i përvuajtur i këtij vendi se kush është pronar i 300, 400, 500 e më tutje hektarëve tokë buke?

Ka shumë kontrata problematike, referuar privatizimit. Dhe, aq më parë, ato edhe si të tilla nuk përfillen, e kjo është e patolerueshme në një shoqëri demokratike dhe në një shtet të së drejtës që pretendojmë të jemi, se kontrata njëjtësohet në njëfarë mënyre me ligjin që quhet bile pacta sun servanda – kontrata duhet të përfilllet, nëse nuk përfilllet, e këtu është në pyetje republika – interesi i përgjithshëm, e ku është interesi i përgjithshëm, Qeveria nuk mund të thotë jam indiferente për ato që ndodhin, për ato mbrapshti e tjera e tjera, sepse ne në Qeveri i kemi sytë. Qeveria ka kapacitet, ka legjitimitet për të vepruar edhe kundër lëshimeve të mëparshme, natyrisht, me plot energji edhe të tashmëve dhe për të vu rend në këtë rrjedhë tepër të rëndësishme.

Kush ka legjitimitet aktiv proceduror në këtë? Askush më tepër se Qeveria, se i ka instrumentet, i ka mekanizmat, për atë ne i adresohemi Qeverisë, jo në kuptimin për ta kritikuar, por për të kërkuar për t'i bërë ato punë që është dashur t'i bëjë e që duhet t'i bëjë.

Zotëri kryesues,

Deputetë të nderuar,

Çështja e pronës në Kosovë është çështja më e ndërlikuar, çështja më topike. Prej vitit 1912 e deri pothuaj se sot kanë ndodhur transformime ilegale, ilegjitime më të ndryshme, duke u nisur prej deprivimit të dhunshëm të tokave, pastaj eksproprijimeve më se të ndryshme, varianteve të ndryshme, nacionalizimeve, arondacioneve, kooperativizimeve dhe më në fund tani i ashtuquajturat korporatizivim që nuk ka kurrfarë lidhshmërie me korporatat, pastaj problemet rreth regjistrimit të pronave pikërisht të trashëguara brez pas brezi që nuk janë në emrat e pronarëve legjitimë. Kjo është një çështje tepër e rëndësishme.

Do ta shfrytëzoj këtë oportunitet për t'i apeluar Qeverisë, sepse e ka këtë mundësi për ta nisur projektimin e ligjit për pronat. Është një ligj që me të do të zgjidheshin shumë çështje që janë lëmsh dhe janë tepër të rëndësishme, janë jetike dhe vitale.

Unë angazhohem, përpos të tjerave, po e zëmë, që kontratat që nuk përfillen të përfillen. Jo kështu me ton moralizues që duhet, po ka instrumente, Qeveria lë t'i aplikojë. Kur janë në pyetje astetet publike, e kontratat nuk përfillen, u fol këtu, për hir të kohës, nuk po i tregoj rastet po e zëmë që janë shndërruar veç, ndoshta, në kotece të pulave se nuk kanë leverdi ata-ato, apo jo, fare nuk u janë përmbajtur klauzave të kontratave. Ka shumë kontrata të pavolitshme, në disfavor të interesit publik, ekziston instituti juridik rebus sic santibus që mund të rishikohen ato, në qoftë se nuk do kontraktori i favorizuar ekziston ose arbitrazhi ose litigacioni. Këto janë rregulla që ekzistojnë edhe në rezolutë të OKB-ës për zgjidhjen e konflikteve në kontrata.

Ku janë paratë, po e zëmë? Janë diku jashtë. Përpjekën për t'i prurë. Ku janë dokumentet që u dogjën? Unë angazhohem që ta ngremë një komision parlamentar me detyra të caktuara, me autorizime të Kuvendit për t'i ndërmarrë masat e nevojshme që mund t'i ndërmarrë duke marrë parasysh theksat që i potencuan diskutuesit e mëparshëm, por do të isha angazhuar edhe këto që unë i thashë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit! Unë pata tjetër send për të thënë, por mbasi më qitët prej rendit, e ndryshova edhe atë që desha ta them, do të jam pak më konkret.

Së pari, dua t'i bashkëngjitem kërkesës së zotit Naim Maloku, nga AAK-ja, por edhe të zotit Rugova, nga LDD-ja, që të bëhet kërkesa të na sjellin raportin për Ferronikelin, sidomos për kontratën e konsumatorit të privilegjuar të Ferronikelit, kurse unë do ta shtoja edhe një kërkesë. Pra, unë kam kërkuar edhe paraprakisht, domethënë, edhe në seancën e 20 nëntorit, por edhe në seancën e 16 prillit, që të na sillet një raport i thukhtë për Ballkanin e Suharekës për shkak se edhe atje ka shkelje enorme të procedurave.

Të nderuar të pranishëm,

Këtu shumë deputetë folën, po edhe ky raport disi tenton që të ndahet përgjegjësia nga AKM-ja dhe AKP-ja dhe në përgjithësi procesi i privatizimit. Unë pajtohem me parafolësit që thanë se këtu përgjegjësia është individuale, nuk është partiake, nuk është qeveritare, por është thjesht individuale, e mund të jetë edhe e grupeve të njerëzve që i ka lidhur interesi i përbashkët.

Them se privatizimi në periudhën e fundit ka qenë i udhëhequr nga Ryckeri i famshëm, i cili në janar të vitit 2007 intervenon personalisht që të ndërpritet apo të mos publikohet Raporti i Auditorit të Përgjithshëm, që gjen një varg shkeljesh, me theks të posaçëm te Ferronikeli. Zëvendës i Ryckerit ka qenë Paul Alcda. Për opinionin, Paul Alcda sot është shef i Doganave të EULEX-it.

Sistemin juridik na ka dizajnuar Borg Olivier udhëheqësi i Shtyllës së dytë. Sot ky zotëri është këshilltar i Kryeministrit. Sipas të dhënave që i kam, merr rrogë enorme, rrogë çfarë ka marrë në AKM. Dhe, pyetja ime është, se Kryeministri na iku, desha ta pyes se prej nga e paguan atë, a e paguan nga buxheti atë këshilltar me rrogë, po them, enorme dhe duhet ta qartësojë pozicionin e tij si këshilltar.

Siç dihet, zëvendës drejtor ka qenë zoti Ahmet Shala, që sot është ministër i Ekonomisë dhe Financave. Nëse e merrni "Kohën Ditore" të 24 majit, thuhet – dosja e Ferronikelit, PDK-ja ishte neutralizuar përmes Ahmet Shalës, ku ka aligacione shumë serioze ndaj ministrit aktual se ka ndikuar në PDK që të ndryshohet qasja ndaj privatizimit të Ferronikelit dhe ato dyshime janë nga drejtori i tij John Johnson. Unë këtë pyetje ia kam pas bërë më 15 korrik, zotit Kryeministër, ai më tha mua kështu, është përgjigja nranskript mund ta shihni, ndër të tjera, thotë : “ nuk dëshiroj të merrem me spekulime mediale, as të komentoj letra private”. Kemi me të bëjmë me John Johnson, njeriun e parë të AKM-së apo bosin e Ahmet Shalës, ministrit, derisa nuk e zëvendësoi.

Dhe, tash do ta citoj zotin Ahmet Shala lidhur me një pyetje që i është bërë në Parlament, më 12 maj, nga zoti Naim Maloku për privatizimin e Ferronikelit. Zoti Ahmet Shala thotë kështu: “për sqarim të opinionit, pozicioni më i lartë në AKM ka qenë bordi”. Të nderuar, për ata që kanë harruar, Bordi i AKM-së në atë kohë është udhëhequr nga Dino Hasanaj, nënkryetar, dhe po ashtu në Bord kanë qenë Bahri Shabani dhe Haxhi Arifi, si përfaqësues të sindikatave në periudha të caktuara.

Dhe, tash unë po kthehem këtu te raporti i AKP-së. E keni në paragrafin e parafundit, ku thotë: “për herë të parë qasja në objektet e ish AKM-së” e të tjera, e të tjera dhe duhet të përmendet fakti se nuk ka pasur pranim nga zyrtaret e AKP nga AKM-ja. Unë s’di çka ka mund të ndodh aty. Dino Asanaj ka qene vet nënkryetar, çka është dashur që ai t’ia japi vetvetes çelësat, dmth prej dorës së majtë çelësin ta vinte në dorën e djathtë. Ai ka qenë zëvendës, apo nënkryetar i Bordit. Domethënë, çfarë ceremonie është dashur prej AKM-së në AKP, kemi të bëjmë me një person. Dhe, unë do të doja, po ashtu, më shkoi Kryeministri, desha veç ta pyes se çfarë janë marrëdhëniet e Ardian Shatkut dhe të Dino Asanajt. Ardian Shatku, për ata që s’e dinë, është pronari kryesor, apo aksionari kryesor i Konzorciumit ” Dardafon” që e ka marrë PTK-në, e ka privatizuar. Sepse pyeti zoti kryeministër, tha a keni raste konkrete, prandaj po bëj pyetje konkrete?

Pastaj, thuhet kështu në paragrafin e parafundit dhe duhet përmendur ... se nuk ka pasur edhe tjera e tjera, kjo ka shkaktuar që agjencia e re, domethënë AKP-ja të përballet me vështirësi të jashtëzakonshme. Kemi hasur në gjurmën e dokumenteve të djegura, në dokumente të ndryshme të hedhura, e tjera, e tjera. Kush ka harruar, unë këtë pyetje e kam bërë më 19 shtator 2008 dhe kështu kam pyetur më 25 gusht u publikua lajmi se më 24 gusht është djegur Arkivi i Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit e tjera, e tjera. Është përgjigjur ministri i Punëve të Brendshme. Ndër të tjera ai thotë se... Policia ka asistuar e tjera, e tjera në objekte, por nuk kemi pasur ndonjë kërkesë të veçantë për çështjen e dokumentacionit dhe më lejoni t’ju them, po ashtu, se asnjë kërkesë deri më tani nuk ka ardhur me një shqetësim të tillë nga Agjencioni ynë, domethënë AKP-ja. Dikush po gënjen këtu, burra! Ose ky është shkruar keq, ose ministri na ka dezinformuar. Këtu duhet dikush të japë përgjegjësi. Kemi dy informata në mënyra krejt tjera, të ndryshme duke na u dhënë.

Ajo që unë pajtohem, është në faqen e dytë, thuhet këtu, ndër të tjera – më duhet të them se fillimisht kemi vërejtje defekte nga e kaluara, pra nga- ish AKM-ja, që kryesisht kanë të bëjnë me parakualifikim, seleksionim të dobët, domethënë, me korrupsion, me një fjalë. Shikoni, një nëpunës shumë i lartë i AKM-së, privatizohet Llamkosi, ai ka qenë Luan Berisha, bëhet drejtor i Llamkositt. Pastaj, një nëpunës tjetër shumë i madh në AKM, që së bashku me Kirk Adamsin e kanë udhëhequr privatizimin e Ferronikelit, ai është Artan Bajrush, bëhet drejtor i Administratës, është drejtori kryesor në Ferronikel.

Shikoni, këto janë gjëra që ndodhin, ndodhin për të të plasur barku dhe askush s’merr kurrfarë aktiviteti, madje thonë se nuk ka ndodhë kurrgjë këtu. Andaj, po them, përgjegjësia është personale duke marrë parasysh edhe faktorin ndërkombëtar për shkak se në atë raportin që e ka ndaluar i famshmi Ryecker, shkruan kështu, ndër të tjera. Pra, thuhet se auditorët në procesin e privatizimit kanë hasur në një varg shkeljes ligjore dhe shmangie nga procedura, të cilat janë bërë me dijeninë e të stafit ndërkombëtar, Bordit të AKM-së si dhe të atij vendës. Komenti më duket është i tepërt.

Përsëri po them, apeloj që ta zvogëlojmë dëmin në Ferronikel, të sillt certifikata e konsumatorit të privilegjuar. Që të mos te zgjas, sepse kanë për të folur edhe të tjerët, po apeloj të gjithë të tjerët që kushdo që të flas, të mos të flasim me teorema, por kemi një rast shumë praktik, krejt e dimë se çka ka ndodhur, me emra dhe mbiemra për shkak se përgjegjësia është personale. Faleminderit!

KRYESUESI EQREM KRYEZIU: Faleminderit, zoti Tali! Fjalën do t’ia japim zotëri Lutfi Haziri, nëse është i përqendruar.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti zëvendëskryeministër, ministër Shala,

Unë do t'iu jap qasje mjeteve, angazhimit, debatit për privatizim. Unë prita sot që edhe grupi i deputetëve që e kanë iniciuar, edhe ne, që të flasim për procesin e privatizimit për kohën që po e kalojmë tash, për periudhën në të cilën jemi tash. Nuk mund të fokusohemi në historinë e procesit, në vendimet që janë sjell më herët në këtë proces. Natyrisht që nuk përjashtohet mundësia, por mesazhin që ne e lëshojmë sot këtu për të gjithë ata njerëz që janë konkurrues në të ardhmen e afërme dhe për publikun tonë më shumë është mesazh dekurajues, fatkeqësisht, sepse kërkesa për të pa kontratën për spinoff special apo për kushtet që i ka negociuar AKM më herët dhe AKP sot me ndërmarrjet fituese është legjitime dhe është kërkesë dhe është presion që unë mendoj duhet bërë në atë agjencion edhe sot dhe mundësitë tjera që jepen, sipas këtyre kushteve apo sipas mundësive ligjore që negociohet, por të flitet për procese para dy- tri vjetësh dhe për vendimet që janë sjell para tri-katër vjetësh ligji ua ka njohur të drejtën njerëzve të jenë konkurrues dhe në atë konkurrencë më i miri ka fituar, në ato rrethana. Dhe tash thuhet kështu, ka fituar në ato rrethana dikush për të cilin ne ia kemi mundësuar apo ata që kanë qenë në Bord të AKM-së, në atë kohë, autoriteti ligjor, ia ka mundësuar, është çështje krejt legjitime po është e panatyrshme që sot të diskutojmë për mënyrën se si kanë fituar dhe në çfarë rrethana i kanë fituar. Unë besoj ... se në të gjitha angazhimet që ky proces, përkundër sfidave që ka pasur, përkundër problemeve që i ka pasur të ketë ecur mbarë, të jetë storie e suksesshme, të jetë angazhim yni i përbashkët në mënyrë që prona shoqërore të kalojë në pronën private, sepse po angazhohemi për një treg të lirë. Kjo është e para.

E dyta. Si një prej ... që kanë qenë mjaft kritik, por të njëjtën kohë edhe bashkëpunues me agjencionin më herët për shkak të rolit të pushtetit lokal në atë kohë dhe angazhimeve krejt tjera edhe në komercializim edhe në privatizim më vonë, ka bërë që ne kemi të bëjmë me një proces e jo me njerëz, njerëz që ishin aty kanë punuar, kanë zbatuar detyrat, e kanë bërë pjesën e angazhimeve të veta, tash jemi në këtë fazë. Dhe unë shpresoj se në fund krejt duhet të dalim në mbështetje të procesit, absolutisht me kërkesë që të gjithë ata që sot bartin mbi vete obligime të kontraktuara me qeveri, që në këtë rast është agjencioni i pavarur, si autoritet që e kemi deleguar me ligj, duhet të jenë përgjegjës, duhet të japin llogari dhe duhet të jenë të kontrolluar natyrisht në mënyrë që të përfitojë krejt nga ky proces është legjitime, por pjesa e tjetër është histori e problemeve dhe e proceseve. Nëse hyjmë në histori të procesit, ju garantoj kemi për të mbetur dhe jam njëri nga ata që kanë qenë pjesë e këtij procesi, jam marrë drejtpërdrejt në dy nivele dhe për këtë proces mund të bisedojmë. Mund të bisedojmë deri në fund dhe nuk kam asnjë problem, por çështja që është ngritur këtu, shqetësimet që janë ngritur, unë i adresoj vetëm në atë pjesë që përfitues ligjor në Kosovë kanë obligime të kontraktuara, ato janë pjesë e interesimit, jo pjesë tjetër, pjesa tjetër jep muhabet dhe mesazh. Mesazhin që duhet ta dërgojmë nga këtu është ai që vërtet procesi nuk ka hezitim nga ne. Procesi është i mbështetur nga ne, por dëshirojmë që të jetë në binar, i kontrolluar, i monitoruar, sepse njerëzit kanë obligime, edhe ne si shtet kemi obligime ndaj tyre. Nuk ka obligime të njëanshme edhe Qeveria merr obligime ndaj investitorëve edhe sigurinë që duhet t'ua ofrojmë investitorëve e gjithçka tjetër që e njeh bota në të cilën ne po jetojmë. Faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari zoti zëvendëskryeministër,

Ministër i nderuar,

Shumë të respektuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Ndoshta kisha folur pak më ndryshe sikur ta kisha marrë fjalën pak më herët, pikërisht për faktin që duke përshëndetur, ndoshta, kushtimisht këtë nismë të deputetit në fjalë dhe shokëve të tij, kërkesën që e kanë bërë vetëm mos ta marrin atë si në këtë Kuvend, në këtë foltore dhe nëpër këto vende që jeni ju, nuk është folur deri më tani asnjëherë për privatizimin. Pra, dua të them është folur shumë herë, është kritikuar në shumë çështje të caktuara sa i përket procedurave të politikave të privatizimit, por asnjë nga diskutuesit ose deputetët, ish-deputetët dhe sot që janë këtu nuk kanë qenë dhe nuk janë kundër privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore.

AKM-ja ka qenë një agjencion që ka qenë nën vartësinë e OKB-së, që brenda saj ka pasur edhe vendorë, që në të shumtën e rasteve edhe janë dëgjuar edhe s'janë dëgjuar dhe si i tillë, si proces kështu që e kemi shkruar, bash nga ajo ana profesionale për mua s'thotë kurrigjë procesi i privatizimit në Kosovë a është fjala për ndërmarrje publike, a është fjala për ndërmarrjet shoqërore, a është fjala për ndonjë privatizim të një natyre tjetër dhe nuk është përcaktuar me kohë? A është fjala për privatizimin që ka ndodhur, sepse duhet të ndahen dy periudha, u tha nga shumë diskutues këtu. Në periudhën deri më 15 qershor të vitit 2008 dhe pas periudhës të vitit 2008 kur si agjencion kosovar i privatizimit që e ndryshon edhe emrin, bëhet institucion komplet vendor dhe merr kompetenca sipas ligjit të miratuar në këtë kohë.

Ju e dini, sa për përkujtim, nëse e keni pas besoj nëpër sirtarët tuaj, më 30 dhjetor të vitit të kaluar Agjencioni Kosovar i Privatizimit ka dorëzuar një raport të vetin rreth procesit dhe punës që ka kryer prej kohës kur e ka marrë mandatin deri më 31 dhjetor dhe duhet t'ju them këtu që ne si komision e kemi shqyrtuar, e kemi analizuar dhe ka qenë shumë i pranueshëm edhe nga pozita edhe nga opozita në komision dhe bile e kemi përgëzuar për punën që e ka arritur ta bëjë një punë, ndoshta po të krahasoj me periudhën sa ka vepruar, nga periudha e kaluar që del me një indeks shumë të lartë të sukseseve të këtij si agjencion dhe që tash do ta keni në Kuvend raportin për vitin komplet 2008 të Agjencionit Kosovar të Privatizimit dhe do të jetë edhe një rast shumë i mirë për të parë se ku është ky proces, çka duhet ndryshuar në këtë proces dhe kah duhet të shkojë ky proces tash e tutje.

Unë do të ndalem vetëm në privatizimin që ka ndodhur deri më 15 qershor. Në këtë foltore, në këtë vend, në një rast kur ka qenë pikë e debatit të privatizimit, kur kemi kërkuar që të vijë të raportojë zoti Ryecker që ishte atëherë përfaqësues ose kryesues i Bordit të Privatizimit, unë i kam pas thënë – me këtë politikë, me këtë formë, me këtë metodë që ti bashkë me ata që po të ndihmojnë ka pas ministra që tash i kemi deputetë dhe do s'i kemi fare deputetë, ju një ditë neve në Kosovë do të na bëni çipçi në tokën tonë dhe një ditë nuk do të kemi vend ku t'i fusim eshtrat tonë kur të vdesim dhe për habi, për çudi, pas dy javëve në një gazetë me shkronja të mëdha totë: Ryeckeri shet varrezat”.

KRYESUESI: Ju lutem Gani, flisni për raportin!

GANI KOCI: Kjo kishte ndodhur në Prizren kur janë shitur do toka dhe kishte pas qëlluar një ngastër ku janë varrezat në kadastër atje dhe nuk di a është zgjidhur ky kontekst a nuk është zgjidhur? Nga letra e atyre që kanë kërkuar këtë debat shihet se një raport për Ferronikelin ku është dhe si është gjendja, një raport për Llamkosin dhe për

tokat bujqësore, një informatë. Dhe ne e pamë informatën e shkurtër, të mirë, pa ose hiq, ne atë informatë e pamë. Por edhe te Ferronikeli unë do të shtroj një çështje pak tjetër. Në këtë Kuvend, në këtë sallë, në këtë vend, ne e kemi kundërshtuar me të madhe mënyrën se si është bërë privatizimi i Ferronikelit. Bile- bile unë jam edhe një nga ata që edhe në atë procesin e demonstrimit të ish-punëtorëve të Ferronikelit kam marrë pjesë dy herë në Drenas, para nënshkrimit të kontratës dhe ku kemi pasur një debat shumë të ashpër me zotin Ryecker dhe zotin Bujar Dugolli. Dhe kemi pasur edhe debate televizive, kemi kundërshtuar atë formë, por po ju them sinqerisht kontratat e nënshkrimit nuk kanë ndodhur në zyrat e Agjencionit Kosovar të Privatizimit, ka ndodhur diku tjetër dhe ku ka ndodhur kam thënë nëse e shfletoni procesverbalet, prandaj çdo adresim i përgjegjesisë që është sot ndaj kësaj Qeverie, për mua është një adresë shumë e gabueshme, shumë e pa qëlluar dhe ajo që duhet të kërkohet prej kësaj Qeverie sot në gjithë procesin e privatizimit, qoftë të ndërmarrjeve publike, qoftë të ndërmarrjet shoqërore, është që sa është në gjendje kjo Qeveri dhe cilat janë kapacitetet e saj të përmirësojë atë që është e mundshme të përmirësohet në procesin e privatizimit që ka ndodhur deri më 15 qershor të vitit 2008? Unë them se ka pak mundësi, ka pak kapacitete për arsye se ai proces është i mbyllur, dosjet nuk janë, dosjet mund të jenë diku ndoshta nëpër arkiva të OKB-ës ose diku tjetër por ne të bëhemi vigjilentë, t'i çelim sytë, t'i hapim sytë sot kah po shkon ky privatizim. Dhe unë them se është një proces i mbarë, është në rrugë të mirë, ne si deputetë dhe si Kuvend kemi marrë një qëndrim këtu, ose vendim mbi bazë të kërkesës të Qeverisë për privatizimin e disa pjesëve të korporatës energjetike të Kosovës dhe besoj Qeveria është në proces e sipër të përmbylljes së atij procesi të privatizimit ose të dhënës me koncesion dhe për fund, sa i përket ndërmarrjeve shoqërore ligji për partneritet privat publik dhe për koncesion e hap një rrugë shumë të mirë kësaj Qeverie që t'ia del mbanë që vërtetë t'i bëjë këto kompani profitabile dhe të jenë në shërbim të qytetarëve. Nëse dikush tjetër kërkon ndonjë përgjegjësi ndaj Kuvendit ose brenda në Kuvend besoj se nuk është, dyshimet të adresohen diku tjetër, nuk do të flas me emra por ka pas rast që për të bind njerëz kanë shkuar prej odës në odë, prej kafes në kafe, prej shtëpisë në shtëpi që të përkrahet në një rast të privatizimit të një, ta quaj, ndërmarrje shoqërore. Prandaj ju lutem, edhe pse jemi në fazën, po them kemi hyrë në fazën zgjedhore, ta lëmë politikën dhe propagandën anash dhe në qoftë se dom për të përmirësuar diçka të përmirësojmë, s'na pëlqejnë këto politika të privatizimit i ndryshojmë, marrim vendim, por me argumente, por jo të qiten në bankë të zezë ata që më së paku ndoshta janë përgjegjës për këto çështje. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Emrush Xhemajli e ka fjalën.

EMRUSH XHEMAJLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritet zoti zëvendësministër,

Përsëritet zoti ministër,

Kolegë deputetë,

Është kërkuar debat për privatizimin, është dhënë një informatë, unë për veti këtë informatë nuk do ta kisha pranuar, për mua së paku është e papranueshme plotësisht. Nuk mund në këtë formë të flitet për Agjencionin Kosovar të Mirëbesimit edhe prerjen në këtë formë me Agjencionin Kosovar të Privatizimit. Kështu ndodh kur një firmë falimenton dhe nuk e vazhdon veprimtarinë, i ndërrohet emri, bartet kështu poshtë-përpjetë. Ndërkaq, ne e dimë se nuk e ka filluar Agjencioni Kosovar i Privatizimit punën e vet prej ta zëmë valës së parë të privatizimit. Ju e dini që po vazhdojmë valën e privatizimit aty ku e ka lënë AKM-ja. Pra, kemi një vazhdimësi të plotë të njëjtës punë, punohet me të njëjtat rregulla dhe thuhet në fund se jo na s'kemi kurrëgjë të bëjmë me

AKM-n. Kjo është shumë e çuditshme. Vetëm një mund të pranohet, nëse dëshirohet t'i mbyllet kapaku, të thuhet ajo periudë ka pasur shumë çrregullime, nuk po mund t'i biem në fije më dhe me kaq po e mbyllim. Kjo nëse duhet mund të pranohet. Tjetër logjikë këtu, për mendimin tim, s'ka. E para ishte kjo.

E dyta, nuk është mirë që këtu me konstatime dhe konsiderata ideologjike që të mbyllet debati për privatizimin ose të nxirret dikush prej kontekstit të debatit. Edhe për një arsye tjetër, për shkak se bota nuk është e para 20 vjetëve, ka ndryshime shumë të mëdha në atë që është menduar para 20 vjetëve për këto probleme, bota nuk është bile edhe e vitit të kaluar. Ekonomia e tregut të lirë për të cilin po flasim ne këtu nuk është lumë pa brigje në botën e sotme. Gjithkund në botë sot janë duke u bërë rregullativa, jo të centralizuara. Unë nuk e di kush e përmendi këtu termin centralizim që të ketë kundërpërgjigje për këtë. E ai e ka përmendur, nuk ka pasur nevojë se këtu nuk e di dikush që e ka përmend, është një polemizim domethënë i panevojshëm rreth asaj.

Tash, te privatizimi i këtyre ndërmarrjeve shoqërore. Dakord, ka filluar privatizimi, janë duke u privatizuar krejt në rregull. Unë nuk e di si mund të thuhet sot privatizimi për ndërmarrjet publike do të ndodhë. S'ka kurrfarë rëndësie, sepse do të ndodhë nëse ia jep lejen që ky Kuvend. Ne nuk mund në formë të flasim për privatizimin e ndërmarrjeve publike, sepse çka është e arsyeshme ne do ta privatizojmë si shoqëri, kjo është e arsyeshme, domethënë kjo në rregull. Ajo çka është profitabile për ta privatizuar, ndërmarrjet që kanë bilanc pozitiv është alogjike, është e panevojshme, është shumë e dëmshme t' i privatizojmë, së paku privatizimi i deritashëm i këtyre ndërmarrjeve të llojit tjetër, të ndërmarrjeve shoqërore duhet të jetë një mësim i madh, megjithëse edhe kjo nuk është shkollë të themi hajt të mësohemi me buxhete të vendit, por , megjithatë, për kurrgjë tjetër duhet të shërbejë si mësim dhe t'i shohim qysh janë trendët e sotme. Sot, të nderuar kolegë, shtetet janë duke blerë asete prej privatëve. Ne e bëjmë të kundërtën, këto që na punojmë me fitim, këto lloj asete duam t' i qesim në treg për t'i shitur. Unë nuk e di me çfarë trendë ne dëshirojmë të ecim përpara, me ato që po ecën bota apo me këto trendët që kanë qenë me të vërtetë shumë në formë, mirëpo pak më herët, para 20 vjetësh. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Xhemajli! Fjalën e ka deputeti Gashi, Ibrahim Gashi.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje zëvendëskryeministër,

Përshëndetje ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë shumë shkurt do të përmend vetëm që iniciativa e nisur nga grupi i deputetëve për të debatuar lidhur me një temë tepër të rëndësishme është për t'u përshëndetur, pavarësisht se vjen shumë me vonesë dhe mundësitë për, si të them, për të korrigjuar diçka janë tepër të vogla, përndryshe jemi duke biseduar për diçka shumë post-festum dhe, ndoshta, vetëm ajo pjesa që mund të korrigjohet diçka, mund të evitohet diçka dhe që ndoshta edhe Qeverisë aktuale i ka rënë barra që kjo tash të tregojë veten se në këtë pjesë mund të korrigjojë diçka nga një proces që ashiqare po shihet se ka shumë defekte, është pjesa e sanksionimit të atyre privatizuesve të ndërmarrjeve që janë privatizuar me spinoff special ku kanë qenë të precizuara kushtet e kontratës dhe ku s'janë respektuar, sanksionimi tash i tyre për të riparuar diçka nga ajo që s'po funksionon, që po shihet shumë qartë dhe që është numër shumë i vogël i ndërmarrjeve të këtij niveli të privatizimit që po funksionojnë si duhet. Pra, numri më i madh të themi në përqindje mbi 80% s'funksionon

fare, që do të thotë se janë shkelur kushtet, domethënë skajshmërisht janë shkelur kushtet e kontratës të parapara me ligj dhe tash është pjesa e përgjegjësisë së kësaj Qeverie që t'i funksionalizojë gjykatat, prokuroritë, përkatësisht gjyqësinë që të merret me këto raste dhe të parandalojë diçka që mund të parandalohet nga pasojat që nuk i dihet ku do të jetë fundi i tyre. Unë mendoj që ky debat i sotëm do të kishte kuptim nëse do të fokusohemi në këtë pjesë dhe të shohim se a ka ndërhyrë diku gjyqësia e Kosovës për të korrigjuar diçka për të sanksionuar ata privatizues që kanë shkelur me të dy këmbët kontratën dhe sot e kanë abuzuar atë pasuri, ato asete të cilat nuk janë thjeshtë të një grupi të punëtorëve që kanë qenë aty, po janë asete nacionale, madje-madje disa prej tyre ne edhe si subjekt politik i kemi kualifikuar edhe si asete që nuk i takojnë vetëm kësaj gjenerate, duhet t'u takojnë edhe gjeneratave të reja, sepse nuk kemi të drejtë ne të privatizojmë diçka qysh janë pasuritë minerare, pasuritë nëntokësore të këtij vendi t'i atribuojmë, domethënë, si pasuri që janë vetëm tona, të këtij brezi.

Duke qenë kështu, po them është momenti i fundit që në këtë pikë mund të bëjmë diçka me debate të tilla, përkatësisht me vendime që mund të sjellë ky organ legjislativ, përkatësisht që mund të iniciojë për t'u sjellë nga ana e ekzekutivit.

Edhe diçka që nuk më pëlqen shumë të krijojmë shkëputje. Në njëfarë mënyre pajtohem me zotërinë parafolës, por edhe me gjithë ata... Nuk ka shkëputje ashtu me thikë në mes të AKM-ës dhe AKP-ës. Ai është një proces që vazhdon dhe në fakt AKP-ja do të duhej që t'i korrigjonte gabimet e AKM-ës të cilat po i dimë të gjithë. Apo ndodh prapë kjo lidhet do me thënë edhe me së paku me ndërmarrjet që privatizohen nga AKP-ja të zbatohen kushtet e kontratës. Ne tash jemi, domethënë ende frik nga kjo dhe ka kohë, por unë nuk dëshiroj që pas një vit e gjysmë tash një Qeveri, kjo ose ndonjë tjetër se këtu unë s'po dua të paragjykoj, domethënë, të merret tash me lëshimet e AKP-ës, prapë post-festum, kurrë s'mund të korrigjojmë kurrëgjë.

Në funksion të kësaj pra e mora fjalën vetëm që të bisedojmë për atë çka mund të parandalojmë, sepse ajo që ka shkuar, ka shkuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Myrvete Pantina!

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Kolegë, të nderuar deputetë,

Procesi i privatizimit nuk është proces i lehtë. Nuk është i lehtë as te ne, mirëpo nuk ka qenë i lehtë as në vendet tjera. Është evidente se procesi i privatizimit në Kosovë nuk i ka sjell rezultatet e pritura, por kjo nuk do të thotë që ne jemi kundër privatizimit. Përkundrazi, ne jemi për privatizim, por jemi edhe për zgjidhjen e problemeve me të cilat përballlet procesi i privatizimit.

Ekonomia e Kosovës vazhdon edhe pas këtyre valëve të privatizimit të jetë e paqëndrueshme dhe e brishtë, në mungesë të kapaciteteve për gjenerim të vendeve të reja të punës, ndërsa mjetet e grumbulluara nga procesi i privatizimit janë të bllokuara diku dhe plotësisht jashtë funksionimit dhe kontributit të tyre për ekonominë e Kosovës, derisa ne kërkojmë investitorë të jashtëm të vijnë e të kontribuojnë në zhvillimin e ekonomisë sonë. Kjo është plotësisht absurde. Mjetet tona i bllokojnë, kurse paratë e të huajve kërkojmë t'i sjellim në Kosovë.

Në disa prej ndërmarrjeve shoqërore që janë privatizuar me spinoff special, blerësit e tyre nuk kanë plotësuar kushtet e parashtruara në kontratë. Madje ka të atillë që ndërmarrjen e kanë dërguar në falimentim. Në mesin e këtyre ndërmarrjeve është edhe ndërmarrja Llamkos në Vushtrri, një ndërmarrje që ka qenë kontribuuesi më i madh në eksportin e Kosovës në periudhën e pasluftës.

Në raport thuhet se Bordi i drejtorëve të AKM-së e ka iniciuar procedurën e ushtrimit të tërheqjes së aksioneve për ndërmarrjen e re Llamkos. Ky vendim është përkrahur edhe nga Bordi i drejtorëve të AKP-ës. Tani thuhet në raport se AKP-ja është duke ndërmarrë të gjitha veprimet e domosdoshme për të ekzekutuar këtë vendim.

Mos të harrojmë se ky vendim është marrë më 21 maj të vitit 2008, ndërsa ne tani jemi në fund të majit të vitit 2009, kurse punëtorët e kësaj ndërmarrjeje dhe familjet e tyre janë në pritje se çka do të ndodhë me ta?

Zoti ministër,

Deri në zgjidhjen e kontestit gjyqësor me pronarin e kësaj ndërmarrjeje, a ka mundësi që kjo ndërmarrje t'i jepet në përdorim të përkohshëm ndonjë operatori të interesuar, meqenëse menaxhmenti i kësaj ndërmarrjeje thotë se ka operatorë të interesuar për këtë ndërmarrje. Apo, a do të shkojë kjo ndërmarrje në ritenderim dhe kur? Punëtorët e Llamkosit kërkojnë përgjigjen në këto pyetje. AKP-ja duhet të veprojë në drejtim të interesave të punëtorëve dhe të ekonomisë së Kosovës.

Në fund, dua të theksoj se më datën 21 maj të vitit 2009 në zyrën ku dorëzohen pyetjet parlamentare kam dorëzuar një pyetje që kishte të bënte me procesin e privatizimit. Mirëpo zyrtari nuk e pranoi pyetjen time duke thënë që do ta lexojë një shkresë që kishte marrë nga ministri i Financave, në të cilën thuhej se ministri nuk është kompetent t'i përgjigjet pyetjeve nga kjo fushë, meqenëse ekziston AKP-ja – një agjencion i pavarur i cili merret me çështjet e privatizimit.

Zoti ministër,

Problemet e privatizimit janë probleme tona. Ato nuk zgjidhen nëse ua mbyllim derën. Ne duhet të ballafaqohemi me to dhe nuk dua fare të komentoj se a është ajo kompetencë e juaja, por e Qeverisë, është. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sa për t'ju rikujtuar, ne kemi për ta miratuar një projektligj pas debatit dhe deputetët duhet të jenë të pranishëm. Tani i thërras deputetët që janë jashtë të vijnë në sallë për ta kryer detyrën e tyre dhe për ta përfunduar debatin. Në qoftë se mbetemi pa kuorum, duhet ta ndërpresim seancën. Sa deputetë janë? Atëherë, vazhdojmë dhe fjalën e ka deputetja Kaqusha Jashari.

KAQUSHA JASHARI: Faleminderit, zoti kryesues! Unë nuk di çka u bë me atë rend, një herë u ndërpre dhe u frikova se mos nuk po vi në rend fare për të diskutuar, por si do që të jetë, faleminderit.

KRYESUESI: Unë kërkoj falje, nuk është faji im.

KAQUSHA JASHARI: Unë, si deputete, jam e re, sa për moshë jam pak më e vjetër, prandaj e di edhe interesimin kush para kamerave kur është televizioni e kush ma vonë

dhe ju kisha lutur me pas kujdes tjera herë. Kjo është e vërtetë, nuk është hera e parë, por për mua nuk është, është për opinion dhe unë po dua ta shpreh mendimin tim.

Sa për privatizim, ne që po diskutojmë sot, unë mendoj se duhet ta ndajmë në dy pjesë, pjesa e privatizimit deri më tani është, jo problem, por është kryer dhe e kemi privatizimin në të ardhmen.

Sa për atë pjesë e cila ka kaluar për mua është e çuditshme, ndodhi ajo pjesë dhe unë mendoj se pasi s'ka qenë dorëzim-pranim AKM-ja dhe AKP-ja këtu ministri ka deklaruar se do të hulumtohet dhe unë shpresoj se nuk do ta lënë këtë problem në harresë.

Sa për pjesën, thashë, në të kaluarën AKM-n as s'e kemi zgjedhur organet tona as mënyrën e privatizimit as sistemin spinoff ose në tjetër mënyrë, ajo ka qenë me siguri nga eksperiencia e vendeve të tjera, por çka është ajo që kemi humbur ne është se të gjitha ndërmarrjet janë konsideruar si shtetërore a faktikisht kanë qenë shoqërore. Prandaj, këtu janë dëmtuar punëtorët, këtu janë dëmtuar të gjithë ata që e kanë krijuar atë pasuri, edhe pensionistët. Dhe me këtë e kisha kryer se nuk mund të kthehem mbrapa.

Po, çka më tutje? Kisha diskutuar ndryshe po të mos e kisha dëgjuar Kryeministrin dhe mua po më vjen shumë keq që nuk është prezent këtu se në mes ekonomisë së lirë të tregut dhe centralizmit nuk besoj se ekziston dikush në këtë shoqëri që është përcaktuar për një sistem centralist. Mirëpo, mendoj se duhet edhe në Qeveri pak të shikojnë ekonominë e lirë të tregut dhe si janë asetet e vendeve në Perëndim, me traditë shumë të gjatë të demokracisë. Pse nuk merret Gjermania si shembull, pse nuk merret Suedia si shembull dhe vendet e tjera, ku shteti nuk është pa asgjë, por i ka asetet e veta.

Prandaj, në fillim të formimit të shtetit të ri te ne në Kosovë, unë mendoj se me privatizimin e ndërmarrjeve publike duhet të kemi kujdes se jam befasuar, se unë nuk e kam ditur që minierat te ne bajagi janë privatizuar. Problemi i "Trepçës" është diçka tjetër, por edhe minierat. A po dom ne edhe tokën edhe krejt pasurinë ta shesim? Unë mendoj se përgjegjësia për të ardhmen nuk është e Qeverisë, por është përgjegjësia e Kuvendit si institucion më i lartë ligdhënës, prandaj nuk mund të kërkohej nga Qeveria përgjegjësi atëherë nëse ne nuk e kemi bërë ligjin për privatizim. Unë mendoj dhe propozoj që ky Kuvend duhet të deklarohej a të vazhdojë në këtë mënyrë privatizimi i ndërmarrjeve publike, ose të jetë më transparent, e unë s'po them që nuk mendohet mirë, që nuk është strategji të cilën Kuvendi nuk e kishte aprovuar, por privatizimi në këtë mënyrë dhe me shikimin si e dëgjova prej Kryeministrit sot – unë jam kështu, jo djathtistë, jo.... Ju lutem mendoj se përgjegjësia është e Kuvendit ta bëjë Ligjin për privatizim dhe asetet ta dinë cilat janë që duhet t'i këtë ky shtet i ri i Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI EQREM KRYEZIU: Faleminderit, zonja Jashari! Fjalën e ka zotëri Ismet Beqiri, le të bëhet gati zonja Sanije Aliaj.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zotëri kryesues!

Zotëri zëvendëskryeministër,

Zotëri ministër,

Kolegë të nderuar,

U tha shumëçka dhe, pa dëshiruar që mundësia është shumë e madhe që diku mund të përsëritet diçka, do të bëj përpjekje ta them edhe mendimin tim për një çështje të

rëndësisë së veçantë - për atë se çfarë ka ndodhur dhe çfarë do të duhej të ndodhte ose po ndodhë aktualisht dhe do të duhej të ndodhë në të ardhmen e që ka të bëjë me privatizimin ose me procesin e privatizimit në Kosovë?

Padyshim se këtu janë disa çështje që ndërlidhen, duke filluar nga çështja e vetë procesit të privatizimit dhe procedurat e tij, privatizimi dhe obligimit që dalin nga këto privatizime, pastaj privatizimi dhe zhvillimi ose më mirë të thuhet relacionet e privatizimit, por në këtë rast po fokusohem në privatizimi

dhe komunat. Pse po e them komunat, do t'ua sqaroj pak më vonë, sepse është shumë e qartë se ky proces drejtpërdrejt ndikon në zhvillimet e caktuara në komunë, që i dinë kolegët që kanë qenë kryetarë të komunave, por s'do të thotë që nuk i dinë edhe të tjerët.

Me një privatizim të tillë çfarë aktualisht është duke u bërë ose më mirë të thuhet çfarë është bërë deri më tani, ne rrezikojmë që të mbesim fare pa pasuri publike ose pronë publike dhe kur e them këtë – pronë publike, po e lidh me atë që e thash më herët, sepse realizimi i shumë projekteve që i bëjnë komunat tona, po i bën edhe shteti i Kosovës, padyshim lidhen me ekzistimin edhe posedimin e atyre pronave.

Po e them me përgjegjësi të plotë që shumë projekte kanë dështuar edhe më herët dhe mund të dështojnë edhe tani po qe se nuk ka hapësira të nevojshme publike për realizimin e atyre projekteve, duke filluar prej projekteve të natyrës që janë, për shembull, ato të ndërtimit të shkollave, pastaj të objekteve shëndetësore, që këtu e përmendi edhe zotëri Koci, e që është një fakt se ndoshta në disa komuna janë përballuar edhe me problemin e hapësirës – edhe të varrezave se ku do të duhej të varroseshin njerëzit, dhe që varrezat ose menaxhimi i tyre është përgjegjësi e komunës, prandaj, e thash këtë jo rastësisht.

Po ashtu, po përmend se domosdoshmërisht lidhet edhe kjo që ndodh aktualisht në të kaluarën, sepse nuk mund të pajtohem, të ketë një shkëputje të tillë dhe të themi – ajo çfarë ka ndodhë ka ndodhë dhe më nuk na intereson, jemi mirë.

Është shumë e qartë që edhe në bartjen e kompetencave ose me marrjen e obligimeve Agjencioni Kosovar i Privatizimit, përpos që merr domethënë kompetencat, i merr edhe përgjegjësitë dhe obligimet, karshi Agjencionit Kosovar që ka qenë, gjegjësisht agjencionit për vlerësim që ka qenë më herët dhe nga ato obligime nuk mund t'u ikën që t'i kryej edhe tash Agjencioni Kosovar i Privatizimit.

Po i përmend edhe dy-tri raste në Prishtinë. Privatizimi, po e marrim, i “Energoinvestit”, Fabrikës së Tekstilit “Kosovarja”, pastaj i “Ramiz Sadikut” ka shkaktar probleme të natyrës ekzistenciale dhe zvogëlimit, siç e thashë, të pronës publike komunale. Pse po ua përmendi këtë? Nëse një ndërmarrje, çfarë ka qenë po e zëmë Fabrika e Tekstilit, privatizohet edhe me 20 hektarë që realisht nuk kanë qenë hektarë të saj, por ka qenë tokë e komunës dhe në shfrytëzim të ndërmarrjes, këtu kanë dalë problemet që më vonë, me rastin e privatizimit edhe hapësirat përreth kanë filluar ta ndërrohet edhe destinimin dhe çka është më kryesorja realisht s'kanë pasur të drejtë as për ta privatizuar atë tokë. Kanë mund ta privatizojnë vetëm hapësirën rreth Fabrikës aq sa është e nevojshme për funksionalizim të asaj ndërmarrje që është privatizuar.

Po ashtu, më lejoni të përmend faktin se në adresë të Komisionit ku ne me kolegët kryejmë obligimet tona si deputetë, vjen një numër i ankesave të punëtorëve që lidhen pikërisht me procesin e privatizimit.

U tha edhe më herët, por mund ta them edhe tash dhe ta përsëris edhe një herë – kemi vazhdimisht kërkesa dhe peticione të natyrës se pse nuk realizohen edhe ato pak obligime që për këta punëtorë janë shumë – të 20%-shit?

Kolegë të nderuar, për qytetarët, për ish-punëtorët që kanë mbetur rrugëve është shumë domethënëse ai 20%. Domethënë ekzistencë për ta, dhe nuk do të duhej në asnjë mënyrë për t'u injoruar. Ndoshta, për ata që janë përgjegjës t'ua kthejnë këto para, iu duket pak, nuk është shumë e rëndësishme, por për këta njerëz është shumë e rëndësishme që të kryhen këto obligime.

Është e vërtetë se flitet edhe për manipulim listash me rastin e hyrjes në listat e 20%-shit. Janë futur punëtorë që fare s'kanë punuar nëpër ato ndërmarrje. Këtë, të mos gaboj e ka përmendur zotëri Geci.

Po e përmendim edhe një çështje, problemin e Pallatit të Rinisë. Unë po e them, edhe si deputet, edhe si çështje që është ngritur edhe më herët. Për mua është e paarsyeshme një ndërmarrje, një projekt, gjegjësisht diçka që është investuar nga qytetarët e Prishtinës, sot e kësaj dite nuk dihet titullari edhe pse është ndërtuar me djersë të qytetarëve të Prishtinës dhe i është lënë zhvillimit stihik, mos të them edhe të degradimit të tij dhe thjeshtë nuk po mund ta shfrytëzojnë qytetarët për çka edhe është destinuar.

Sot atje paguhen shuma të caktuara parash edhe për aktivitete sportive, që në rrethana normale edhe kulturore do të duhej dikush tjetër t'i kryejë këto obligime, pse jo edhe komuna, prandaj është shumë e paarsyeshme pse kjo sot nuk i kthehet komunës.

Ju e dini, ata që kanë qenë në këtë proces, ju kujtohet dhe fatbardhësisht Pallati i Rinisë është hequr nga lista e privatizimit ka 3 vjet dhe është për ta përshëndetur këtë veprim, por që do të duhej të finalizohet me aktin që do të duhej ta bënte Qeveria apo dikush tjetër kompetent që kjo t'i kthehet komunës.

T'ju them edhe atë se është më se e vërtetë që shteti do të duhej të ruajë, mos të them një sasi, por, pa dyshim, një pjesë të pronës së saj, në mënyrë që të mos bëhen pengesa në zhvillimet strategjike urbane, të Kosovës në këtë rast, por edhe të komunave tona. Unë po e përmend Anglinë, për shembull si rast. Nga ajo që kam pasur rast për të parë, në iks komunat e caktuara, atje deri 70% e pronës është pronë e komunës dhe ajo i mundëson dhe i ndihmon shumë në realizimin e projekteve dhe nuk di pse ne, nganjëherë edhe bëhemi më të mençur se sa dikush që ka traditë demokratike qindravjeçare.

Dhe, fare në fund, unë ju lus, sikur edhe shumë të tjerë deputetë, që Agjencioni t'i kryejë obligimet, po e përsëris, të 20%-shit karshi punëtorëve. Për ta është shumë me rëndësi dhe sado që shuma duket ndoshta se është e vogël, por për ta është shumë e madhe, sepse e kanë të vetmin burim ekzistence. Dhe po ashtu, nuk janë ndoshta në moshën që të mund të punojnë diç tjetër këta njerëz. Fundi i fundit, është djersë e tyre dhe do të duhej kjo t'u kompensohet. Po ashtu, të shikohet mundësia që ne si shtet, kur ka mundësi të ruhet një pjesë e aseteve – një interes i caktuar shtetëror, duke mos penguar në asnjë mënyrë procesin e privatizimit, thjesht mos e leni, po e përsëris edhe një herë, nuk po flas në stilin e të qenit ose avokat i komunave, mos i lëni komunat pa pronë publike sepse i pengoni në zhvillim, i pengoni në realizim të projekteve kapitale, i pengoni ose më mirë të themi i shumëfishoni shpenzimet për realizimin e projekteve të caktuara. Dhe, po që se një shkollë do të kushtonte në kushte normale, ku do të ishte prona komunale, po

paragjykoj, një milion euro, nëse duhet ekspropriuar ose kompensuar nga komuna, ju mund ta merrni me mend se sa do të mund të kushtonte një projekt i tillë. Prandaj, është shumë e nevojshme, është shumë e arsyeshme që të kihet kujdes i jashtëzakonshëm dhe shumë i madh në këto relacione, sepse fundi i fundit ndikojnë në zhvillimin dhe prosperimin e të gjitha atyre ndërmarrjeve, aq më tepër, nuk do të duhej, po ashtu, lejuar edhe një mundësi që tokat bujqësore që po privatizohen të shndërrohen në toka ndërtimore pa asnjë kriter dhe pa kurrfarë planesh urbanistike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Beqiri. Fjalën e ka zonja Sanije Aliaj, le të përgatitet zonja Gjylnaze Syla.

SANIJE ALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër, ministër,

Kolegë të nderuar,

Përsëritës iniciativën e Grupit të deputetëve që sot të flasim për procesin e privatizimit në Kosovë.

Në start deklarohej se jam për privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore, por sot po debatojmë post-privatizim, pa një informacion të institucioneve, në bazë të cilit do të konkludonim dhe do të jepnin sugjerimet deputetët për një rrugëtim të mbarë të vazhdimin të mëtutjeshëm të procesit të privatizimit.

Tani privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë është në fazën përfundimtare. Megjithatë, edhe përkundër domosdoshmërisë për t'u privatizuar ndërmarrjet shoqërore, që synojmë ekonominë e tregut të lirë, ky proces në vazhdimësi është përcjell me shqetësim dhe shumë dilema nga qytetarët e Kosovës e në veçanti nga punëtorët e këtyre ndërmarrjeve.

Këtë e potencoj se në mënyrë të vazhdueshme Komisionit për të Drejtat e Njeriut i adresohen peticione ku shkelet e drejta e punës së punëtorit dhe keqpërdorimi i pasurisë kombëtare. I cilësuar si një nga proceset më të suksesshme të ndodhura pas luftës nga administrata ndërkombëtare, për fat të keq nuk është kështu se procesi i privatizimit tashmë ka filluar t'i shpalosë edhe anët negative. Ndërmarrjet shoqërore me të gjitha asetet e tyre janë shitur me çmim më përbuzës dhe më zhvlerësues për pasurinë shoqërore dhe kombëtare, pa u marrë aspak me fatin e mijëra punëtorëve për shkeljen e të drejtës së punës.

Përmes disa raporteve dhe mjeteve të informimit, disa zyrtarë të Riinvestit deklarohen se procesi i privatizimit në Kosovë ka pasur të meta serioze që nga fillimi, por për hir të situatës politike, në mungesë të një statusi politik të pa definuar në atë kohë, është dashur që edhe nëpërmjet këtij procesi Kosova të ndahet definitivisht nga Serbia.

Sipas një publikimi, privatizimi dhe post-privatizimi – forum 2015, numri total i kompanive të privatizuara që nga fillimi është 495 ndërmarrje shoqërore, 10% të tyre ende presin kompletimin e privatizimit. Mjetet e akumuluar nga shitja e aseteve të ndërmarrjeve shoqërore arrijnë mbi 383 milionë euro. Megjithatë, këto mjete ende mbahen të ngjira dhe janë jashtë aktivitetit të zhvillimit të vendit.

Obligimet për investime me spinoff special arrijnë në 191.3 milion dhe obligimet për të punësuar mbi 8 mijë punëtorë.

Me këtë rast, më intereson sa ka ndikuar privatizimi në zhvillimin ekonomik të Kosovës, sa është rritur numri i të punësuarve, sa është eksporti i prodhimeve vendore, sa është konkurrenca nga importi dhe sa luftohet gjatë procesit korrupsioni. Më habit fakti se edhe përkundër faktit se ndërmarrjet shoqërore të privatizuara me spinoff special por edhe me spinoff të rregullt deri më tani as Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit, as Agjencioni Kosovar i Privatizimit, as Qeveria nuk kanë dalur me një studim që do ta pasqyronte në mënyrë gjithëpërfshirëse performancën e ndërmarrjeve të privatizuara, efektet e tyre në ekonomi, aspektet sociale si dhe ndikimi i këtyre ndërmarrjeve në mesin biznesor.

Këtë e potencoj se vetëm pas atij studimi do të dinim me ndërmarrë iniciativa dhe hapa konkretë për të ndreq atë që ka mbet për t'u ndreq.

Bazuar në petitionet e punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore, adresuar Komisionit për të drejtat e njeriut, obligimet e kontraktuara me shitjen e ndërmarrjeve shoqërore me spinoff special, asnjë nga këto obligime të kontraktuara nuk janë plotësuar në tërësi.

Me këtë rast, do ta potencoj një rast. Industria e duhanit në Gjilan, e privatizuar me spinoff special nga një kompani nga Afrika Jugore, e cila është zotuar se do të investojë mbi 5 milion, kjo ndërmarrje ka lënë shumë punëtorë jashtë, shumë familjeve nuk u është paguar honorari i furnizimit me duhan të papërpunuar, kështu që punëtorët, të shqetësuar, kërkojnë nga AKP-ja dhe Qeveria për të ndërhyrë në këtë proces me projekte konkrete.

Gati në një situatë të njëjtë është Fabrika e Tubave në Ferizaj, Industria e Gomës në Suharekë dhe shumë kompani shoqërore tjera.

Duke u nisur nga aspekti ekonomik-social, gjërat nuk kanë shkuar si duhet, nga se mjetet e privatizimit ende janë të ngrira dhe jashtë funksionimit të zhvillimit ekonomik.

Duke u nisur nga fakti se blerësit nuk kanë realizuar kushtet e parashtruara me kontratë e në mënyrë të veçantë moskryerja e obligimit për 20%-qindëshin për punëtorët, propozoj që AKP-ëja pas një auditimi thelbësor të ndërmarrjeve të privatizuara së bashku me Qeverinë të hartojnë një strategji për ritenderimin e ndërmarrjeve të privatizuara të cilat kanë dështuar në mosrealizimin e obligimeve të kontraktuara.

Dhe, krejt në fund, do të apeloja te Agjencioni Kosovar i Privatizimit dhe te Qeveria e Republikës së Kosovës resurset kombëtare të ruhen me fanatizëm sepse edhe ne dimë të menaxhojmë atë që është në interes të madh të zhvillimit ekonomik. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Zef Morina. Nuk është. Deputetja Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, kryesues!

I nderuari zoti zëvendëskryeministër,

I nderuari ministër,

Të nderuar deputetë,

Sikurse e gjithë seanca e sotme, edhe kjo pikë e rendit të ditës kaq e rëndësishme, siç është privatizimi, nuk është përgatitur si duhet. Kërkesa e deputetëve për të pasur debat dhe për të ftuar bartësit e procesit të privatizimit – përgjegjësit – ministrin e Ekonomisë, Ahmet Shala, dhe drejtorin, Dino Hasanaj, nuk është plotësuar.

Kryesia, në vend që të kërkojë raport nga AKP-ja, ka kërkuar informatë. Atëherë, si po debatojmë ne? Po i flasim njëri-tjetrit! Natyrisht se nuk do të ketë debat të frytshëm dhe as rezultat të frytshëm të këtij debati. Është dashur të kërkohej raport nga AKP-ja sepse, e tha deputeti Gani Koci, që raporti është i gatshëm për vitin 2008 dhe sot të debatohet në bazë të atij raporti.

Çështja është e rëndësishme dhe serioze dhe prek jetën e secilit qytetar dhe çdo familje në Kosovë. Por, do t'ia filloj së pari me disa gjysmë të vërteta ose të pavërteta, që i tha Kryeministri. Arsyeja është se Kryeministri është kreu i Qeverisë dhe në një mënyrë është përgjegjës për të siguruar që procesi i privatizimit do të ecë drejt.

E para, është se ai fajësoi tërë kohën Qeverinë e kaluar dhe bartësit e privatizimit. E vërteta është se privatizimi ka filluar në vitin 2004, në kohën kur Bajram Rexhepi ka qenë kryeministër. Tjetra është se ai në mënyrë gjysmake i përmendi se kush kanë qenë në bord, duke harruar edhe ministrin e tanishëm Ahmet Shala, i cili ka pasur një rol shumë të rëndësishëm në procesin e privatizimit.

Pa dashur më tej të merrem ose të replikoj, qëllimi i debatit tim është më shumë të shoh se si do të zhvillohet procesi i privatizimit dhe sa do të përfitojnë qytetarët e Kosovës nga ky proces.

Megjithatë, po ta kishim një raport, do ta kishim të qartë se cilat janë objektivat e privatizimit, cili është sukcesi, cilat rezultate, si do të zhvillohet procesi, në çfarë modeli do të bazohet.

Në raport thuhet se procesi i likuidimit do të mbarojë diku deri në mesin e qershorit. Mbasi ministri Shala nuk na tregoi se a do të mbarojë me të vërtetë, meqenëse nuk e kemi një informatë të saktë dhe, nëse po, si do të mbarojë dhe a është i gatshëm, meqenëse nuk mund të vazhdojë procesi i privatizimit pa u bërë një herë likuidimi i ndërmarrjeve. Pritjet e mia kanë qenë se do të kemi një informatë shumë të saktë për të gjitha ndërmarrjet të cilat janë privatizuar, qoftë ato shoqërore, publike dhe tokat bujqësore, sepse nuk mund të bëhen as politika të mirëfillta të privatizimit në qoftë se nuk ka vazhdimësi, në qoftë se nuk e dimë se si është zhvilluar procesi i privatizimit deri më sot.

E dyta, vazhdimisht është marrë nga buxheti i Kosovës shumë mjaft e madhe për AKM-në. Asnjëherë nuk kemi pasur asnjë raport se si janë shpenzuar ato dhe në çfarë mënyre. Prandaj, nuk e di se a ka ndonjë proces të auditimit.

Tjetra, sa i përket materialit. Besoj se të gjithë e dini që UNMIK-u i ka këto materiale dhe se AKP-ja duhet t'ia kërkojë UNMIK-ut të gjitha materialet sa i përket AKM-së, në mënyrë që të sigurojë vazhdimësinë e procesit.

Nëse është siç thuhet në raport, se është përshpejtuar dinamika e listave për punëtorët, po ashtu edhe shqyrtimet e ankesave të tyre, duke përmendur këtu ato listat e përkohshme dhe përfundimtare, unë kisha dashur ta di më saktë kohën kur do ta marrin punëtorët këtë 20%-shin. Është shumë e çuditshme mospagesa e 20%-shit punëtorëve dhe marrja e asaj pjese e cila i takon secilit punëtor.

Prandaj, apeloj dhe po të ishte këtu drejtori, do t'ia kisha drejtuar drejtorit të Agjencionit që ky proces të kryhet sa më shpejt dhe punëtorët ta marrin 20%-shin që iu takon. Është e drejtë e tyre.

Ndërsa, sa i përket shumës e cila është investuar jashtë vendit, informata do të ishte se si do të kthehen ato në vend, ku do të investohen, çfarë ndikimi do të kishin në zhvillimin ekonomik dhe sa vende të reja të punës do të hapeshin. Këto do të ishin çështje me rëndësi që do të diskutoheshin.

Më vjen mirë që është zëvendëskryeministri këtu dhe mbase edhe mund të përgjigjet se në qoftë se Qeveria mendon të privatizojë PTK-në, unë duhet t'ia kujtoj Qeverisë dy gjëra shumë të rëndësishme. E para, asetet nacionale Qeveria nuk ka të drejtë t'i trajtojë si të vetat dhe duhet për këtë ta pyes Kuvendin. Në fund të fundit, janë asete të qytetarëve të Kosovës.

Dhe, e dyta, si mund të ketë Qeveria një mendim të tillë që të privatizojë PTK-në – një ndërmarrje e cila është profitabile.

Dhe, pastaj kisha dashur ta kem një pasqyrë të qartë të privatizimit të mëtejme, gjithashtu edhe të KEK-ut ose edhe të koncesionit të Aeroportit. Të gjitha këto çështje janë të rëndësishme për të cilat duhet ftuar edhe drejtori e gjithashtu edhe ministri i Financave që ta informojnë Kuvendin, jo si informatë e thjeshtë. Deputetët nuk është dashur të pranojnë informatë, por raport të mirëfilltë për privatizimin dhe, gjithashtu, në Kuvend të vijnë të raportojnë ministri dhe drejtori i Agjencinit për të treguar se me të vërtetë seriozisht e shqyrtojnë këtë çështje dhe që procesi i privatizimit do të shkojë në drejtim të përfitimit për qytetarët e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Buçinca!

GANI BUÇINCA: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë e dëgjova debatin me vëmendje dhe para se gjithash kisha falënderuar të gjithë ata të cilët me nënshkrimet e veta e kanë nxit dhe padyshim debati megjithatë ka qenë i frytshëm në shumë drejtime dhe besoj që nuk e ka dëmtuar as procesin e privatizimit dhe as prestigjin politik të pozitës, por edhe nuk ka përfituar shumë opozita për qëndrimin e vet propagandistik, politik duke e shfrytëzuar procesin e privatizimit si shans të mirë për fushatë parazgjedhore.

Desha t'ju them se nuk dëshiroj t'i përsëris shumë diskutime që u thanë, mirëpo ma merr mendja se i kanë artikulluar shumë mirë ato pikëpamjet e mia deputeti i nderuar Lutfi Haziri, pra diskutimi i tij që ka qenë shumë parimor dhe i përgjegjshëm politikisht i kolegut tim të nderuar Gani Koci dhe gjithashtu i deputetit Ismet Beqiri. Kanë qenë diskutime racionale dhe kanë qenë në funksion të gjetjes së zgjidhjeve pozitive dhe sidomos të gjetjes së atyre zgjidhjeve që janë të arsyeshme në kontekstin politik, në të cilin po kalojmë.

Desha t'ju shpreh një mendim se pranohet një fakt se konteksti politik kur ka ndodhë privatizimi në Kosovë nuk ka qenë i ngjashëm me asnjë kontekst politik të shteteve të Lindjes, të ish-bllokut socialist dhe nuk ka qenë i ngjashëm me asnjë kontekst politik të shteteve të ish-Jugosllavisë. Edhe procesi që po vazhdon tani nuk është i ngjashëm akoma

në tërësi me proceset e privatizimit që kanë ndodhur në Evropën Lindore – në shtetet e bllokut socialist. Këtë do të duhej ta kishin parasysh të gjithë ata të cilët diskutuan.

Rezoluta 1244 i ka shpronësuar të gjithë qytetarët e Kosovës në mënyrë arbitrare dhe për kontekstin për të cilin po flasim ka qenë në kundërshtim jo vetëm të qytetarëve të Kosovës, por edhe në kundërshtim me konventat ndërkombëtare të kësaj sfere.

Administrata e UNMIK-ut nuk ka pasur të drejtë të transformojë pronën në Kosovë, të ndërrojë titullarët e pronës në Kosovë me asnjë konventë ndërkombëtare si dhe as me asnjë konventë mbi të drejtat dhe liritë e individit. Ai ka pasur të drejtë vetëm ta administrojë pronën në Kosovë, t'i rivitalizojë ndërmarrjet dhe nuk ka pasur të drejtë, sipas të drejtës ndërkombëtare, që të bëjë ndryshimin, domethënë ta transformojë pronarin, ta bëjë privatizimin e tyre. Privatizimi, sipas konventave ndërkombëtare mund të bëhet vetëm nëpërmes një procesi transparent ligjor dhe nëpërmes përfaqësuesve të zgjedhur të popullit. Dhe, kjo nuk ka ndodhur në Kosovë. AKM-ja ishte më shumë një institucion i krijuar për të mbuluar dështimet e mëdha të administratës ndërkombëtare në Kosovë dhe obligimet që i kishte marrë me Rezolutën 1244 për zhvillimin ekonomik të vendit. Nëse administrata nuk kishte para as vullnet politik për të rivitalizuar ndërmarrjet shoqërore në Kosovë, ajo i theu në aksionin e privatizimit të tyre dhe padysim ky privatizim edhe nga aspekti politik, social dhe ekonomik ka qenë i dëmshëm për Kosovën. Këtë duhet ta konstatojmë të gjithë.

Pastaj, vetë koha kur ka ndodhë privatizimi nuk ka qenë Kosova e përgatitur në aspektin institucional dhe ligjor dhe as në aspektin politik, që të fillojë procesin e privatizimit. Në Kosovë, kur ka ndodhur privatizimi, nuk ka ekzistuar tregu financiar. Pra, nuk kanë ekzistuar letrat me vlerë dhe në këtë drejtim janë shpronësuar të gjithë qytetarët e Kosovës në mënyrë arbitrare.

T'ju them të drejtën, procesi i privatizimit ka qenë i dhimbshëm dhe është përcjellë me korrupsion, me padrejtësi të mëdha dhe vetëm dy- tri shtete kanë pasur sukses në këtë drejtim. Administrata e UNMIK-ut nuk e ka marrë përvojën e shteteve të suksesshme në procesin e transformimit të pronës si Sllovenia e Çekia, mirëpo ka shkuar me një proces dhe me një bazë legjislative që ka qenë jo transparente.

Unë mund t'ju them se i përkrah diskutimet që kanë për qëllim që procesin aktual të privatizimit ta vënë në kontroll parlamentar dhe që ky proces të jetë transparent konform ligjeve në fuqi. Unë shpreh besimin tim të plotë se Qeveria aktuale do t'i bëjë të gjitha përpjekjet që ky proces të jetë sa më transparent dhe shumë i dobishëm për qytetarët e Kosovës. Këtu, disa deputetë përmendën faktorët ideologjikë. Unë mund t'ju them se çdo proces i privatizimit e ka edhe komponentin ideologjik brenda, ashtu siç e ka edhe komponentin politik, ekonomik dhe social. Kurse për fjalën “shok” që u përdor këtu dhe disa kolegë aluduan në kontestin negativ, unë mund t'ju them se fjala “shok” te shqiptarët ka ekzistuar para se të ekzistojë komunizmi si ideologji dhe mund të përdoret edhe në rrethanat tona shumë mirë dhe është shumë e ngrohët, si për nga intonacioni, ashtu edhe përmbajtja e saj.

Unë desha t'ju them vetëm që e kisha lutur Qeverinë dhe të gjithë ata që janë përgjegjës, që vërtet në këtë fazë kur kriza ekonomike globale ka ndikuar dukshëm edhe në gjendjen sociale në Kosovë, të angazhohet sinqerisht që 20%-shi që u takon punëtorëve t'u kthehen sa më parë.

Përveç këtij problemi që duhet ta zgjidhë Qeveria me prioritet, do të ishte mirë që edhe disa konteste individuale që i kanë qytetarët e Kosovës me firmat e privatizuara të marrin një zgjidhje juridike, pra, lë të marrin një përgjigje. Unë i mora si shembull disa qytetarë dhe disa firma që janë privatizuar dhe funksionojnë, pra ata kanë probleme me këto firma. Këto firma kanë obligime financiare ndaj qytetarëve, krejt në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe deri me sot që 4 vjet nuk marrin asnjë përgjigje as pozitive as negative dhe nuk i informojnë qytetarët. Ata nuk kanë ku të ankohen për të drejtat e tyre.

Unë shpresoj se Qeveria aktuale është mjaft e përgjegjshme dhe është duke u angazhuar mjaft që i gjithë procesi i cili ka shkuar jashtë vullnetit tonë, jashtë vullnetit të partive opozitare që janë këtu, por ka qenë i imponuar dhe në njëfarë mënyre ne i kemi pranuar të marrë një tjetër drejtim dhe ky drejtim padyshim do të jetë shumë më i mirë dhe më i leverdishëm për qytetarët e Kosovës. Se Qeveria ka probleme në këtë sferë dhe, ndoshta, ka neglizhencë të justifikueshme për shkak të problemeve të grumbulluara, kjo është e evidente. Mirëpo, kjo Qeveri e cila e ka marrë Kosovën në një kontest politik, ekonomik dhe social shumë të vështirë, ndoshta, më të vështirin në historinë e popullit tonë e ka shumë të vështirë për një kohë kaq të shkurtër të bëjë ndryshime radikale pozitive. Mua ma merr mendja se edhe deputetët e përgjegjshëm këtu duhet të kenë mirëkuptim ashtu qysh jam i bindur se qytetarët e Kosovës e mirëkuptojnë Qeverinë aktuale në përpjekjet që po i bën dhe me vështirësitë që i ka për shkak të kontestit politik në të cilën gjendemi si komb dhe edhe si institucione shtetërore. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Fjalën e ka ministri i Ekonomisë dhe i Financave, zoti Ahmet Shala.

MINISTRI AHMET SHALA: Ju faleminderit!

I nderuar kryesues,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë,

Sot jam paraqitur këtu në cilësinë e ministrit të Ekonomisë dhe të Financave, jo për t'u përgjigjur për të bërat në Agjencionin Kosovar të Mirëbesimit, sepse e konsideroj që unë tani jam ministër i Ekonomisë dhe i Financave dhe përgjigjem për punën e ministrit të Ekonomisë dhe Financave. Në Shqipëri një proverb që më ka pëlqyer shumë- thotë: "Krimi të e kaluara nuk fiket, e keqja nuk thihet". Pra, "nëse është hëngër pitja, tepsia ka mbetur". Pra, secili në çdo moment, në çdo kohë, në çdo situatë përgjigjet për punën e vet që e ka pasur edhe që e ka bërë.

Unë, dua të sqaroj para jush se shoh që dikush me djallëzi, ose i pa informuar ose me qëllime të caktuara, qofshin elektorale, qofshin çfarëdo karakteri, përzien pozicionin tim në Agjencionin Kosovar të Mirëbesimit. Do ta lus kamerën, në qoftë se më dëgjon regjia, që këtu e kam vizatuar një skemë të vogël, do t'i kisha lutur që ta paraqesin që këtu është Bordi i Drejtorëve, në të cilin kanë qenë 8 anëtarë të Bordit, gjithnjë 3 ministra të Republikës në atë kohë të Kosovës dhe një përfaqësues i Sindikatës dhe 4 ndërkombëtarë.

Pozicioni im është zëvendësdyrektori për ndërmarrjet shoqërore dhe ka qenë i zëvendësdyrektorit për ndërmarrjet publike dhe i monitoruesit- kontrolluesit për zbatimin

e këtyre obligimeve që është dashur t'i ketë. Nuk mbaj asnjë përgjegjësi për këtë pozicion, sepse vendimet janë marrë këtu në Bord. Problemi, konsideroj me të gjithë ne shqiptarët, nganjëherë është harresa. Në Kornizën Kushtetuese, e cila fatmirësisht nuk është përkrahur nga gjithë spektri politik i Kosovës atëherë, po është përkrahur nga një spektër i gjerë politik në Kosovë, udhëheqës dhe liderë të Kosovës, në nenin 5 dhe 8 shkruan shumë qartë që privatizimi është pjesë e rezervuar që e udhëheqin ndërkombëtarët, i cili përbëhet nga 4 udhëheqës ndërkombëtarë, drejtori ekzekutiv dhe 4 vendorë.

Deri në atë kohë, në këtë podium, në këtë audiencë kanë qenë deputetë, kanë qenë kryeministra, kanë qenë ministra që kanë deleguar ministra në atë Bord për të marrë vendime për të cilat unë është dashur t'i zbatoj për metodologjinë se si të privatizohet. Pra, ajo Qeveri që ka udhëhequr në atë kohë, që nga 2002-ta, është marrë me metodologjinë se si do të privatizohet. Andaj, për t'u diskutuar për modalitetet, mund të organizohen çfarë të duash debatesh akademike se a ka qenë i mirë a nuk ka qenë i mirë. Unë, në cilësinë e zëvendës drejtorit, jo që kam pasur rol ekzekutiv, konsideroj dhe me besim të plotë them që procesi i privatizimit në rrethanat politike- juridike dhe të tjera, aq sa unë kam pasur mundësi ta përcjellë pjesën time, ka qenë më transparenti dhe më i thjeshti dhe më i pa korruptuari, në të gjitha përvojat e ekonomive postkomuniste. Merrni raportet e institucioneve të rëndësishme ndërkombëtare çka kanë shkruar për këtë proces. Në qoftë se dikush ka ndonjë element konkret, ju kisha lutur e sillni, është gjyqësia, por të mos luaj ky Parlament rolin që nuk i takon.

Pra, kur të doni mund të diskutojmë a kanë qenë modalitetet e mira apo të këqija. Konsideroj dhe nuk dua të përmend as kush e ka pasur përgjegjësinë, e dini këtë. Ky Parlament, ata kryeministra, ata kryetarë të shtetit të Kosovës e dinë kënd e kanë dërguar për ta përfaqësuar interesin e Kosovës atje. Unë kam qenë një punëtor i Unionit Evropian, por edhe si kosovar që është përpjekur me dijen, me potencialin e vet për të shkëputur dhënien e atyre që kanë pretenduar se ato prona nuk janë të Kosovës, nuk janë të popullit të Kosovës. Pra, konsideroj që pa marrë parasysh kundërshtimet që i kanë pasur institucionet ndërkombëtare dhe fqinjët tanë që nuk ia donë të mirën Kosovës, ne kemi arritur që brenda një periudhe të konsiderueshme t'ua shkëpusim atyre pretenduesve diku 400 mijë ndërmarrje.

Unë dua të shpjegoj atë që konsideroj që është valide dhe që është e rëndësishme për popullin, sepse shpeshherë këtu në këtë Parlament me qëllime shumë djallëzore dikush ngre gisht nga Ahmet Shala. Jam ministër i Republikës së Kosovës dhe me dinjitet të plotë kam punuar dhe do të punoj për të mirën e popullit tim. Kushdo që ka një element për Ahmet Shalën, urdhëroni është gjyqësia, prokuroria, dërgojeni, sillni argumente. Mos flisni gjëra që nuk janë njerëzore, pra lë të shkojë në ndjenjën dhe fytyrën e secilit.

Çka duhet të them këtu. Jam tani ministër i Ekonomisë dhe Financave dhe me shumë respekt dhe me nderë do të punoj për të shtyrë procesin e zhvillimit të ndërmarrjeve strategjike. Është një proces i rëndë, do të kemi debate të shumta, është një sfidë e madhe për ne. Pajtohem me shumicën e vërejtjeve se ne duhet të jemi të kujdesshëm me privatizimin e ndërmarrjeve strategjike. Jam një sy i fuqishëm me ju dhe popullin e Kosovës që do të bëjmë gjithçka që është e mundur edhe nga gabimet që janë lëshuar, se nuk ka punë që është pa gabime. Pra, kemi mësuar shumë gjëra edhe gjatë këtyre 10 vjetëve, pra unë kam mësuar shumë. Rrethanat juridike dhe politike nuk kanë lënë shumë mundësi të zgjerohet procesi i privatizimit, i dini vetë ju. Populli i Kosovës ka

demonstruar për ta filluar procesin e privatizimit, armiqtë e Kosovës e kanë ndaluar për 2 vjet. Ju e dini çfarë lufte është bërë me Maria Fuçin dhe klikën e saj, tek në vitin 2005 ka rifilluar dhe vetëm 8 ndërmarrje janë privatizuar deri në vitin 2005.

Zhvillimi ekonomik i Kosovës konsideroj që varet shumë nga mënyra se si u qasemi këtyre ndërmarrjeve strategjike. Unë ju siguroj që me gjithë potencialin tim, me gjithë mundësitë e mia, ndërmarrjet publike të Kosovës siç e tha edhe Kryeministri, do të privatizohen në mënyrën më transparente të mundshme dhe modalitetet më të mira. Këtu do të debatojmë bashkë, nëpër seanca edhe nëpër shoqëri civile për ato që i përmendën edhe të drejtat e punëtorëve, edhe pjesëmarrjen e Qeverisë së Kosovës, përkatësisht shtetit të Kosovës në pronën apo në aksionet që do t'i privatizojmë ose konsesionojmë si Aeroportin, Postën, KEK-un, Trepçën, etj. Këto janë me rëndësi strategjike, prandaj ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm. Do të duhej të ishim të kujdesshëm gjithnjë në secilën, natyrisht, po këtu është fokusi ynë.

Desha edhe një çështje t'ju them. Në vitin 2004 eksporti i Kosovës ka qenë 15 milionë euro, në vitin 2007 ka qenë 300 milionë euro. Jam i sigurt që nuk do të ishte bërë ky kërcim pa privatizimin e disa ndërmarrjeve shoqërore. Nuk mund të jesh 100% i sigurt se secila prej tyre do të ketë suksesin 100%, për të gjitha ndërmarrjet që janë privatizuar me spinoff special. Unë apeloj dhe mbështes Agjencionin Kosovar të Privatizimit që të ngre nivelin e kontrollit dhe zbatimit të obligimeve kontraktuale që ata i kanë. Janë nja 15 ndërmarrje sa di unë, vetëm nja 4 prej tyre, sa unë e mbaj mend, i kanë realizuar 100% obligimet e tyre dhe janë në rregull, të tjerat që s'i kanë realizuar, duhet t'i realizojnë, ekzistojnë mekanizmat edhe të Bordit edhe ligjor që mund ta bëjnë këtë.

Çështja e 20% dhe çështja e 80% ka mbetur dhe do të mbeten edhe një kohë, problem për ne dhe për ju. Unë kam kërkuar edhe nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar që t'i emërojë anëtarët e Komisionit për likuidim, që janë 113, duhet t'i emërojë dhe ta fillojë procedurën. Qeveria e Kosovës e ka mbështetur edhe me buxhet edhe politikisht këtë proces dhe duhet ta bëjnë këtë.

Këto janë elemente që unë, si ministër i Ekonomisë dhe Financave, desha t'i them. Falënderoj kryesuesin, falënderoj audiencën dhe jam në gjendje çdo kohë të përgjigjem për çfarëdo. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Shala!

Sipas Rregullores, fjalën e ka përfaqësuesi i Grupit të deputetëve si propozues për të debatuar për procesin e privatizimit.

ARSIM REXHEPI: Faleminderit, zoti kryesues!

I falënderoj të gjithë ata që morën pjesë intensivisht në këtë debat të shumë pritur dhe dhanë kontributin e tyre që ne të kemi një pasqyrë rreth kësaj brengje të madhe të popullit tonë.

Zoti ministër,

Faleminderit për diskutimin tuaj. Ju nuk patët asnjë arsye që ta ndieni veten të sulmuar, sepse po e përsëris edhe një herë, kjo ide për sjelljen në Kuvend të këtij debati nuk ka qenë në asnjë mënyrë asnjëherë e menduar si tendencë ndaj x apo y. Këtë ia thashë edhe Kryeministrit dhe le të mbetet kështu. Se këtu pastaj dikush ka mund t'i shfaq edhe idetë e tij, është çështje personale e secilit. Mirëpo, me gjithë diskutimin tuaj përmbyllës dhe

arsyetues, në fund dalin disa çështje që lënë në shije pak sa të hidhur. Nuk do t'ju lodhja as ju, as këtë audiencë nëse do t'i përsëritja disa çështje të argumentuara shumë mirë nga kolegët dhe koleget deputete.

Mungesa e Ligjit për privatizimin, që u soll në diskutim, mungesa e kontrollit që u bëhet ndërmarrjeve të privatizuara me spinoff special, shtron pyetjen deri në ç'shka ato i kanë përmbushur kushtet e dala nga kontrata? Flas këtu edhe për furnizimin me rrymë të Ferronikelit i cili bëhet edhe në këto 2 vjet prej sa edhe ju jeni ministër i Ekonomisë dhe Financave.

Flas këtu edhe për raportet dhe raportin që u soll këtu, që s'janë të kënaqshëm. Flas këtu për dyshimet që i soll në diskutim kolegu im Naim Rustemi rreth raporteve të ministrit të Ekonomisë dhe Financave me këshilltarin Arila Fogel. Flas këtu për panatyrshmërinë e një prerjeje të thukët në mes të asaj që ka qenë AKM-ja dhe kësaj që sot quhet AKP, rreth tendencës për t'i ndërprerë aktivitetet e të vetmes agjenci. Edhe një herë po e përsëris, flas këtu për mungesën e argumentimit të llogaridhënies nga të gjitha ato kompani të cilat janë privatizuar dhe sidomos ato të cilat janë privatizuar me spinoff special. Unë shpresoj që ky debat i sotëm nuk është fundi i këtij debati në këtë rrafsh dhe do të isha i lumtur që në të ardhmen të kemi debate më të thukëta, më të thella dhe më intensive, në mënyrë që edhe ne si Parlament ta arsyetojmë vetveten duke kontrolluar segmente të caktuara të qeverisjes. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Me kaq debat lidhur me procesin e privatizimit sipas kërkesës së Grupit të deputetëve mori fund. Nuk jemi të obliguar të votojmë. Prandaj, besoj që edhe vërejtjet që janë dhënë nga deputetët duhet të kihen parasysh.

Kalojmë në pikën e 10 apo të 5 të rendit të ditës, sipas miratimit që e kemi bërë në mëngjes.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar dhe në Organizatat e Grupit të Bankës Botërore.

Lus regjinë që ta bëjë konstatimin e kuorumit në sallë dhe lus në të njëjtën kohë që t'i ftojë deputetët që janë jashtë salle, me qëllim që të bëhet kuorumi.

Ju njoftoj që aktualisht në sallë janë 57 deputetë, duhet të jenë 61, po presim edhe 2 – 3 minuta, bashkë me ata.

Regjia, në qoftë se ka mundësi i bini ziles!

Atëherë, të nderuar deputetë, nuk ka kuorum. Seanca vazhdon nesër në orën 10,00, në të cilën do ta miratojmë ligjin.

E premte, më 29 maj 2009

Vazhdimi i seancës planare

Drejton seancën anëtari i Kryesisë, zoti Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Mirë mëngjes,
Të nderuar deputetë,

Zoti Kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Po vazhdojmë me pikën e fundit që e lamë dje për sot.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar dhe në Organizatat e Grupit të Bankës Botërore

Ftoj ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektligjin. Ju njoftoj se në sallë janë 69 deputetë.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar kryesues i Parlamentit,
I nderuar zoti Kryeministër,
I nderuar zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra,
Të nderuar deputetë,
Më lejoni që para se të prezantoj Ligjin për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Grupin e Bankës Botërore, fillimisht t'ju informoj rreth procesit të anëtarësimit të vendit tonë në këto dy institucione shumë të rëndësishme financiare botërore.

Besoj se ju të gjithë jeni të informuar se Kryeministri i Republikës së Kosovës ka bërë aplikim formal më 10 korrik të vitit të kaluar për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në grupin e institucioneve të Bankës Botërore. Menjëherë pas këtij aplikimi, ne kemi formuar një grup punues në përbërje të Kryeministrit, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave për të udhëhequr dhe proceduar këtë proces.

Në tetor të vitit të kaluar për herë të parë Kosova u ftua nga këto dy organizma për të marrë pjesë në takimet vjetore të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të Bankës Botërore.

Pas krijimit të Komisionit për përcaktim të kuotës dhe të anëtarësimit nga ana e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe pas aprovimit të kuotës, procesi i votimit kishte filluar në prill dhe ka mbaruar më 5 maj, për rezultatet e të cilit do t'ju shpjegojë pak më vonë. Dhe, në të njëjtën kohë, të njëjtat procedura kishin filluar edhe në Bankën Botërore.

Ne, po ashtu, me ftesë të këtyre dy institucioneve, një delegacion i udhëhequr nga ministri i Ekonomisë dhe Financave dhe në përbërje të guvernatorit të Bankës Qendrore, ishim në Uashington për të marrë pjesë në takimet pranverore që janë raportuar për mediet dhe për opinionin e Fondit Ndërkombëtar dhe të Bankës Botërore.

Gjatë kësaj kohe në koordinim me të gjithë partnerët tanë strategjikë ndërkombëtarë konsideroj se kemi arritur që Kosovën ta shtymë një hap përpara në këtë drejtim.

Sot, kur po flas para jush për këtë proces, tanimë të gjithë jeni të informuar se Fondi Monetar Ndërkombëtar, përkatësisht Bordi Ekzekutiv i Fondit Monetar Ndërkombëtar i ka bërë ftesë zyrtare Republikës së Kosovës për anëtarësim.

Kjo ftesë Kosovës i është bërë pas një rezultati shumë të mirë, nga votimi i të gjithë guvernatorëve të Fondit Monetar Ndërkombëtar, ku siç jeni të informuar, 138 vende e përkrahën Kosovën për t'u bërë anëtare me të drejtat e plota të këtij institucioni të rëndësishëm, prej të cilave 96 shtete votuan "për", 10 "kundër" dhe 32 abstenuan. Pra, të gjithë këto e mbështetën Kosovën për të qenë anëtare e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe besoj dhe i lus që të gjitha ta bëjnë këtë edhe për anëtarësim në Bankën Botërore.

Në këtë rast, dua që në emër tuaj, në emër të Republikës së Kosovës, t'i falënderoj të gjithë ata miq ndërkombëtarë dhe të gjitha këto shtete që po na mbështesin në procese të rëndësishme të integritetit ndërkombëtar.

Siç e thashë edhe më herët, procesi i anëtarësimit në Bankën Botërore ka filluar javë më parë dhe tani po i afrohem fundit. Votimi përfundon më 3 qershor. Ne jemi duke punuar pa ndërprerë me miqtë tanë ndërkombëtarë që edhe këtë proces ta përfundojmë me sukses.

Në këtë mënyrë, sot para jush paraqesim për aprovim Ligjin për anëtarësim në këto dy institucione të rëndësishme, përkatësisht në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Grupin e Bankës Botërore, që përfshinë 5 institucione të rëndësishme.

Para se ne të dërgojmë këtë ligj te ju, jemi koordinuar mirë me institucionet në fjalë, pra me Fondin Monetar Ndërkombëtar, me Bankën Botërore dhe me Zyrën e tyre juridike dhe çdo fjali e shkruar në ligj para jush është e harmonizuar edhe me këto dy institucione të rëndësishme, që është parakusht për të ecur përpara në këtë drejtim.

Parimisht, me aprovimin e këtij ligji pranohen të gjitha obligimet dhe përgjegjësitë si dhe benificionet që mund t'i ketë Kosova pas anëtarësimit në këto institucione të rëndësishme ndërkombëtare.

Duke u bërë anëtare e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe e Bankës Botërore, Republika e Kosovës përfundimisht do të ketë qasje në financimin e nevojave të saja nga këto dhe institucione të tjera financiare ndërkombëtare, por në të njëjtën kohë merr edhe obligimet në qoftë se ato janë të konfirmuara se janë të Republikës së Kosovës.

Ndër të tjera, me anëtarësimin në këto institucione Kosovës i ndihmohet të ketë një stabilitet fiskal, të ketë një kredibilitet të shtuar për Republikën e Kosovës ndaj investitorëve ndërkombëtarë, do të ketë kreditim të ekonomisë vendëse dhe do të ketë, besoj, qëndrueshmëri ekonomike makro- financiare.

Është, po ashtu, e rëndësishme të përmendet fakti se pas aprovimit të këtij ligji dhe pas përfundimit të procesit të anëtarësimit në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Bankën Botërore, Kosova si e tillë do të përfitojë edhe nga ngritja e besimit të potencialit të vetë investues dhe e kredibilitetit të saj ekonomiko- financiar.

Një ndër elementet e rëndësishme që përcaktohen me anëtarësimin në Fondin Monetar Ndërkombëtar është edhe kuota të cilën me shumë sukses konsideroj e kemi përfunduar gjatë bisedimeve të përbashkëta me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Më lejoni t'ju them se vetëm një pjesë e vogël e kuotës -totali do të duhet të paguhet në para të gatshme, ndërsa për pjesën tjetër ne do të lëshojmë të ashtuquajtura "letra

premtuese”, me anë të të cilave u premtojmë këtyre institucioneve në rast se ata kërkojnë nga ne, ne do të jemi të gatshëm t’i bëjmë pagesat shtesë në çdo kohë.

Historikisht shikuar, nuk ka ndodhur që kërkesa për pagesën e këtyre letrave premtuese të ndodhë ndonjëherë. Meqë përmenda kuotën, ju mund të keni dëgjuar se kuota për Republikën e Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar ka qenë 59 milionë US dollar, përkatësisht shndërruar në euro - 65 milionë euro. Në terme relativ, kjo do të thotë se Kosova do të marrë pjesë në tërësinë e kuotës të Fondit Monetar Ndërkombëtar për 0,02%. Pra, fuqia e votës sonë në Fondin Monetar Ndërkombëtar do të jetë 0,02%, që është një pjesëmarrje e përafërt me shtetet krahasuar me rajonin, siç janë Shqipëria që ka 0,02%, Mali i Zi 0,01%, Maqedonia 0,03% kjo është një term përafërsisht e rrumbullakuar.

Pra, këto janë pika të përgjithshme të cilat kanë të bëjnë me Ligjin që është para jush sot, ku i mundësohet Kosovës që pas aprovimit të anëtarësohet në këto dy institucione të rëndësishme ndërkombëtare. Me qëllim që ne të arrijmë që gjatë qershorit të nënshkruajmë anëtarësimin e Kosovës në Bankën Botërore dhe në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe me qëllim që Kosova të ketë mundësi që në planifikimet buxhetore të cilat fillojnë nga 1 korriku i këtij viti deri më 30 qershor të vitit të ardhshëm, lus të gjithë deputetët e nderuar që sot ta përmbyllim në procedurë të veçantë këtë ligj me qëllim që t’i jepet Kosovës mundësi që ta zërë hapin e kohës lidhur me vendimet e rëndësishme që do të merren në qershor, përkatësisht në planifikimet buxhetore të Bankës Botërore, të cilat në ciklin e vet buxhetor fillojnë më 1 korrik dhe mbarojnë më 30 qershor, jo sikurse te ne që është 1 janar - 31 dhjetor.

Prandaj, kërkoj nga ju që me procedurë të shkurtuar, përkatësisht të përsheptuar ta aprovojme këtë ligj dhe të jemi në gjendje që anëtarësimin e Republikës së Kosovës në këto dy institucione ndërkombëtare të rëndësishme ta përmbyllim në qershor, me sukses besoj. Faleminderit! Nëse keni ndonjë pyetje, jam këtu për t’u përgjigjur.

KRYESUESI: Faleminderit!

Tani, sipas radhës, kryetari ose raportuesi i Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa. Pra, fjalën e ka deputeti, Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar Kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Ju e dëgjuat fjalën e zotit ministër në paraqitjen e këtij projektligji. Ne si Komision kemi diskutuar shkurt çështjen e këtij projektligji. Pra, ishte mendim unanim që ky projektligj të përkrahet dhe të miratohet, në parim. Duke pasur parasysh nevojën dhe domosdoshmërinë që angazhimet e Qeverisë së Kosovës të fuqizohen pikërisht edhe nga Kuvendi lidhur me këtë Projektligj dhe anëtarësimin në Fondin Monetar Ndërkombëtar, ne mendojmë se duhet të respektohet kërkesa e Qeverisë për t’i zënë afatet, siç e paraqiti edhe ministri këtu dhe që ky projektligj të bëhet ligj dhe t’i mundësohet aktiviteti i mëtutjeshëm Qeverisë në aspektin e anëtarësimit të Kosovës në mekanizmat monetarë ndërkombëtarë, në këtë rast në Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Unë shkurtimisht dua të them se ky projektligj më tepër ka të bëjë me autorizimet që do t’i japin Qeverisë dhe Presidentit lidhur me aktivitetet që do t’i ushtrojnë me këta mekanizma ndërkombëtarë monetarë dhe në pjesën tjetër të ligjit që ka të bëjë me

anekset që janë rregullativë e institucioneve ndërkombëtare, respektivisht e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe konventa të ndryshme, në të cilat, ne si Kuvend nuk mund të ndërhyjmë lidhur me ndryshimin e tyre. Pra, ose duhet t'i miratojmë, si të tilla, ose do të heqim dorë nga kërkesa jonë për anëtarësim në Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Ne mendojmë dhe jemi të gatshëm, si Komision, që këtë projektligj ta procedojmë në mënyrën siç u kërkuar edhe nga Qeveria. Kemi një letër këtu nga Kryeministri, por edhe nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave që procedura të jetë e përshpejtuar. Pra, unë e kuptoj se procedura e përshpejtuar është që sot në mënyrë urgjente Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe komisionet e tjera përkatëse të takohen dhe t'i japin rekomandimet e tyre dhe ky projektligj të miratohet në ditën e sotme në një vazhdim të seancës ose një seancë të re gjatë ditës kështu që, si të tillë, duhet pasur parasysh afatin kohor. Ministri tha se është data 3 qershor, kur Fondi Monetar Ndërkombëtar duhet të vendosë, kështu që ne si Kuvend duhet të jemi të përgjegjshëm në këtë çështje dhe të angazhohemi për miratimin e këtij ligji.

Prandaj, kërkoj nga deputetët, nga grupet parlamentare të Kuvendit të Kosovës që, vërtet, të jenë për propozimin e bërë të ministrit në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit!

Më lejoni që në emrin tuaj ta përshëndes zotin Age Baker, drejtor ekzekutiv i grupit të shteteve të Fondit Monetar Ndërkombëtar që udhëhiqet nga Holanda, i cili është prezent në sallë duke përcjellë miratimin e ligjit.

(Duartrokitje)

Faleminderit! Njëkohësisht falënderojmë për ndihmën dhe koordinimin e shkëlqyer që ka pasur Qeveria me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Faleminderit, zoti Koci. Sipas radhës, fjalën e kanë kryetarët e komisioneve të përhershme, në qoftë se janë të interesuar të diskutojnë. Në emër të komisioneve nuk është paraqitur askush. Radhën e kanë përfaqësuesit ose kryetarët e grupeve parlamentare.

Është paraqitur kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuar zoti kryesues,

I nderuar zoti Kryeministër, zëvendëskryeministër dhe ministra,
Kolegë të nderuar deputetë,

Para se të kaloj në atë pjesën mbështetëse për Projektligjin, do t'ju them diçka që sinqerisht po ndjehem keq kur po bie zilha për deputetët, përfaqësues të popullit, për ta vijuar punën e seancës. Sinqerisht, po ndihem keq, andaj dua t'ju them, kur të bëhet ora 10:15 ose ora 10:00 fillojmë seancën. Kur unë gjithmonë po mund të jem i pari ose ndër të parët këtu në sallë, pse s'munden të tjerët. Sinqerisht po ju them që kjo logjikë ballkanase e vonësës ose të mos bëhet vonë kurrë, për mua është shumë ... Unë ju lus, kolegë të nderuar deputetë, paraprakisht do t'ju kërkoj falje, por duhet të jemi më të ndërgjegjshëm për pozitën dhe rolin që kemi ... në minutat e caktuar në sallë. Nëse do të duam gjithmonë të vonohemi për 40 minuta, unë nuk di çka nënkupton kjo. Ju faleminderit!

Ndërsa, sa i përket çështjes së Projektligjit që sot e kemi në trajtim, duhet pasur parasysh rolin që ka, funksionin që ka anëtarësimi në këto mekanizma financiar ndërkombëtar. Ne, si Grup Parlamentar, natyrisht që e mbështesim si Projektligj dhe procedurën e veçantë të përshpejtuar që ky të bëhet sa më shpejt i realizuar dhe të ecim në rrugën që e dëshirojmë ...

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, zoti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti Kryeministër,

Zëvendëskryeministër, ministër Shala,

Po ashtu, mysafir i nderuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Sot është një ditë e rëndësishme për ne pas lajmit për anëtarësimin e Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar, sigurisht që mbështetja për anëtarësim dhe angazhimi i institucioneve tona tregon qartë që kemi arritur në pikën kur duhet të votojmë ligjin.

Grupi ynë Parlamentar e mbështet këtë ligj edhe i mbështet procedurat e përshpejtuara që ky ligj të miratohet sot në mënyrë që të finalizojmë angazhimet tona sipas kërkesës së vetë ministrit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së ta përshëndes përfaqësuesin e Fondit Monetar të pranishëm në Kuvend.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet në parim këtë projektligj dhe duke qenë i vetëdijshëm për rëndësinë e krijimit të bazës ligjore për anëtarësimin e Kosovës në institucionet ndërkombëtare në Fondin Monetar, në Bankën Botërore dhe në strukturat e tjera, është i gatshëm që ta japë kontributin e vet në forma të përshpejtuara të miratimit të këtij ligji.

Ne mendojmë që është dashur më shumë angazhim që të paktën një vlerësim i kostos ka mund të nxirret përafërsisht, megjithatë ne do ta mbështesim dhe shpresojmë që shumë shpejt do ta eliminojmë edhe këtë zbrazëti në këtë projektligj.

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputetja Synavere Rysha.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe ne, si Lidhje Demokratike e Dardanisë, normalisht që e mbështesim anëtarësimin e Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar. Gjithashtu, projektligjin e përkrahim sepse është një projektligj, ndoshta, më se i domosdoshëm. Gjithashtu, e përkrahim edhe procedurën e përshpejtuar. Kontributin tonë do ta japim gjatë kësaj kohe në Komision.

KRYESUESI: Faleminderit!

AKR-së i kërkoj falje që e kam kaluar. Në emër të AKR-së, kryetari i Grupit Parlamentar, Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti Kryeministër,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Duke pasur parasysh se ky është një ligj specifik dhe i një rëndësie të veçantë për Kosovën, ne si Grup Parlamentar e mbështesim Projektligjin në fjalë. Po ashtu, edhe procedurat për miratimin e këtij ligji me një kërkesë që në të ardhmen, kur ka ligje të natyrës së tillë, të përgatiten më herët në mënyrë që të kemi mundësi për një procedim më të rregullt. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “7+” Myfera Shinik.

MUFERA SHINIK:

Teşekkür ederim!

Sayın Başbakan, Başbakan yardımcısı, Bakanlar, milletvekilleri ve salonda bulunan tüm misafirleri selamlamak istiyorum.

Uluslararası Platformu Yasa Tasarısının, Kosova için çok önemli bir Yasa Tasarısı olduğunu biliyoruz. Bu yüzden “7 +” Parlamenter grubu olarak bu Yasa Tasarısının birinci okunuşunu kabul ediyoruz ve komisyona sunacağımız gerekli önerilerin gözönünde bulundurulmasını rica ediyorum.

Teşekkür ederim!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të SLS-së, nuk ka të paraqitur tani. Ju lutem, paraqituni me kohë. Radmila Vujović.

RADMILA VUJOVIĆ: Hvala, predsedavajući!

Ministri, premijeru, poslanici,

Prethodne diskusije su pojasnile značaj i važnost ovog Zakona, tako da naša Parlamentarna grupa ne bi dodala nešto posebno i ne bi ponavljala i podržavamo ovaj Nacrt zakona.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar „Zajedno“ nuk është paraqitur askush. Ju faleminderit!

Atëherë, propozimi është që të shkojmë në dy lexime sot, pas miratimit në parim dhe shqyrtimit nga komisionet me procedurë të shpejtë, ta martojmë ligjin.

Ju lus për një votim formal për shpejtim të procedurës sot. Kush është „për“? „Kundër“ - asnjë. Pra, me shumicë absolute ose me konsensus të përbashkët, miratohet procedura e përshpejtitimit të ligjit. Tani radhën e kanë deputetët sipas paraqitjes. Për debat është paraqitur Shkumbin Demaliaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë mendoj se edhe deputetët për këtë projektligj mund ta thonë fjalën e tyre për shkak se dihet se ligji është i një rëndësie të veçantë. Folën edhe parafolësit më herët këtu, zoti kryetar i Komisionit për Buxhet, në të cilin jam anëtar edhe unë. Duke e kuptuar rëndësinë e Projektligjit, edhe ne do ta votojmë. Mirëpo, në këtë rast i them Kryetarit

edhe një herë se ne nuk kemi diskutuar asnjëherë në Komisionin për Buxhet për të njëjtin projektligj, përkatësisht Komisioni për Buxhet të hënën e ka në pikën e dytë të rendit të ditës shqyrtimin e Projektligjit, mirëpo duke e kuptuar rëndësinë e tij, lypset përkrahje e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Pra, ne do ta votojmë këtë projektligj.

Lidhur me vërejtjet që po jepen nganjëherë nga deputetët, unë e përkrah plotësisht kryetarin e Grupit Parlamentar të PDK-së, zotin Ramë Buja, mirëpo po të jenë prezentë deputetët e pozitës në Kuvend, asnjëherë nuk dështojnë seancat për mungesë kuorumi. Do të thotë, që tri herë mbajmë mbledhje për shkak të papërgjegjësisë së deputetëve, të pozitës në këtë rast, sepse po marrin vërejtje të gjithë deputetët, përderisa vetëm pozita sa herë dëshiron mund t'i kalojë të gjitha projektligjet dhe ligjet. Pra, lidhur me këtë çështje, le të merren grupet parlamentare, pra të mos na e marrin kohën në Kuvend e ne do t'i përkrahim të gjitha procedurat që u thanë sot këtu në Kuvend. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka Driton Tali.

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Fillimisht, e përshëndes përfaqësuesin e Fondit Monetar Ndërkombëtar këtu tek ne.

E mora fjalën në konotacion të asaj që u tha për përgjegjësinë e deputetit, si përfaqësues i popullit, t'i them disa fjalë këtu.

U përmend edhe rasti historik i anëtarësimit të Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar, por ajo që desha të them është se pa të drejtë Qeveria tenton ta marrë këtë si fitore, kur dihet se është një procedurë e rëndomtë ndërkombëtare në kuptimin e anëtarësimit të ndonjë shteti. Pasi veç u përmend historia, nëse doni, unë po ua përmend shumë shtete të cilat ngjashëm si Kosova janë anëtarësuar aty. Po i marrë këtu shtetet e vogla, si Xhibuti, Ginea Bisao, Burkina Faso, ndonëse Burkina Faso ka 0.03% influencë atje, apo Sierra Leone ka 0.05% e tjera, e tjera. Po e marrim Bangladeshin, që dje u përmend. Bangladeshi ka fituar pavarësinë më 26 mars 1971. Në Bankën Botërore është anëtarësuar më 17 gusht 1972, domethënë një vit e katër muaj, pak më shpejt se Kosova. Nuk ka nevojë që çdo procedurë të politizohet dhe të tentohet të përfitohen poenë politikë, kur nuk është e tillë, aq më shumë në rastin e Kosovës, ku nëse kemi parasysh influencën e atyre që janë kundër pavarësisë së Kosovës, nuk e kalojnë 10% apo 12%, ndërsa miqtë tanë e kanë atë farë 88%-shin e influencës në Fondin Monetar dhe në Bankën Botërore.

Sigurisht se e përkrah këtë projektligj, me një kritikë të vogël se është dashur më herët të na e sjellin, se ne kemi konkurruar, kemi kërkuar për t'u anëtarësuar para disa muajve dhe ky ligji ka mund të sillej shumë më parë. Ju faleminderit! Por, edhe një gjë të vogël, atë do ta le për një debat tjetër, e pati një mbyllje ministri i Financave dje, nuk m'u dha rasti t'i them disa gjëra konkrete, por do t'i them njëherë tjetër. Po, po, këtu pasi u fol për zile, atëherë edhe për fjalimin e djeshëm.

KRYESUESI: Tjetër ditë, të lutem!

DRITON TALI: Po, po, tjetër ditë, në një debat tjetër. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Koci, e keni fjalën.

GANI KOCI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë do të ndërlidhem pak me fjalën e zotit Tali, që kërkon që të mos politizohet dhe të mos i atribuohet Qeverisë si sukses, por dua t'i tregoj zotit Tali se ky është një aktivitet i Qeverisë dhe duhet ta ndërmarrë Qeveria, prandaj i atribuohet Qeverisë dhe Qeveria e kërkon mbështetjen e Kuvendit këtu, zoti Tali, dhe Kuvendi i dha mbështetjen e vet në formën që e ka kërkuar edhe Qeveria.

Duke pasur parasysh domosdoshmërinë dhe nevojën e anëtarësimit të Republikës së Kosovës në të gjitha institucionet ndërkombëtare dhe, në këtë rast, edhe të Fondit Monetar Ndërkombëtar, unë konsideroj që, vërtet, të mos bëhemi ne si diskutues tash rreth këtij projektligji që ta politizojmë këtë çështje edhe të fitojmë poenë politikë. Është e nevojshme ta trajtojmë sa më parë këtë çështje.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Koci!

I kisha lutur deputetët që të mos polemizojmë me diskutuesit tani rreth kësaj. Qeveria është këtu dhe do ta thotë fjalën e vet përfundimtare. Meqenëse ia ka përmendur emrin zotit Koci, deputeti Tali, e ka fjalën për replikë.

DRITON TALI: Unë, singërisht, pa dashur të polemizoj me zotin Koci, duke marrë parasysh profesionin e tij, nuk i merr vesh këto sende, unë i përmenda historikisht gjërat se si shkojnë ato. Kështu që, unë këtu po e ndërpres, si të doni ...po ua llogaris kohën kohen kur e kanë shpallur pavarësinë dhe kur janë anëtarësuar edhe në Fondin Monetar, edhe në Bankën Botërore. Është procedurë, ju lutem. Është e kotë të polemizoj, edhe një herë po them, me zotin Koci, nuk i merr vesh këto sende. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, vazhdojmë. Gani, t'u kisha lutur që ta tërheqësh. Në rregull, Zoti Koci, kundër replikë. Kurrkund, veç tek ne, ta keni parasysh, veç në Parlamentin e Kosovës ka kundër replikë. Askund në botë nuk ka kundër replikë. Vazhdo, zoti Koci.

GANI KOCI: Zotit Tali vetëm dua t'i them një gjë. Ne nuk po diskutojmë se cili shtet është anëtarësuar, por edhe për sa ditë këtu. Është e nevojshme që Kosova të anëtarësohet dhe e ka kërkuar këtë procedurë dhe këtë përshejtim. Prandaj, se sa i njohim çështjet, ka vend edhe ka mundësi që të dëshmohej se ku dhe si i njohim. Nëse Kuvendi është vend ku duhet të merren vendime, Kuvendi nuk duhet të jetë vend për shfryrje këtu. Ju keni nevojë për shfryrje, por për këtë ta shfrytëzojmë një rast tjetër, ju lutem!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Diskutues të tjerë nuk ka. Sipas procedurës, fjalën e ka përfaqësuesi i Qeverisë, propozuesi i Ligjit. Pra, fjalën e ka ministri Ahmet Shala, nëse e do. Nuk e do fjalën. Atëherë, në vazhdim kërkoj që të deklarohet prezenca e deputetëve. Në sallë janë 80 deputetë dhe është radha e votimit të Ligjit, në parim.

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim. Votojmë, tani:

Kemi 78 vota me elektronikë. A ka dikush që nuk ka kartelë?

Me 79 vota "për", 2 abstenime, konstatoj që miratohet, në parim, Projektligji për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në organizatat e Grupit të Bankës Botërore.

Kuvendi, në bazë të Rregullores së Punës, i ngarkon këto Komisione:

- Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional,
- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisionin për Komunitete dhe
- Komisionin për Integritet Evropian.

Komisionet duhet të punojnë deri në orën 13:00 dhe në orën 13:00 do ta miratojmë ligjin. Si? Në rregull. Në orën 14,00, atëherë. Komisionet le të shkojnë në sallë. Pra, le të bisedojnë dhe të merren vesh mes veti, anëtarët e komisioneve përkatëse.

Në orën 14:00, takohemi në seancë të re për leximin e dytë të projektligjit që posa e miratuar, në parim.

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve